REPUBLIKA E KOSOVËS

KUVENDI I KOMUNËS NË MALISHEVË

04.03.2026
02/55

---

Kuvendi Komunal Malishevë
Nr.02/___
Datë: 04.03.2026

Mbështetur në nenin 43 të Ligjit nr.03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale, nenit 3 paragrafi 1 pika1.2, nenit 5 të Udhëzimit Administrativ (MAPL) nr.02/2015, për mbajtjen e mbledhjeve të Kuvendit të Komunës, nenit 13 të Rregullores nr.02/175 datë:31.05.2017 për punën e Kuvendit, Komiteteve dhe Komisioneve të Komunës së Malishevës në bazë të Statutit të Komunës së Malishevës, miratuar në mbledhjen e Kuvendit të Komunës me datë, 11.09.2023 (nr.02/441, datë: 14.09.2023), Kryesuesi i Kuvendit të Komunës së Malishevës, me datë: 04.03.2026;

THËRRET

Mbledhjen e -I- (parë) të rregullt të Kuvendit të Komunës së Malishevës për vitin 2026, e cila do të mbahet ditën e **Enjte** me datë**: 12.03.2026** duke filluar nga ora: **10:00.**
Mbledhja do të mbahet në sallën e Kuvendit të Komunës.

Ftohet z/zj______________________________që të marrë pjesë në këtë mbledhje.

Për këtë mbledhje propozoj këtë:

RENDI I DITËS

1. Dhënia e betimit të anëtarëve të Kuvendit Komunal, z. Astrit Sertolli, z.Skender Zogaj dhe z. Hamez Bytyçi.
2. Shqyrtimi dhe miratimi i procesverbalit të mbledhjes së -I- (parë) inauguruese të KK- Malishevë, datë: 03.12.2025, Shqyrtimi dhe miratimi i procesverbalit të mbledhjes së -I- (parë) të jashtëzakonshme të mbajtur me datë: 30.12.2025, Shqyrtimi dhe miratimi i procesverbalit të mbledhjes së -I-(parë) urgjente të mbajtur me datë: 12.01.2026, Shqyrtimi dhe miratimi i procesverbalit të mbledhjes së -II-(dytë) të jashtëzakonshme të mbajtur me datë: 20.01.2026.
3. Shqyrtimi dhe miratimi i kërkesës nr.01/448 datë:02.03.2026 e parashtruar nga Kryetari i Komunës, në lidhje me kërkesën e Shoqatës Bamirëse "Jetimat e Ballkanit" për ndryshimin dhe plotësimin e Vendimit të Komunës së Malishevës nr.02/359, datë:11.08.2022.
4. Shqyrtimi dhe miratimi i kërkesës nr.01/390 datë:23.03.2026 e parashtruar nga Kryetari i Komunës, për formimin e Komisionit Vlerësues, me rastin e dhënies në shfrytëzim të pronës publike përmes thirrjes së interesit publik sipas vendimeve të Kuvendit nr.02/121, datë:08.03.2024 dhe nr.02/142, datë:23.05.2025
5. Shqyrtimi dhe miratimi i kërkesës nr. 01/391,datë 23.02.2026 e parashtuar nga Kryetari i Komunës, për fomimin e komisionit të ankesave, konform nenit 18,të Ligjit nr.06/L-092 për dhënien në shfrytëzim dhe këmbimin e pronës së paluajtshme të Komunës.
6. Shqyrtimi dhe miratimi i kërkesës nr.01/451 datë:03.03.2026 e parashtruar nga Kryetari i Komunës, për miratim të listës së pronave të paluajtshme të komunës së Malishevës, për dhënie në shfrytëzim gjatë vitit 2026.

7. Shqyrtimi i Raportit të Komisionit Komunal nr.01/459, datë: 04.03.2026 mbi Vlerësimin e Dëmeve nga FNFT.
8. Formimi i Komisionit për Hartimin e Planit të Punës së Kuvendit.
9. Shqyrtimi dhe miratimi i kërkesës nr.01/459, datë:04.03.2026 për Themelimin dhe emërimin e anëtarëve të KKSB-së për Komunën e Malishevës.
10. Formimi i Komisionit Komunal të Aksionarëve ''Stacioni i Autobusëve" SH.A. Malishevë.
11. Formimi i Komisionit Komunal të Aksionarëve "EKO-Regjioni" SHA.A Prizren,njësia në Malishevë.
12. Shqyrtimi dhe miratimi i kërkesës për ngritje të tarifës së shërbimit të mbeturinave.
13. Formimi i Komisionit për ndryshim-plotësim të Statutit të Komunës.
14. Formimi i Komiteteve jo obligative.
15. Formimi i Komisionit për zgjedhjen e këshillave lokale.
16. Propozim- Formula për zgjedhjen e delegatëve të Komunës për Kuvend të AKK-së.
17. Të ndryshme.

Malishevë, Mars 2026.

Kryesuesi i Kuvendit
Fatmir Ademaj

**KOMPANIA REGJIONALE PËR MBETURINA**

**"EKOREGJIONI" Sh.A -Prizren**


Adresa : Rruga " KUKËSIT " nr.10

Tel: 029-241-167
Email: krm_ekoregjioni@yahoo.com
www.ekoregjioni.com


Datë:06.01.2025

| | |
|---|---|
| Nga : | Kryeshefi Ekzekutiv i K.R.M "Ekoregjioni" Sh.A Prizren Burim Shala |
| Për: | Komunës së Malishevës - Kryetarit z Ekrem Kastrati,<br><br>Kuvendin Komunal- Kryesuesit të Kuvendit, |
| Lënda : | Kërkesë për ngritje të tarifës së shërbimit të mbeturinave |

Të nderuar,

Kompania Regjionale e Mbeturinave "Ekoregjioni" Sh.A Prizren, ashtu siç jeni në dijeni, operon si ndërmarrje publike lokale- regjionale dhe nën menaxhimin e saj ka njësitë operative në Komunat (aksionarët) : Prizren, Suharekë, Malishevë, Rahovec dhe Dragash.

Aktualisht ndërmarrja operon me kapacitet të plotë dhe nga viti në vit po zgjeron veprimtarinë operative primare në grumbullim të mbeturinave deri në 100% të territorit të Komunave aksionare.

Kjo kërkesë në parim duhet të kuptohet dhe si iniciativë e përbashkët e cila duhet të ndërmerret nga ana e Kuvendeve Komunale mbi dy baza, baza juridike dhe ajo faktike.

Baza juridike e inicimit të ngritjes së tarifës së shërbimit të mbeturinave buron në *Ligjin për Mbeturina- Nr:04/L-060, Neni 13, pika 1.2. dhe Neni 15, pika 1.8, si dhe Ligji Nr.08/L-071, për plotësim-ndryshim të Ligjit bazik, 04/L060.*

Baza faktike dhe e nevojshme për të inicuar në Kuvend ndryshimin dhe rritjen e tarifës së shërbimit të mbeturinave është më e gjerë, komplekse dhe e domosdoshme.

Siç mund të jeni në dijeni fatura mujore në bazë të tarifës së fundit të vitit 2023 mbeturinave për amvisëri ka qenë 5.50€.

K.R.M Ekoregjioni deri me datë 31.12.2022 me rastin e dërgimit të mbeturinave në Deponinë e Landovicës, e cila menaxhohet nga Ndërmarrja Publike Qendrore KMDK(Kompania e Menaxhimit te Deponive në Kosovë) , do të paguaj nga 5.31€, pa TVSH, për 1/ton mbeturina amvisërie(komunale).

*Nga data 01.01.2023 ka hyrë në fuqi vendimi i Ministrisë së Ekonomisë i datës 02.12.2022 nr.01-3148,* në bazë të së cilit automatikisht rritet tarifa e mbeturinave nga 5.31€ për 1/ton, në 10.31€ 1/ton, për vitin 2026 që do të thotë se është ngritur tarifa 5€ dhe sipas vendimit kjo ngritje do të vazhdoj në vitet në vijim me plus një euro-deri në vitin 2027 si më poshtë:

Viti 2026 çmimi që do i faturohet KRM Ekoregjionit nga KMDK për një ton mbeturina komunale do të jetë 10.31 €, dhe

Në vitin 2027 çmimi që do i faturohet KRM Ekoregjionit nga KMDK për një ton mbeturina komunale do të jetë 11.31 €, pa tvsh e që sipas pikës 2 të dispozitivit të vendimit të Ministrisë mund të rishikohet për të siguruar dhe garantuar qëndrueshmëri financiare të KMDK së.

Tek rasti jonë, shërbimet e ofruara nga Ekoregjioni, në bazë të gjendjes aktuale dhe gjendjes së pritur ndër vite, nga 01 Janari 2026 nuk do ketë qëndrueshmëri financiare, e që në bazë të kostos së shërbimit që është ngritur përfshirë këtu : çmimet në përgjithësi, naftën, tani dhe ngritja e paraparë e tarifave të KMDK së, nga 5.31 € viti 2023 në 10.31€ për ton, në vitin 2026 e ka vështirësuar dhe akoma do ta vështirësoj gjendjen e mbarvajtjes dhe kryerjes së shërbimeve me koston siç ka qen deri tani, andaj konsiderojmë se baza faktike e ngritjes së faturës së shërbimeve te mbeturinave komunale-amvisërisë është e domosdoshme që të bëhet një regullore e re dhe që most ë ket probleme deri në 3 apo 4 vitet e ardhshme duhet me patjetër të bëhet dhe ndryshimi i tarifave.

Sugjerimi jonë aktual është që fatura e mbeturinave komunale të amvisërisë e cila ka qenë në fuqi qe 15 vite në vlerë prej 4.50€ dhe tani 5.50€, për të mbuluar koston e shërbimit emergjent nga Koriki ose edhe më shpejt i vitit 2026 minimalisht duhet të ngritet dhe të jet i aprovuar

nga Kuvendet Komunale si ngritje 2 € apo fatura mujore 7.50 € , përderisa për vitet në vijim të vendoset arsyeshëm konform gjendjes së krijuar.

Shumica e Komunave kanë marrë vendime për ngritje të tarifave më shumë se tre vite të cilat tani janë ende në diskutim për ngritje tarife.

Kjo kërkesë e Kompanisë është Emergjente dhe duke e shikuar edhe Planin e Biznesit të vitit 2026 ku nëse nuk ndodhin ngritjet e tarifave Kompania mundë të rezikohet që most ë funksionojë si duhet për të vetmen arsye se shpenzimet janë më të mdhaja se tarifat e përcaktuara për amvisëri dhe biznese.

Dhe gjithashtu kërkojm nga ju që kur të caktohen grupet punuese për regulloren e mbeturinave të kemi një antar tonin të kompanisë në grup punues që edhe ne mundë të japim ndihmën ton profesionale në kët drejtim.

Shpresojmë që kërkesa jonë do të kuptohet drejtë dhe do të hasë në mirëkuptimin tuaj !

REPUBLIKA E KOSOVËS
KUVENDI KOMUNËS NË MALISHEVË

23.02.2026
01/330

---

Kryetari i Komunës
**Nr. 01/___**
Datë; 19/02/2026

Nga: Kryetari i Komunës së Malishevës, Ekrem Kastrati.

Për: Kuvendin e Komunës së Malishevës
Kryesuesit z. Fatmir Ademaj.

Datë: 19.02.2026

Kopje: Arkivit të komunës

Lënda: Kërkesë për formimin e komisionit vlerësues, me rastin e dhënies në shfrytëzim të pronës publike përmes thirrjes së interesit publik sipas vendimeve të Kuvendit nr.02/121, dt.08.03.2024 dhe nr.02.142, dt.23.05.2025.

Të nderuar anëtarë të kuvendit të komunës së Malishevës,

Bazuar në Ligjin për dhënien në shfrytëzim dhe këmbimin e pronës së paluajtshme të komunës, Ligji, nr.06/L-092, dt.07.03.2019, neni 17, propozojë formimin e komisionit vlerësues për dhënien në shfrytëzim afatgjatë të pronës publike përmes shprehjes së interesit publik.

Formimi i këtij komisioni vlerësues përbëhet prej pesë ( 5 ) anëtarësh, ku dy ( 2 ) anëtarë i propozon kryetari i komunës ndërsa dy ( 2 ) anëtarë i propozon kuvendi dhe një ( 1 ) anëtarë nga sektori jo qeveritar.

Njëherit ju sqarojmë se Kuvendi i Komunës së Malishevës, me Vendimin nr.02/147, dt.23.05.2025, mirëpo sipas shkresës zyrtare të MAPL-së, nr.020-326/16, dt.07.07.2025, i njëjti është pezulluar për shkak të zgjedhjeve komunale të mbajtura në vitin 2025, mirëpo për shkak të rikonfigurimit të kuvendit, ndërrimit të anëtarëve kërkohet që të formohet komision i ri.

Ju faleminderit për mirëkuptim !

Me respekt,

Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal
Ministarstvo Administracije Lokalne Samouprave
Ministry of Local Government Administration
Nr. 020 - 326/16
Data: 01.07.2025

# Republika e Kosovës
## Republika Kosova-Republic of Kosovo
## Qeveria - Vlada - Government

*Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal*
*Ministarstvo Administracije Lokalne Samouprave*
*Ministry of Local Government Administartion*

| | | |
|---|---|---|
| Për: | Ekrem Kastrati, Kryetar i Komunës së Malishevës<br>Argjend Thaqi, Kryesues i Kuvendit të Komunës së Malishevës | |
| Kopje: | Njësisë për Administrimin e Dokumenteve në MAPL<br>Njësisë për Administrimin e Dokumenteve në Komunë | |
| Përmes: | Elbert Krasniqi, Minister i MAPL-së<br>Jeton Qela, Sekretar i Përgjithshëm i MAPL-së | |
| Nga: | Erblin Hetemi, Drejtor i Departamentit Ligjor, MAPL | Data: 11.06.2025<br>Nr. 020-326 |
| Zyrtarët përgjegjës:<br><br>1. Zyrtari konfirmues i vlerësimit ligjor<br><br>2. Zyrtari hartues i vlerësimit ligjor | Xhevat Tafa, Udhëheqës i Divizionit për Shqyrtimin e Ligjshmërisë së Akteve të Kuvendeve Komunale dhe Kryetarit të Komunës<br><br>Maltin Shala, Zyrtar i Lartë për Shqyrtimin e Ligjshmërisë së Akteve të Komunës | |
| Lënda: | Konfirmim i ligjshmërisë | |
| Lloji i aktit: | Vendim | |

I nderuar Kryetar,
I nderuar Kryesues,

Në pajtim me nenin 9 të Ligjit Nr. 08/L-284 Për Shqyrtimin Administrativ të Akteve të Komunave, Rregulloren e Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr. 10/2019 për Shqyrtimin Administrativ të Akteve të Komunave, si dhe Rregulloren nr. 06/2021 për ndryshim-plotësimin e Rregullores (QRK) Nr. 10/2019, për Shqyrtimin Administrativ të Akteve të Komunave, e në bazë të kompetencave ligjore të ministrisë të përcaktuara me ligjet bazike dhe Rregulloren e Qeverisë Nr. 14/2023 për Fushat dhe Përgjegjësitë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, Departamenti Ligjor dhe Monitorim të Komunave i Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal ka pranuar për shqyrtim të detyrueshëm të ligjshmërisë ashtu siç parashihet me nenin 81 të Ligjit Nr. 03/L-040 për Vetëqeverisje Lokale aktin komunal në vijim:

| |
|---|
| Vendim nr. 02/147 për formimin e komisionit vlerësues për dhënien në shfrytëzim të pronës së paluajtshme publike përmes procedurës së shprehjes së interesit për periudhën 99 vite. |
| I miratuar më datë: 15.05.2025 |
| I parashtruar për shqyrtim në MAPL më datë: 26.05.2025 |

Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal, pas shqyrtimit të përmbajtjes së aktit të komunës si më sipër, vlerëson se akti i komunës <u>është në pajtim me dispozitat e legjislacionit në fuqi</u>. Ndërsa sa i përket përmbajtjes së aktit si dhe obligimeve ndaj palëve tjera janë në përgjegjësi të komunës.

**Maltin Shala**

| | |
|---|---|
| **From:** | Muharrem Morina |
| **Sent:** | Wednesday, June 11, 2025 11:30 AM |
| **To:** | Maltin Shala |
| **Cc:** | Xhevat Tafa; Erblin Hetemi |
| **Subject:** | WG: kerkesë për material shtesë |
| **Attachments:** | komisioni per dhenien ne shfrytezim afatgjat 02 147 2025.pdf |

Pershendetje i nderuari z.Shala,

Asthu si edhe kerkuat permes telefonit per profesionet e antarve te komisionit te formuar sipas vendimit te kuvendit te Komunes, ju sqaroje se
ne bazë te informatave qe kam mundur ti marr kane keto profesione;

1. Muharrem Morina Ma.sc-jurist- nga ekzekutivi i komunes,
2. Kujtim Stolliqi-gjeografi aplikative- zyrtar i drejtoris per sherbime publike nga ekzekutivi,
3. Amrush Helshani-Anetar i Kuvendit me profesion fakulteti filozofik, nga kuvendi
4. Valon Krasniqi- Anetar i Kuvendit- !? nga kuvendi
5. Dibran Kastrati-Edukat Fizike-OJQ-

Ju faleminderit per mirekuptim !

Me respekt,
M.M

6. Pas miratimit nga ana e Kuvendit të Komunës së Malishevës, ky vendim hymnë fuqi 15 ditë pas dërgimit në autoritetin mbikëqyrës, konform nenit 81 të Ligjit nr.03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale, nenit 8, lidhur me nenin 9 të Rregullores (QRK) nr.10/2019, për shqyrtimin administrativ të akteve të Komunave, dhe 7 ( shtat ) ditë pas shpalljes publike në tabelën e shpalljeve ose ueb-faqen e Komunës.

Vendimi ju dërgohet:
1.MAPL-së ,
2.Zyrës së Kryetarit,
3.Arkivit të komunës.

Kryesuesi i Kuvendit
[illegible]

1). Parcela me numër të njësisë, P-72310049-00303-0, sipas numrit të lëndës 580/25, zona kadastrale në fshatin Shkozë, në sipërfaqe të përgjithshme prej 279291 m$^2$ në vendin e quajtur "*Balli Vneshtëve* " e kualitetit të klasës, kullosë e klasit 5, pronë publike në emër të Komunës së Malishevës.

2).Parcela me numër të mjësisë,P-72310003-00833-2, sipas numrit të njësisë së lëndës 401/25, zona kadastrale në fshatin Bubavec, në sipërfaqe të përgjithshme prej 100000 m$^2$, në vendin e quajtur " Rrezja Jonë " e kualitetit, kullosë e klasit 3, pronë publike në emër të Kuvendit të Komunës së Malishevës.

3).Parcela me numër të njësisë,P-72310025-00223-679, sipas numrit të lëndës 400/25, zona kadastrale Dragobil, në sipërfaqe të përgjithshme prej 900 m$^2$ në vendin e quajtur Polanka -Golesh, e kualitetit Kullosë e klasit 5, pronë publike në emër të Kuvendit të Komunës së Malishevës.

-Procedura e dhënies në shfrytëzim të pronës të cekur si më lartë, zhvillohet konform nenit 8 par.1 pika 1.2 ( *shprehje të interesit* ) të Ligjit, nr.06/L-092, për dhënien në shfrytëzim dhe këmbimin e pronës së paluajtshme të komunës, ndërsa afati ose kohëzgjatja parashihet të jet për 99 vite, konform rregullës së parapare me nenin 6 par.1 pika 1.2, të këtij Ligji, ( *neni 6, par.1 pika 1.2, 1 Ligjit, afati dhënies në shfrytëzim i pronës së paluajtshme të komunës* )-.

*Qëllimi i dhënies në shfrytëzim të pronës komunale të cekur si më lartë është, funksionalizimi dhe rritja e vlerës dhe përfitimi ekonomik dhe interes publik i Komunës së Malishevës nga pronat komunale, përmes kësaj procedure gjithashtu synon krijimin e mundësive për zhvillim ekonomik, duke krijuar të hyra afatgjate për buxhetin e KK-së, në Malishevë.*

Ju faleminderit për mirëkuptim!

Me respekt,

23.05.2025
02/142

**R E P U B L I K A  E  K O S O V Ë S**
KUVENDI I KOMUNËS NË MALISHEVË

Kuvendi i Komunës
Nr. 02/
Data: 15.05.2025

Kuvendi i Komunës së Malishevës, në bazë të nenit 12 Ligji për Vetëqeverisjen Lokale nr. 03/L-040, neni 4 neni 5 par.5.1 shkronja ( b,d ) neni 12, 17 par. 17.1 shkronja (a, b, e dhe s ) neni 40, Ligj. nr.06/L-092 për Dhënien në shfrytëzim dhe Këmbim të Pronës së Paluajtshme të Komunës, neni 4, 5 neni 6 par. 6.1 pika 1.2, neni 7 par 7.1, neni 8 par.1 pika 1.2, neni 14 par.14.4, Rregullores (QKK)Nr. 09/2020 për Përcaktimin e Procedurave të Dhënies në Shfrytëzim dhe Këmbim të Pronës së Paluajtshme Komunale neni 4, neni 5 par.1 pika 1.3, neni 13 neni 14, Ligjin nr.05/L-031, për Procedurën e Përgjithshme Administrative neni 4, 32, 37,38, 39,40,41,42,49 par.1 pika 1.3, neni 83,neni 84, Vendimin e Kuvendit të Komunës nr.02/484, dt.10.01.2024, miratim paraprak të listës së pronave të paluajtshme të komunës e planifikohen për dhënien në shfrytëzim për vitin 2025, i konfirmuar sipas Konfirmimit të MAPL-së, nr.020/27/11 dt.22.01.2025,

Kuvendi i Komunës së Malishevës, në mbledhje e mbajtur me datë, 15.05.2025, mori këtë,

**V E N D I M**

*Paraprak për dhënin në shfrytëzim afatgjatë të pronës publike komunale, përmes procedurës së shprehjes së interesit,*

1. Kuvendi i Komunës së Malishevës miraton, kërkesën e kryetarit të komunës së nr.01/369, dt.27.03.2025, dhe kërkesën nr.01/523, dt.02.05.2025, për inicimin e procedurës administrative në lidhje me dhënien në shfrytëzim afatgjatë të pronës publike komunale, me qëllim të ushtrimit të aktiviteteve ekonomike dhe interesit publik, përmes procedurës së *shprehjes së interesit*, të pronave sipas specifikave të cekura si më poshtë;

1.1. Parcela me numër të njësisë, P-72310078-01785-2, sipas numrit të lëndës 845/25, zona kadastrale në fshatin Carrallukë, në vendin e quajtur Hija -Hija, sipërfaqe të përgjithshme prej 42311 m$^2$ tokë bujqësore e kualiteti, arë e klasës 5, Zona Kadastrale Carrallukë, pronë publike në emër të Komunës së Malishevës,

-Qëllimi i dhënies në shfrytëzim të pronës komunale të cekur si më lartë është ( *për treg publik dhe qëllime tjera ekonomike në interes publik* ) funksionalizimi dhe rritja e vlerës dhe përfitimi ekonomik dhe interes publik i Komunës nga pronat komunale, përmes kësaj procedure gjithashtu synon krijimin e mundësive për zhvillim ekonomik, duke krijuar të hyra afatgjate për buxhetin e KK-së, në Malishevë-.

1.2. Parcela me numër të njësisë, P-72310049-00303-0, sipas numrit të lëndës 580/25, zona kadastrale në fshatin Shkozë, në sipërfaqe të përgjithshme prej 279291 m$^2$ në vendin e quajtur "*Balli Vneshtëve*" e kualitetit të klasës, kullosë e klasit 5, pronë publike në emër të Komunës së Malishevës,

1.3.Parcela me numër të njësisë P-72310003-00833-2, sipas numrit të njësisë së lëndës 401/25, zona kadastrale në fshatin Bubavec, në sipërfaqe prej 2000 m $^2$ nga sipërfaqja e përgjithshme prej 100000 m$^2$, në vendin e quajtur " Rrezja Jonë " e kualitetit, kullosë e klasit 3, pronë publike në emër të Kuvendit të Komunës së Malishevës.

**Republika e Kosovës**
**Republika Kosova-Republic of Kosovo**
**Qeveria - Vlada – Government**
*Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal*
*Ministarstvo Administracije Lokalne Samouprave*
*Ministry of Local Government Administartion*

| | | |
|---|---|---|
| Për: | Ekrem Kastrati, Kryetar i Komunës së Malishevës<br>Argjend Thaqi, Kryesues i Kuvendit të Komunës së Malishevës | |
| Kopje: | Njësisë për Administrimin e Dokumenteve në MAPL<br>Njësisë për Administrimin e Dokumenteve në Komunë | |
| Përmes: | Elbert Krasniqi, Ministër i MAPL-së<br>Jeton Qela, Sekretar i Përgjithshëm në MAPL | |
| Nga: | Erblin Hetemi, Udhëheqës i Departamentit Ligjor, MAPL | Date: 19.06.2025<br>VI-020-326 |
| Zyrtaret përgjegjës:<br>1. Zyrtari konfirmues i vlerësimit ligjor<br>2. Zyrtari hartues i vlerësimit ligjor | Xhevat Tafa, Udhëheqës i Divizionit për Shqyrtimin e Ligjshmërisë se Akteve të Komunës dhe Akteve të Kryetarit<br>Maltin Shala, Zyrtar i Lartë për Shqyrtimin e Ligjshmërisë së Akteve të Komunës | |
| Lënda: | Konfirmim i ligjshmërisë | |
| Lloji i aktit: | Vendim i Kuvendit të Komunës së Malishevës | |

I nderuar Kryetar,
I nderuar Kryesues,

Në pajtim me nenin 9 të Ligjit Nr. 08/L-284 për Shqyrtimin Administrativ të Akteve të Komunave, Rregulloren e Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr. 10/2019 për Shqyrtimin Administrativ të Akteve të Komunave, si dhe Rregulloren nr. 06/2021 për ndryshim-plotësimin e Rregullores (QRK) Nr. 10/2019, për Shqyrtimin Administrativ të Akteve të Komunave, e në bazë të kompetencave ligjore të ministrisë të përcaktuara me ligjet bazike dhe Rregulloren e Qeverisë Nr. 14/2023 për Fushat dhe Përgjegjësitë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, Departamenti Ligjor dhe Monitorim të Komunave i Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal ka pranuar për shqyrtim të detyrueshëm të ligjshmërisë ashtu siç parashihet me nenin 81 të Ligjit Nr. 03/ L-040 për Vetëqeverisje Lokale aktin komunal në vijim:

| |
|---|
| **Vendimi paraprak Nr. 02/142 për dhënien në shfrytëzim afatgjatë të pronës publike komunale, përmes procedurës së shprehjes së interesit.** |
| I miratuar më datë: 15.05.2025 |
| I parashtruar për shqyrtim në MAPL më datë: 26.05.2025 |

REPUBLIKA E KOSOVËS
KUVENDI I KOMUNËS NË MALISHEVË

PRANUAR MË: 08/03/2024
Nr. 02/121

Kuvendi i Komunës
Nr. 02/___
Datë:29.02.2024

Kuvendi i Komunës së Malishevës, në bazë të nenit 12 Ligji për Vetëqeverisjen Lokale nr. 03/L-040, neni 4 neni 5 par.5.1 shkronja ( b,d ) neni 12, 17 par. 17.1 shkronja (a, b, c dhe s ) neni 40, Ligi, nr.06/L-092 për Dhënien në shfrytëzim dhe Këmbim të Pronës së Paluajtshme të Komunës, neni 4, 5 neni 6 par. 6.1 pika 1.2, neni 7 par 7.1, neni 8 par.1 pika 1.2. neni 14 par.14.4, Rregullores (QRK)Nr. 09/2020 për Përcaktimin e Procedurave të Dhënies në Shfrytëzim dhe Këmbim të Pronës së Paluajtshme Komunale neni 4, neni 5 par.1 pika 1.3, neni 13 neni 14, Ligjin nr.05/L-031, për Procedurën e Përgjithshme Administrative neni 4, 32, 37,38, 3,40,41,42,49 par.1 pika 1.3, neni 83,neni 84, Vendimin e Kuvendit të Komunës nr.02/598, dt.21.12.2023; miratim paraprak të listës së pronave të paluajtshme të komunës ë planifikohen për dhënien në shfrytëzim për vitin 2024, i konfirmuar sipas Konfirmimit të MAPL-së. nr.020/991/4, dt.09.01.2024, Vendimin e Kuvendit të Komunës së Malishevësnr.02/254, dt.19.04.2019, i konfirmuar sipas Vendimit për dhënien e Pëlqimit për miratim të Plani Zhvillimor Komunal të Malishevës 2019-2027, Kuvendi i Komunës së Malishevës, në mbledhje e mbajtur me datë, 29.02.2024, mori këtë;

# VENDIM

Paraprak për dhënin në shfrytëzim afatgjatë të pronës publike komunale, përmes procedurës së shprehjes së interesit;

1. Kuvendi i Komunës së Malishevës miraton, kërkesën e kryetarit të komunës së nr.01/159, dt.12.02.2024, për inicimin e procedurës administrative në lidhje me dhënien në shfrytëzim afatgjatë të pronës publike komunale, me qëllim të ushtrimit të aktiviteteve ekonomike dhe interesit publik, përmes procedurës së *shprehjes së interesit*, të pronave sipas specifikave të cekura si më poshtë;

1.1. Parcela me numër të njësisë, P-7231001-01692-1, sipas numrit të lëndës 275/24, zona kadastrale në fshatin Banjë, në sipërfaqe të përgjithshme prej 5147 m$^2$ në vendin e quajtur "*Bazhlina-Te Bazeni* " e kualitetit të klasës, Kullosë e klasit 2, pronë publike në emër të Komunës së Malishevës, ( *Në ngastrën e cekur si më lartë, gjendet Pishina Publike në fshatin Banjë* ).

1.2. Parcela me numër të njësisë, P-72310047-00894-25, sipas numrit të lëndës 275/24, zona kadastrale Malishevë, në sipërfaqe 1494 m$^2$ në vendin e quajtur "*Mahalla e Hisenajve*" e kualitetit të klasës, kullosë e klasit 3, pronë publike në emër të Komunës së Malishevës dhe Parcela me numër të njësisë P-72310047-00894-26, sipas numrit të lëndës 275/24, zona kadastrale Malishevë, në sipërfaqe prej 2460 m$^2$, në vendin e quajtur "*Mahalla- Hisenajve*" e kualitetit të klasës Kullosë e klasit 3, pronë publike në emër të Komunës së Malishevës.

1.3. Parcela me numër të njësisë, P72310047-00641-102, sipas numrit të lëndës 275/24, zona kadastrale Malishevë, në sipërfaqe 17024 m$^2$, në vendin e quajtur "*Zallina Krshi Vogel*" e kualitetit të klasës, mal i klasit 4, pronë publike në emër të Komunës së Malishevës dhe Parcelën me numër të njësisë P-72310047-00641-6, sipas numrit të lëndës 275/24, zona kadastrale Malishevë, në sipërfaqe prej 1993 m$^2$, në vendin e quajtur " *Zallina -Krshi i Vogël* " e kualitetit të klasës, mal i klasit 4, pronë publike në emër të Komunës së Malishevës, Parcelën me numër të njësisë, P-72310047-00641-7, sipas numrit të lëndës 275/24, zona

kadastrale Malishevë, në sipërfaqe prej 1000 m², në vendin e quajtur " *Zallina -Krshi i Vogel* " e ku
të klasës, mal i klasës 4, pronë publike në emër të Komunës së Malishevës.

1.4. Parcela me numër të njësisë, P-72310047-01046-166, sipas numrit të lëndës 275/24, zona kad Malishevë, në sipërfaqe prej 14614 m², në vendin e quajtur " *Gajrak Breg* " e kualitetit kullosë e k pronë publike në emër të Komunës së Malishevës.

1.5. Parcela me numër të njësisë, P-72310025-00223-672, sipas numrit të lëndës 304/24, zona kada Dragobil, në sipërfaqe prej 21118 m² në vendin e quajtur " Palanka- Golesh " e kualitetit kullosë e kl pronë publike në emër Komunës së Malishevës, Parcelën me numër P-72310025-00223-669, sipas r të lëndës 304/24, zona kadastrale Dragobil,në sipërfaqe prej 10600 m², në vendin e quajtur " Pala Golesh " e kualitetit kullosë e klasit 5, pronë publike në emër të Komunës së Malishevës. Parcelë numër P-72310025-00223-668, sipas numrit të lëndës 304/24, zona kadastrale Dragobil, në sipërfaq 4695 m², në vendin e quajtur " Palanka -Golesh " e kualitetit kullosë e klasit 5, pronë publike në en komunës së Malishevës, Parcelën me numër P-72310025-00223-667, sipas numrit të lëndës 3014/24, kadastrale Dragobil, në sipërfaqe prej 30270 m², në vendin e quajtur " Palanka- Golesh " e kualitetit ku e klasit 5, pronë publike në emër të komunës së Malishevës, Parcelën me numër të njësisë P-72310 00223-687, sipas numrit të lëndës 304/24,zona kadastrale Dragobil, në sipërfaqe 7650 m², në ver quajtur " Palanka -Golesh " e kualitetit kullosë e klasit 5, në emër të Komunës së Malishevës,

1.6. Parcela me numër të njësisë, P-72310015-00466-0, sipas numrit të lëndës 304/24, zona kadas Guriq, në sipërfaqe prej 118782 m², në vendin e quajtur " Polana " e kualitetit kullosë e klasit 5, p publike në emër të Komunës së Malishevës, Parcelën me numër të njësisë P-72310015-00249-0 numë lëndës 304/24, zona kadastrale Guriq, në sipërfaqe prej 53036 m², në vendin e quajtur " Boka "e kuali kullosë e klasit 6, pronë publike në emër të Komunës së Malishevës, Parcelën me numër të njësisë 72310015-00247-0, me numër të lëndës 304/24, zona kadastrale Guriq, në sipërfaqe prej 14883 m vendin e quajtur " Boka " e kualitetit kullosë e klasit 6, në emër të Komunës së Malishevës, Parcelën numër të njësisë P-72310015-00246-0, numri i lëndës 304/24, zona kadastrale Guriq, në sipërfaqe p 59490 m², në vendin e quajtur " Boka " e kualitetit- jo pjellore, në emër të Komunës së Malishevës, Parce me numër të njësisë P-72310015-0242-0 lëndës 304/24, zona kadastrale Guriq, në sipërfaqe prej 15803 në vendin e quajtur " Boka " e kualitetit kullosë e klasit 6, në emër të komunës së Malishevës. Parcelën numër të njësisë P-72310015-00186-0, me numër të lëndës 304/24, zona kadastrale Guriq, në sipërfa prej 13924 m², në vendin e quajtur " Boka " e kualitetit jo pjellore, në emër të Komunës së Malishev Parcelën me numër të njësisë P-72310015-00185-0, me numër të lëndës 304/24, zona kadastrale Guriq, sipërfaqe prej 1240 m² në vendin e quajtur " Boka "e kualitetit jo pjellor, në emër të komunës Malishevës, Parcelën me numër të njësisë P-72310015-00187-0, me numër të lëndës 304/24, zo kadastrale Guriq, në sipërfaqe prej 138838 m², në vendin e quajtur " Boka " në emër të Komunës Malishevës.

1.7. Parcelën me numër të njësisë, P-72310064-00627-1, sipas numrit të lëndës 304/24, zona kadastral Panorc, në sipërfaqe prej 182616 m² në vendin e quajtur " Boka "e kualitetit kullosë e klasës 5, pron publike në emër të Komunës së Malishevës.

1.8. Parcelën me numër të njësisë, P-72310048-01263-0, sipas numrit të lëndës 304/24, zona kadastral Marali, në sipërfaqe prej 95351 m² në vendin e quajtur " Rudine-Rudine " e kualitetit kullosë e klasit 5 pronë publike në emër të Komunës së Malishevës, Parcelën me numër të njësisë P-72310048-01337-0 sipas numrit të lëndës 304/24, zona kadastrale Marali, në sipërfaqe 82139 m² në vendin e quajtur " Rudine-Rudine", e kualitetit kullosë e klasit 5, pronë publike në emër të Komunës së Malishevës.

1.9. Parcela me numër të njësisë, P-72316001-01898-0, sipas numrit të lëndës 8645/24, zona kadastrale Banjë, në sipërfaqe prej 11670, në vendin e quajtur " Gajrak" e kualitetit tokë pyjore mal i klasit 5, pronë publike në emër të Komunës së Malishevës.

2. Afati kohor për dhënien në shfrytëzim afatgjatë të pronës së paluajtshme Komunale të cekur në pikën parë të këtij Vendimi është në kohëzgjatje prej 99 ( nëntëdhjetë e nëntë ) vite .

*3. Qëllimi i dhënies në shfrytëzim te pronës komunale të cekur në pikën 1 te këtij vendimi dhe specifika të cekura si më poshtë, është funksionalizimi dhe përfitimi ekonomik i komunës së Malishevës nga pron komunale përmes procesit konkurrencës së hapur, ku fituesi do të zgjidhet në bazë të kritereve specifikuara në thirrjen e interesit .*

4. Procedura e dhënies në shfrytëzim të pronave të cekur si më lartë, zhvillohet konform nenit 8 par.1 pi 1.2 ( *shprehje të interesit* ) të Ligjit, nr.06/L-092, për dhënien në shfrytëzim dhe këmbimin e pronës paluajtshme të komunës, ndërsa afati ose kohëzgjatja parashihet të jet për 99 vite, konform rregullës paraparë me nenin 6 par.1 pika 1.2, të këtij Ligji, ( *neni 6, par.1 pika 1.2, i Ligjit, afati dhënies në shfrytëz i pronës së paluajtshme të komunës* ).

5. Pronat e paluajtshme në fjalë nuk e ndërrojnë titullarin juridik, pronësia i mbetet Kuvendi Komunal Malishevës, dhe si të tilla ato nuk mund tu jepen personave të tretë në shfrytëzim nga ana e shfrytëzuesit nuk mund të tjetërsohen, nuk mund të jenë objekt i ndonjë barre tatimore, bankare apo çfarëdo ngarke tjetër mbi këto prona pa pëlqimin e pronarit.

7. Ky vendim është paraprak, dhe pas thirrjes publike për shprehjen e interesit, rekomandimit të komisionit vlerësues, do të vendoset nga Kuvendi i Komunës së Malishevës, për procedurën e mëtejme përfundimtare.

8. Pjesë përbërëse e këtij vendimi janë: Kërkesa, skica grafike dhe certifikatat e njësive kadastral Vendimin e Kuvendit për miratimin e planit hapësinorë Vendimi nr.02/254, dt.19.04.2019 si dhe vendimi nr.02/598, dt.21.12.2023, për miratimin paraprak të listës së pronave të paluajtshme të komunës q planifikohen për dhënien në shfrytëzim për vitin 2024.

9. Për zbatimin e këtij vendimi kujdeset kryetari i komunës, përmes drejtorisë për gjeodezi, kadastër.

10. Pas miratimit nga ana e Kuvendit të Komunës së Malishevës, ky vendim hyn në fuqi 15 ditë pa dërgimit në autoritetin mbikëqyrës, konform nenit 81 të Ligjit nr.03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale nenit 8, lidhur me nenin 9 të Rregullores (QRK) nr.10/2019, për shqyrtimin administrativ të akteve t Komunave, dhe 7 ( shtat ) ditë pas shpalljes publike në tabelën e shpalljeve ose ueb-faqen e Komunës.

Vendimi ju dërgohet
1.MAPL-së ,
2.Zyrës së Kryetarit,
3.Arkivit të komunës,

Kryesuesi i Kuvendit
Argjend Thaqi

REPUBLIKA E KOSOVËS
KUVENDI KOMUNËS NË MALISHEVË

Kryetari i Komunës
Nr. 01/___
Datë; 19/02/2026

Nga: Kryetari i Komunës së Malishevës, Ekrem Kastrati

Për: Kuvendin e Komunës së Malishevës

Datë: 19.02.2026

Kopje: Arkivit të komunës.

Lënda: Kërkesë për shqyrtimin dhe marrjen e vendimit për formimin e komisionit të ankesave, konform nenit 18 , të Ligjit nr.06/L-092 për dhënien në shfrytëzim dhe këmbimin e pronës së paluajtshme të Komunës.

Të nderuar anëtarë të kuvendit të komunës së Malishevës,

Me anë të kësaj shkrese kërkojë nga ana e juaj, që të shqyrtoni mundësinë për inicimin e procedurave, marrjes së vendimit për formimin e komisionit të ankesave sipas nenit 18, të Ligjit nr.06/L-092, për dhënien në shfrytëzim dhe këmbimin e pronës së paluajtshme të Komunës.

Ky komision do të veprojë bazuar në autorizimet e ligjit dhe rregulloreve që merren me këtë çështje, përkatësisht do të merren me shqyrtimin e ankesave të palëve të cilat do të mund të parashtrojnë ankesa kundër vendimeve të komisionit vlerësues, në rastet e përzgjedhjes në procedurë të rasteve për dhënien në shfrytëzim afatshkurtër dhe afatgjatë të pronës publike nga Kuvendi i Komunës së Malishevës.

Ky komision sipas ligjit parashihet të ketë pesë ( 5 ) anëtarë, dy ( 2 ) do të caktohen nga Kuvendi i Komunës, dy ( 2 ) kryetari i Komunës dhe një ( 1 ) nga shoqëria civile.
Mandati i këtij komisioni sipas Ligjit është dy ( 2 ) vjeçar, brenda mandatit të Kuvendit të Komunës.

Ju faleminderit për mirëkuptim !

Me respekt,

REPUBLIKA E KOSOVËS
KOMUNAEMALISHEVËS

Kryetari i Komunës
**Nr. 01/___**
Datë; 02/03/2026

Nga: Kryetari i Komunës së Malishevës, Ekrem Kastrati.

Për: Kuvendin e Komunës së Malishevës
Kryesuesit z. Fatmir Ademaj.

Datë: 02.03.2026

Kopje: Arkivit të komunës

Lënda: Kërkesë për shqyrtimin dhe marrjen e vendimit në lidhje me kërkesën e Shoqatës Bamirëse " Jetimat e Ballkanit " për ndryshimin dhe plotësimin e Vendimit të Komunës së Malishevës nr.02/359, dt.11.08.2022.

Të nderuar anëtarë të kuvendit të komunës së Malishevës,

Komuna e Malishevës, me Vendimin nr.02/359, dt.11.08.2022, në pajtim me Ligjin për dhënien në shfrytëzim dhe këmbimin e pronës së paluajtshme të komunës , Ligji nr.06/L-092,dt.07.03.2019, ka iniciuar procedurën për dhënien në shfrytëzim afatgjatë të pronës së paluajtshme të komunës, në sipërfaqe prej 20000 $m^2$ përmes shprehjes së interesit për ndërtimin e Qendrës për persona me nevoja të veçanta " në nivel të Republikës së Kosovës, me lokacion në Komunë e Malishevës.

Me shkresën e MAPL-së, nr.020-742/10, 19.08.2022, konfirmon Vendimin me tekstin " është në pajtim me dispozitat e legjislacionit në fuqi ".

Mirëpo, kjo organizatë bamirëse, " Jetimat e Ballkanit " me seli në fshatin Gjinoc, Komuna e Suharekës, me numër të regjistrimit 5112584-3 dhe me numër fiskal 600322200, me kërkesën nr.01/444, dt.27.02.2026, i është drejtuar kryetarit të komunës, me shkrim për të ndarë hapësirë ( sipërfaqe ) shtesë, për zgjerimin dhe realizimin sa më të mirë të projektit " Qëndrim Ditorë për të moshuar, kuzhinës dhe qendrës për fëmijë me nevoja të veçanta shëndetësore ".

Duke ditur që kuvendi i komunës, është autoritet i vetëm dhe kompetent i autorizuar me ligj, për trajtimin e kësaj kërkese, njëherit ju parashtrojë këtë kërkesë për shqyrtim dhe miratim të mëtejmë.

Dhënia në shfrytëzim do të jetë me qira, ndërsa pronësia do të mbetet Komunës së Malishevës.

Kërkesës ja bashkëngjisim edhe, kopjen e vendimit të kuvendit nr.02/359,dt.11.08.2022, certifikata pronësore, kopjet e planit, kërkesën e shoqatës bamirëse " Jetimat e Ballkanit " si dhe shkresat përcjellëse të MAPL-së, që është konfirmuar vendimi paraprak po ashtu edhe kopjen e certifikatës dhe kopjen e planit ku mund të përfshihet rritja nëse kuvendi merr një vendim të tillë.

Ju faleminderit për mirëkuptim !

Me respekt,

# Republika e Kosovës

Republika Kosova-Republic of Kosovo

*Qeveria - Vlada - Government*

*Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor / Ministarstvo Životne Sredine i Prostornog Planiranja / Ministry of Environment and Spatial Planning*

AGJENCIA KADASTRALE E KOSOVËS / KATASTARSKA AGENCIJA KOSOVA / KOSOVO CADASTRAL AGENCY

# CERTIFIKATË / CERTIFIKAT / CERTIFICATE

## NJËSIA KADASTRALE / KATASTARSKA JEDINICA / CADASTRAL UNIT : P-72310025-00223-686

| | |
|---|---|
| Numri i lëndës / Broj Predmet / Case Referent Number: | 398/26 |
| Data dhe koha e lëshimit / Datum i vreme izdavanja / Date and time of submission: | 02.03.2026 - 12:46 |
| Komuna / Opština / Municipality: | MALISHEVË / MALIŠEVO / MALISHEVË |
| Zona kadastrale / Katastarska Zona / Cadastral Zone: | Dragobil / Dragobilje / Dragobil |
| Zyra Kadastrale Komunale / Opštinska Katastarska Kancelarija / Municipal Cadastral Office: | MALISHEVË / MALIŠEVO / MALISHEVË |

## A. TË DHËNAT PËR NJËSINË KADASTRALE / PODACI O KATASTARSKOJ JEDINICI / CADASTRAL UNIT DATA

| Numri i njësisë kadastrale<br>Broj katastarske jedinice<br>Cad. Unit. No. | Lloji i njësisë<br>Vrsta Jedinice<br>Unit Type | Lloji i pronës<br>Vrsta imovine<br>Property Type | Zona<br>U/R<br>G/S<br>U/R | Sipërfaqja<br>Površina<br>Area<br>(m²) | Përshkrim<br>Opis<br>Description | Krijuar më datën<br>Uradjeno na dan<br>Created On | Azhuruar<br>Ažurirano<br>Updated |
|---|---|---|---|---|---|---|---|
| P-72310025-00223-686 | PARCELË / PARCELA / PARCEL | Pronë shoqërore / Drushtvena Imovina / Socially owned Land | Urban | 172054 | 06-776-2024 | 27.08.2024 | |

## A.1 ADRESA E NJËSISË KADASTRALE / ADRESA KATASTARSKE JEDINICE /CADASTRAL UNIT ADDRESS

| Vendi i quajtur<br>Mesto zvano<br>Called place | Kodi Postal<br>Poštanski Kod<br>Postal Code | Emri i rrugës<br>Naziv ulice<br>Street name | Krijuar më datën<br>Uradjeno na dan<br>Created On | Azhuruar<br>Ažurirano<br>Updated |
|---|---|---|---|---|
| PALANKA-GOLESH | 0 | | | |

Zyrtari përgjegjës / Odgovorno lice / Official person



Printuar nga / Odštampani od / Printed by: Xhevdet.Krasniqi | P-72310025-00223-686 |

## A.2 LLOJI I SHFRYTËZIMIT / VRSTA KORISCENJA / TYPE OF USE

| Numri<br>Broj<br>Number | Lloji i shfrytëzimit të parcelës<br>Vrsta koriscenja parcele<br>Parcel Type Of Use | Shfrytëzimi aktual i parcelës<br>Trenutno koriscenje parcele<br>Parcel Current Use | Kualiteti i klasës<br>Kvalitet klase<br>Quality Class | Sipërfaqja (m²)<br>Površina (m²)<br>Area (m²) |
|---|---|---|---|---|
| 1 | Bujqësore/Poljoprivredno/Agriculture | Kullosat/Pašnjaci/pasture | Kullosë E Klasës 5/Pasnjak 5 Klase/5th Class Pasture | 172054 |

## B. PRONARI/POSEDUESI - VLASNIK/DRŽALAC - OWNER/POSSESSOR

| Të drejtat<br>Prava<br>Rights | Emri<br>Ime<br>Name | Nr. personal<br>Licni broj<br>ID. No. | Vendbanimi<br>Prebivaliste<br>Resident | Kodi postal<br>Poštanski kod<br>Postal code | Hollësitë e adresës<br>Pojedinosti adrese<br>Address details | Pjesa e pronës<br>Deo imovine<br>Share quota | Pershkrimi<br>Opis<br>Description | Azhuruar<br>Ažurirano<br>Updated |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| Posedim individual /<br>Individualna Drzavina /<br>Single possessor | Komuna e Malishevës | 600535259 | / / / | | | 1/1 | Aktvendim Nr.06-239/2012<br>dt.15.06.2012 | 30.08.2024 |

REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA / REPUBLIC OF KOSOVO

QEVERIA E KOSOVËS / VLADA KOSOVA /GOVERNMENT OF KOSOVA

MINISTRIA E MJEDISIT DHE PLANIFIKIMIT HAPËSINOR
MINISTARSTVO ŽIVOTNE SREDINE I PROSTORNOG PLANIRANJA
MINISTRY OF ENVIRONMENT AND SPATIAL PLANNING

AGJENCIA KADASTRALE E KOSOVËS/ KATASTARSKA AGENCIJA KOSOVA/ KOSOVA CADASTRAL AGENCY

## KOPJA E PLANIT / KOPIJA PLANA / COPY PLAN

Zyra Kadastrale Komunale/ Opštinska Katastarska Kancelarija /Municipal Cadastral Office : MALISHEVË

Zona Kadastrale / Katastarska Zona / Cadastral Zone: Dragobil

| Njësia/Jedinica/Unit | Tipi/Vrsta/Type | Sipërfaqja/Površina/Area m² |
|---|---|---|
| P-72310025-00223-686 | Parcelë / Parcela / Parcel | 172054 |




Shkalla/Razmera/Scale: 1:5360

Punoi/Obradio/Created: Armend Krasniqi

Nënshkrimi/Potpis/Signature:

Shënim/Beleška/Note:

Data/ Data/Date: 02.03.2026

Koha/ Vreme/ Time: 12:45:54

Republika e Kosovës

Republika Kosova-Republic of Kosovo

*Qeveria - Vlada - Government*

*Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor / Ministarstvo Životne Sredine i Prostornog Planiranja /*
*Ministry of Environment and Spatial Planning*

AGJENCIA KADASTRALE E KOSOVËS / KATASTARSKA AGENCIJA KOSOVA / KOSOVO CADASTRAL AGENCY

# CERTIFIKATË / CERTIFIKAT / CERTIFICATE

## NJËSIA KADASTRALE / KATASTARSKA JEDINICA / CADASTRAL UNIT : P-72310025-00223-525

| | |
|---|---|
| **Numri i lëndës / Broj Predmet / Case Referent Number:** | 398/26 |
| Data dhe koha e lëshimit / Datum i vreme izdavanja / Date and time of submission: | 02.03.2026 - 12:45 |
| Komuna / Opština / Municipality: | MALISHEVË / MALIŠEVO / MALISHEVË |
| Zona kadastrale / Katastarska Zona / Cadastral Zone: | Dragobil / Dragobilje / Dragobil |
| Zyra Kadastrale Komunale / Opštinska Katastarska Kancelarija / Municipal Cadastral Office: | MALISHEVË / MALIŠEVO / MALISHEVË |

## A. TË DHËNAT PËR NJËSINË KADASTRALE / PODACI O KATASTARSKOJ JEDINICI / CADASTRAL UNIT DATA

| Numri i njësisë kadastrale<br>Broj katastarske jedinice<br>Cad. Unit. No. | Lloji i njësisë<br>Vrsta Jedinice<br>Unit Type | Lloji i pronës<br>Vrsta imovine<br>Property Type | Zona<br>U/R<br>G/S<br>U/R | Sipërfaqja<br>Površina<br>Area<br>(m²) | Përshkrim<br>Opis<br>Description | Krijuar më datën<br>Uradjeno na dan<br>Created On | Azhuruar<br>Ažurirano<br>Updated |
|---|---|---|---|---|---|---|---|
| P-72310025-00223-525 | PARCELË / PARCELA / PARCEL | Pronë shoqërore / Drushtvena Imovina / Socially owned Land | Urban | 20000 | | 29.07.2022 | |

## A.1 ADRESA E NJËSISË KADASTRALE / ADRESA KATASTARSKE JEDINICE /CADASTRAL UNIT ADDRESS

| Vendi i quajtur<br>Mesto zvano<br>Called place | Kodi Postal<br>Poštanski Kod<br>Postal Code | Emri i rrugës<br>Naziv ulice<br>Street name | Krijuar më datën<br>Uradjeno na dan<br>Created On | Azhuruar<br>Ažurirano<br>Updated |
|---|---|---|---|---|
| PALANKA-GOLESH | 0 | | 29.07.2022 | |

Zyrtari përgjegjës / Odgovorno lice / Official person



Printuar nga / Odštampani od / Printed by: Xhevdet.Krasniqi | P-72310025-00223-525 |

## A.2 LLOJI I SHFRYTËZIMIT / VRSTA KORISCENJA / TYPE OF USE

| Numri Broj Number | Lloji i shfrytëzimit të parcelës Vrsta koriscenja parcele Parcel Type Of Use | Shfrytëzimi aktual i parcelës Trenutno koriscenje parcele Parcel Current Use | Kualiteti i klasës Kvalitet klase Quality Class | Sipërfaqja (m²) Površina (m²) Area (m²) |
|---|---|---|---|---|
| 1 | Bujqësore/Poljoprivredno/Agriculture | Kullosat/Pašnjaci/pasture | Kullosë E Klasës 5/Pasnjak 5 Klase/5th Class Pasture | 20000 |

## B. PRONARI/POSEDUESI - VLASNIK/DRŽALAC - OWNER/POSSESSOR

| Të drejtat Prava Rights | Emri Ime Name | Nr. personal Licni broj ID. No. | Vendbanimi Prebivaliste Resident | Kodi postal Poštanski kod Postal code | Hollësitë e adresës Pojedinosti adrese Address details | Pjesa e pronës Deo imovine Share quota | Pershkrimi Opis Description | Azhuruar Ažurirano Updated |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| Posedim individual / Individualna Drzavina / Single possessor | **Komuna e Malishevës** | 600535259 | / / / | | | 1/1 | Aktvendim Nr.01-302 dt.16/02/2012 | 29.07.2022 |

Zyrtari përgjegjës / Odgovorno lice / Official person



Printuar nga / Odštampani od / Printed by: Xhevdet.Krasniqi | P-72310025-00223-525 |

REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA / REPUBLIC OF KOSOVO

QEVERIA E KOSOVËS / VLADA KOSOVA /GOVERNMENT OF KOSOVA

MINISTRIA E MJEDISIT DHE PLANIFIKIMIT HAPËSINOR
MINISTARSTVO ŽIVOTNE SREDINE I PROSTORNOG PLANIRANJA
MINISTRY OF ENVIRONMENT AND SPATIAL PLANNING

AGJENCIA KADASTRALE E KOSOVËS/ KATASTARSKA AGENCIJA KOSOVA/ KOSOVA CADASTRAL AGENCY

# KOPJA E PLANIT / KOPIJA PLANA / COPY PLAN

Zyra Kadastrale Komunale/ Opštinska Katastarska Kancelarija /Municipal Cadastral Office : MALISHEVË

Zona Kadastrale / Katastarska Zona / Cadastral Zone: Dragobil

| Njësia/Jedinica/Unit | Tipi/Vrsta/Type | Sipërfaqja/Površina/Area m² |
|---|---|---|
| P-72310025-00223-525 | Parcelë / Parcela / Parcel | 20000 |




Shkalla/Razmera/Scale: 1:1479

Punoi/Obradio/Created: Armend Krasniqi

Nënshkrimi/Potpis/Signature:

Shënim/Beleška/Note:

Data/ Data/Date: 02.03.2026

Koha/ Vreme/ Time: 12:45:06

SHOQATA BËMIRËSE
JETIMAT E BALLKANIT
Data: 26.02.2026
Lënda: ... Nr.Prot: ...

27/02/2026
01/444

SHOQATA BËMIRËSE
E BALLKANIT

**PER:** Konunen e Malisheves, Kryetarin, Z. Ekrem Kastrati

**NGA:** Shoqata Bamirëse - Jetimat e Ballkanit -, Adresa; Gjinoc, Komuna e Suharekës, NR i REGJISTRIMIT 5112584-3; NR FIS: 600322200

# KËRKESË

I dashur Kryetar Z. Ekrem Kastrati,

Shoqata Bamirëse Jetimat e Ballkanit ka planifikuar zgjerimin e projektit "QËNDRIM DITOR PËR TË MOSHUAR, KUZHINËS HUMANITARE DHE QENDRËS PËR FEMIJË ME NEVOJA TË VEÇANTA SHËNDETSORE" i cili se shpejti fillon te ndertohet sipas memorandumit komune-shoqate te dates 06.10.2025, ky projekt pasi qe ka nje rendesi te madhe per qytetaret e komunes tuaj ju lusim juve qe permes kuvendit komunal per shkak te zgjerimit te projektit te na jepeni parcele-hapesire shtese per zgjerim dhe realizim sa me te mire te projektit do te ishte i mireseradhur miratimi i kerkeses tone.

Projekti eshte me standarte te larta qe eshte model ne rajon dhe me gjere, dhe si i tille ka kete nevoje per zgjerim.

Mbesim me shprese se kerkesa jone do te aprovohet.

Me respekt,

B. Kabashi

Berat Kabashi, Drejtor
JETIMAT E BALLKANIT

**Datë:** 26.02.2026

REPUBLIKA E KOSOVËS
KUVENDI I KOMUNËS NË MALISHEVË

Kuvendi i Komunës
Nr. 02/359
Datë: 11.08.2022

Në bazë të nenit 11, nenit 12 paragrafi 2 shkronja (d), nenit 17 dhe 40, të Ligjit Nr.03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale, "Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës" Nr.28/15, qershor 2008", mbështetur në nenin 4,5, nenin 6 paragrafi 1 pika 1.2, nenin 8 paragrafi 1 pika 1.1,1.2, nenin 14 paragrafi 1 dhe 2, të Ligjit Nr.06/L-092 për Dhënien në Shfrytëzim dhe Këmbimin e Pronës së Paluajtshme të Komunës "Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës nr.10/03, Prill 2019", në bazë të nenit 5 paragrafi 1, pika 1.3, nenit 8,9,10, të Rregullores (QRK) Nr.09/2020, për përcaktimin e procedurave të dhënies në shfrytëzim dhe këmbimin e pronës se paluajtshme të Komunës, në bazë të nenit 10, nenit 19, nenit 46, Statutit të Komunës së Malishevës Nr.01/871 të datës:12.11.2008, Kuvendi i Komunës së Malishevës në mbledhjen e mbajtur me datë: 09.08.2022 merr këtë:

# VENDIM
# PËR INICIMIN E PROCEDURAVE PËR DHËNIEN NË SHFRYTËZIM AFATGJATË TË PRONËS SË PALUAJTSHME TË KOMUNËS

1. Miratohet propozimi Nr.01/1223 i datës: 09.08.2022 i parashtruar nga kryetari i Komunës, për miratim paraprak për dhënien në shfrytëzim afatgjatë të pronës se paluajtshme të Komunës, përmes shprehjes së interesit, për ndërtimin e "Qendrës për persona me nevoja të veçanta" në nivel të Republikës së Kosovës.

2. Prona e paluajtshme për dhënien në shfrytëzim afatgjatë, e cekur si në pikën 1 të këtij vendimi është në Z.K Dragobil në vendin e quajtur "Palanka-Golesh" e evidentuar sipas certifikatës së pronësisë Nr. P-72310025-00223-525, në sipërfaqe të përgjithshme prej 20000m² me kulturë kullosë e klasës 5, në emër të Komunës së Malishevës.

3. Qëllimi i dhënies në shfrytëzim afatgjatë të pronës publike përmes shprehjes së interesit është ngase në të njëjtin lokacion, Komuna planifikon të ndërtojë "Qendrën për persona me nevoja të veçanta" në nivel të Republikës së Kosovës.

4. Obligohet Komisioni për vlerësimin e ofertave që në pajtim me nenin 15 dhe nenit 19 paragrafi 3, të Ligjit Nr.06/L-092 për dhënien në shfrytëzim dhe këmbimin e pronës së paluajtshme të Komunës dhe Rregulloren (QRK) Nr.09/2020, për përcaktimin e procedurave të dhënies në shfrytëzim dhe këmbimin e pronës se paluajtshme të Komunës, t'i kryejnë procedurat e njoftimit publik për dhënie në shfrytëzim afatgjatë dhe pas përfundimit të afatit për shqyrtimin e ankesave e procedon në Kuvendin e Komunës për aprovim ofertën e përzgjedhur.

5. Afati kohor për dhënien në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të Komunës caktohet të jetë afatgjatë për nëntëdhjetë e nëntë (99) vite, ndërsa çmimi minimal i qirasë për shfrytëzimit të lokacionit të lartcekur do të jetë në shumën prej 2€ (dy euro) qira vjetore.

6. Mënyra dhe kushtet e shfrytëzimit të pronës së paluajtshme do të përcaktohen me kontratë e cila lidhet dhe nënshkruhet në mes të kryetarit të Komunës dhe përfaqësuesit të shfrytëzuesit.

7. Mënyra e shfrytëzimit dhe menaxhimit të lokacionit të përcaktuar me ketë vendim, do të rregullohet sipas procedurave të parapara ligjore.

8. Për zbatimin e këtij vendimi përkujdeset kryetari i Komunës, përmes organeve tjera kompetente.

9. Pas miratimit nga ana e Kuvendit të Komunës së Malishevës, ky vendim hyn në fuqi 15 ditë pas dërgimit në autoritetin mbikëqyrës, në kuptim të nenit 81 të Ligjit nr.03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale, "Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës Nr.28/2008", nenit 8, lidhur me nenin 9 të Rregullores (QRK) Nr.10/2019, për Shqyrtimin Administrativ të Akteve të Komunave, e ndryshuar dhe plotësuar me Rregulloren (QRK) Nr.06/2021 dhe pas shpalljes në ueb-faqen e Komunës.

Kryesuesi i Kuvendit
Argjend Thaçi

Vendimi ju dërgohet:
Arkivit të Komunës
MAPL-së
Drejtorive të KK-së.

REPUBLIKA E KOSOVËS
KUVENDI KOMUNËS NË MALISHEVË

Kryetari i Komunës
**Nr. 01/___**
Datë; 08/08/2022

| | |
|---|---|
| Nga: | Kryetari i Komunës së Malishevës, Ekrem Kastrati. |
| Për: | Kuvendin e Komunës së Malishevës<br>Kryesuesit z.Argjend Thaçi. |
| Datë: | 08.08.2022 |
| Kopje: | Arkivit të komunës |
| Lënda: | Propozim për miratim paraprak, për dhënien në shfrytëzim afatgjatë të pronës publike, përmes shprehjes së interesit, të pjesës së ngastrës kadastrale, P-72310025-00223-525, në vendin e quajtur "Palanka -Golesh", ZK-Dragobil, KK-Malishevës. |

Të nderuar anëtarë të kuvendit të komunës së Malishevës,

Bazuar në Ligjin nr.06/L-092, për dhënien në shfrytëzim dhe këmbimin e pronës së paluajtshme të komunës, neni 4, 5 dhe neni 6 , neni 8 par.8.1 pika 1.2 dhe neni 14, paraqes këtë propozim për miratim paraprak, për dhënien në shfrytëzim afatgjatë përmes shprehjes së interesit, të pronës publike në sipërfaqe prej 20000 m $^2$ e cila gjendet në pjesën e ngastrës, P-72310025-00223-525, në vendin e quajtur " Palanka - Golesh", ZK-Dragobil, KK-Malishevës.

-Ky organ propozon që afati i dhënies në shfrytëzim afatgjatë të pronës publike përmes shprehjes së interesit, të jetë 99 vjetë, megjithatë mbetet në autoritetin tuaj për vendimarrje. -

Qëllimi i dhënies në shfrytëzim afatgjatë të pronës publike, përmes shprehjes së interesit, është ngase në të njëjtin lokacion komuna planifikon të ndërtojë, " **Qendrën për persona me nevoja të veçanta** " në nivel të Republikë së Kosovës.

Realizimi i këtij projekti do të bëhet përmes donatorëve, ku të drejtat dhe detyrimet do të specifikohen me kontratë, pas miratimit tuaj përfundimtarë !

Pjesë e kësaj shkrese është edhe kopja e certifikatës pronësore, kopja e planit të pronës që është planifikuar për dhënë në shfrytëzim afatgjatë, për qëllimin e cekur.

Ju faleminderit për mirëkuptim !

Me respekt,

09.08.2022

REPUBLIKA E KOSOVËS
KUVENDI KOMUNËS NË MALISHEVË

01/1223

Kryetari i Komunës
**Nr. 01/___**
Datë; 08/08/2022

| | |
|---|---|
| Nga: | Kryetari i Komunës së Malishevës, Ekrem Kastrati. |
| Për: | Kuvendin e Komunës së Malishevës<br>Kryesuesit z.Argjend Thaçi. |
| Datë: | 08.08.2022 |
| Kopje: | Arkivit të komunës |
| Lënda: | Propozim për miratim paraprak, për dhënien në shfrytëzim afatgjatë të pronës publike, përmes shprehjes së interesit, të pjesës së ngastrës kadastrale, P-72310025-00223-525, në vendin e quajtur "Palanka -Golesh", ZK-Dragobil, KK-Malishevës. |

Të nderuar anëtarë të kuvendit të komunës së Malishevës,

Bazuar në Ligjin nr.06/L-092, për dhënien në shfrytëzim dhe këmbimin e pronës së paluajtshme të komunës, neni 4, 5 dhe neni 6 , neni 8 par.8.1 pika 1.2 dhe neni 14, paraqes këtë propozim për miratim paraprak, për dhënien në shfrytëzim afatgjatë përmes shprehjes së interesit, të pronës publike në sipërfaqe prej 20000 $m^2$ e cila gjendet në pjesën e ngastrës, P-72310025-00223-525, në vendin e quajtur " Palanka - Golesh", ZK-Dragobil, KK-Malishevës.

-Ky organ propozon që afati i dhënies në shfrytëzim afatgjatë të pronës publike përmes shprehjes së interesit, të jetë 99 vjetë, megjithatë mbetet në autoritetin tuaj për vendimarrje. -

Qëllimi i dhënies në shfrytëzim afatgjatë të pronës publike, përmes shprehjes së interesit, është ngase në të njëjtin lokacion komuna planifikon të ndërtojë, " **Qendrën për persona me nevoja të veçanta** " në nivel të Republikë së Kosovës.

Realizimi i këtij projekti do të bëhet përmes donatorëve, ku të drejtat dhe detyrimet do të specifikohen me kontratë, pas miratimit tuaj përfundimtarë !

Pjesë e kësaj shkrese është edhe kopja e certifikatës pronësore, kopja e planit të pronës që është planifikuar për dhëne në shfrytëzim afatgjatë, për qëllimin e cekur.

Ju faleminderit për mirëkuptim !

Me respekt,

Republika e Kosovës

Republika Kosova-Republic of Kosovo

*Qeveria - Vlada - Government*

*Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës / Ministarstvo Životne Sredine, Prostornog Planiranja i Infrastrukture / Ministry of Environment, Spatial Planning and Infrastructure*

AGJENCIA KADASTRALE E KOSOVËS / KATASTARSKA AGENCIJA KOSOVA / KOSOVO CADASTRAL AGENCY

# CERTIFIKATË / CERTIFIKAT / CERTIFICATE

## NJËSIA KADASTRALE / KATASTARSKA JEDINICA / CADASTRAL UNIT : P-72310025-00223-525

| | |
|---|---|
| Numri i lëndës / Broj Predmet / Case Referent Number: | 06-486-2022 |
| Data dhe koha e lëshimit / Datum i vreme izdavanja / Date and time of submission: | 29.07.2022 - 16:05 |
| Komuna / Opština / Municipality: | MALISHEVË / MALIŠEVO / MALISHEVË |
| Zona kadastrale / Katastarska Zona / Cadastral Zone: | Dragobil / Dragobilje / Dragobil |
| Zyra Kadastrale Komunale / Opštinska Katastarska Kancelarija / Municipal Cadastral Office: | MALISHEVË / MALIŠEVO / MALISHEVË |

## A. TË DHËNAT PËR NJËSINË KADASTRALE / PODACI O KATASTARSKOJ JEDINICI / CADASTRAL UNIT DATA

| Numri i njësisë kadastrale<br>Broj katastarske jedinice<br>Cad. Unit. No. | Lloji i njësisë<br>Vrsta Jedinice<br>Unit Type | Lloji i pronës<br>Vrsta imovine<br>Property Type | Zona<br>U/R<br>G/S<br>U/R | Sipërfaqja<br>Površina<br>Area<br>($m^2$) | Përshkrim<br>Opis<br>Description | Krijuar më datën<br>Uradjeno na dan<br>Created On | Azhuruar<br>Ažurirano<br>Updated |
|---|---|---|---|---|---|---|---|
| P-72310025-00223-525 | PARCELË / PARCELA / PARCEL | Pronë shoqërore / Drushtvena Imovina / Socially owned Land | Urban | 20000 | | 29.07.2022 | |

## A.1 ADRESA E NJËSISË KADASTRALE / ADRESA KATASTARSKE JEDINICE /CADASTRAL UNIT ADDRESS

| Vendi i quajtur<br>Mesto zvano<br>Called place | Kodi Postal<br>Poštanski Kod<br>Postal Code | Emri i rrugës<br>Naziv ulice<br>Street name | Krijuar më datën<br>Uradjeno na dan<br>Created On | Azhuruar<br>Ažurirano<br>Updated |
|---|---|---|---|---|
| PALANKA-GOLESH | | | 29.07.2022 | |

Zyrtari përgjegjës / Odgovorno lice / Official person



Printuar nga / Odštampani od / Printed by: Fitim Sertolli | P-72310025-00223-525 |

## A.2 LLOJI I SHFRYTËZIMIT / VRSTA KORISCENJA / TYPE OF USE

| Numri<br>Broj<br>Number | Lloji i shfrytëzimit të parcelës<br>Vrsta koriscenja parcele<br>Parcel Type Of Use | Shfrytëzimi aktual i parcelës<br>Trenutno koriscenje parcele<br>Parcel Current Use | Kualiteti i klasës<br>Kvalitet klase<br>Quality Class | Sipërfaqja (m²)<br>Površina (m²)<br>Area (m²) |
|---|---|---|---|---|
| 1 | Bujqësore/Poljoprivredno/Agriculture | Kullosat/Pašnjaci/pasture | Kullosë E Klasës 5/Pasnjak 5 Klase/5th Class Pasture | 20000 |

## B. PRONARI/POSEDUESI - VLASNIK/DRŽALAC - OWNER/POSSESSOR

| Të drejtat<br>Prava<br>Rights | Emri<br>Ime<br>Name | Nr. personal<br>Licni broj<br>ID. No. | Vendbanimi<br>Prebivaliste<br>Resident | Kodi postal<br>Poštanski kod<br>Postal code | Hollësitë e adresës<br>Pojedinosti adrese<br>Address details | Pjesa e pronës<br>Deo imovine<br>Share quota | Pershkrimi<br>Opis<br>Description | Azhuruar<br>Ažurirano<br>Updated |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| Posedim individual / Individualna Drzavina / Single possessor | Komuna e Malishevës | 600535259 | / / / | | | 1/1 | Aktvendim Nr.01-302 dt.16/02/2012 | 29.07.2022 |

REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA / REPUBLIC OF KOSOVO

QEVERIA E KOSOVËS / VLADA KOSOVA /GOVERNMENT OF KOSOVA

MINISTRIA E MJEDISIT, PLANIFIKIMIT HAPËSINOR DHE INFRASTRUKTURËS
MINISTARSTVO ŽIVOTNE SREDINE, PROSTORNOG PLANIRANJA I INFRASTRUKTURE
MINISTRY OF ENVIRONMENT, SPATIAL PLANNING AND INFRASTRUCTURE

AGJENCIA KADASTRALE E KOSOVËS/ KATASTARSKA AGENCIJA KOSOVA/ KOSOVA CADASTRAL AGENCY

## KOPJA E PLANIT / KOPIJA PLANA / COPY PLAN

Zyra Kadastrale Komunale/ Opštinska Katastarska Kancelarija /Municipal Cadastral Office : MALISHEVË
Zona Kadastrale / Katastarska Zona / Cadastral Zone: Dragobil

| Njësia/Jedinica/Unit | Tipi/Vrsta/Type | Sipërfaqja/Površina/Area m² |
|---|---|---|
| P-72310025-00223-525 | Parcelë / Parcela / Parcel | 20000 |




Shkalla/Razmera/Scale: 1:1479

Punoi/Obradio/Created:
Data/ Data/Date: 29.07.2022
Koha/ Vreme/ Time: 04:06:57
Nënshkrimi/Potpis/Signature:
Shënim/Beleška/Note:

Aprovoi/Usvojio/Aproved: Drejtori/Direktor/Director

Nënshkrimi/Potpis/Signature: ____________________

Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

*Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal*
*Ministarstvo Administracije Lokalne Samouprave*
*Ministry of Local Government Administration*

| | |
|---|---|
| Për: | **Ekrem Kastrati**, Kryetar i Komunës së Malishevës<br>**Argjend Thaqi**, Kryesues i Kuvendit të Komunës së Malishevës |
| Kopje: | Njësisë për Administrimin e Dokumenteve në MAPL<br>Njësisë për Administrimin e Dokumenteve në Komunë |
| Përmes: | **Elbert Krasniqi**, Minister i MAPL-së<br>**Venera Çerkini**, Zv. Sekretare e Përgjithshme e MAPL-së |
| Nga: | **Besim Myrtezani**, Zv. Udhëheqës i Departamentit Ligjor dhe Monitorim të Komunave |
| Zyrtarët përgjegjës:<br>1. Zyrtari konfirmues i vlerësimit ligjor<br>2. Zyrtari hartues i vlerësimit ligjor | **Xhevat Tafa**, Udhëheqës i Divizionit për Monitorim të Komunave<br>Kujtim Aliu, Zyrtar i Lartë Ligjor |
| Lënda: | Shqyrtim i ligjshmërisë e aktit të Kuvendit të Komunës |
| Lloji i aktit: | Vendim |

Date: 16.08.2022
Nr. 020-702

I/e nderuar Kryetar,
I/e nderuar Kryesues,

Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal në mbështetje të nenit 81.4 të Ligjit Nr. 03/L-040 për Vetëqeverisje Lokale, Rregulloren e Qeverisë Nr. 02/2021 për Fushat dhe Përgjegjësitë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, si dhe Rregulloren nr. 06/2021 për ndryshim-plotësimin e Rregullores (QRK)nr. 10/2019, për Shqyrtimin Administrativ të Akteve të Komunave, MAPL, me datë 12.08.2022 ka pranuar për vlerësim të ligjshmërisë së Vendimit nr. 02/359 për inicimin e procedurave për dhënien në shfrytëzim afatgjatë të pronës së paluajtshme të komunës, të datës 09.08.2022 të miratuar nga kuvendi i komunës së Malishevës.

Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal (MAPL), ka bërë shqyrtimin e ligjshmërisë së aktit në fjalë, dhe:

KONFIRMON

Vendimi nr. 02/359 për inicimin e procedurave për dhënien në shfrytëzim afatgjatë të pronës së paluajtshme të komunës, *është në pajtim* me dispozitat e legjislacionit në fuqi.

Arsyetim

Kuvendi i Komunës së Malishevës në mbledhjen e mbajtur me datë 09.08.2022, ka miratuar Vendimit nr. 02/359 për inicimin e procedurave për dhënien në shfrytëzim afatgjatë të pronës së paluajtshme të komunës.

MAPL, konstaton së vendimi i nxjerrë nga Kuvendi i Komunës së Malishevës është bazuar në Nenin 11, nenin 12, paragrafi 2, shkronja d), neni 17 dhe 40 të Ligjit nr 03/L-040, për Vetqeverisje Lokale, nenin 4,5 dhe 6 paragrafi 1 pika 1.2, nenin 8 paragrafin 1 pika 1.1, 1.2, nenin 14 paragrafin 1 dhe 2 të Ligjit Nr. 06/L-092 për dhënien në shfrytëzim dhe këmbim të pronës së paluajtshme komunale. *Vendimi është miratuar në mbledhjen e Kuvendit të Komunës së Malishevës me datë 09.08.2022.*

Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal, mbetet në dispozicion të komunës për çfarëdo sqarimi të mëtejmë lidhur me këtë vlerësim.

**REPUBLIKA E KOSOVËS**
KOMUNA E MALISHEVËS

Kryetari i Komunës
Nr. 01/____
Datë: 03.03.2026

Nga: Kryetari i Komunës së Malishevës, Ekrem Kastrati.

Për: Kuvendin e Komunës së Malishevës.
Kryesuesit z.Fatmir Ademaj.

Datë: 03.03.2026.

Kopje: Arkivit të Komunës.

Lënda: Kërkesë për shqyrtim dhe miratim të listës së pronave të paluajtshme të komunës së Malishevës, për dhënie në shfrytëzim gjatë vitit 2026.

Të nderuar anëtarë të Kuvendit të Komunës së Malishevës,

Duke vepruar në pajtim me Ligjin nr. 06/L-092 për dhënien në shfrytëzim dhe këmbimin e pronës së paluajtshme të komunës, konkretisht nenin 13, si dhe në bazë të shkresës nr. 463/23, datë 09.01.2026, me lëndë "Publikimi i pronave komunale për dhënie në shfrytëzim", të dërguar nga Ministria për Administrimin e Pushtetit Lokal, ju paraqesim për shqyrtim dhe miratim listën e pronave publike të përpiluar nga Drejtoria për Gjeodezi dhe Kadastër.

Kërkojmë miratimin e kësaj liste nga Kuvendi i Komunës së Malishevës, në mënyrë që të krijohen kushtet ligjore për vazhdimin e procedurave administrative për dhënien në shfrytëzim afatshkurtër dhe afatgjatë të pronave publike, sipas listës së bashkëngjitur.

Pas miratimit të kësaj liste dhe konfirmimit të ligjshmërisë nga organet e autorizuara ligjore (MAPL), do t'ju paraqesim propozimet për secilën pronë veç e veç dhe, varësisht nga shqyrtimi dhe miratimi juaj, do të vazhdohet më tutje konform autorizimeve ligjore në fuqi.

Kësaj kërkese i bashkëngjisim:

- Kërkesën zyrtare nr. 06/46, datë 26.02.2026;
- Listën e pronave të përgatitur nga Drejtoria për Gjeodezi dhe Kadastër, e cila fillon me numrin rendor një (1) dhe përfundon me numrin rendor dyqind e pesëdhjetë e katër (254);
- Kopjen e shkresës së MAPL-së.

Ju faleminderit për mirëkuptimin tuaj.

Me respekt,

ZYRA E PROTOKOLLIT
Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal
Ministarstvo Lokalne Samouprave
Ministry of Local Government Administration
463-23
09.01.2026

# Republika e Kosovës
## Republika Kosova-Republic of Kosovo
## Qeveria - Vlada - Government
*Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal*
*Ministarstvo Administracije Lokalne Samouprave*
*Ministry of Local Government Administration*

*Prishtinë, 09.01.2026*

Për: Kryetarët e Komunave të Republikës së Kosovës /Kryesuesit e Kuvendit të Komunave

**LËNDA:** Publikimi i pronave komunale për dhënie në shfrytëzim

Të nderuar/a,

Ligji Nr. 06/1-092 për Dhënien në Shfrytëzim dhe Këmbimin e Pronës së Paluajtshme të Komunës, përcakton procedurat dhe format për dhënien në shfrytëzim dhe këmbim të pronës së paluajtshme të komunës, si dhe procedurat e bartjes së pronave të paluajtshme të cilat administrohen nga Institucionet Qendrore.

Bazuar në Nenin 13 paragrafi 1 dhe 2 të Ligjit Nr.06/1-092 për Dhënien në Shfrytëzim dhe Këmbimin e Pronës së Paluajtshme si dhe nenin 6 të Rregullores (QRK) nr. 09/2020 për Përcaktimin e Procedurave të Dhënies në Shfrytëzim dhe Këmbim e Pronës së Paluajtshme, komunat janë të obliguara të publikojnë në Ueb-faqe të Komunës, listën e përgjithshme të pronave të paluajtshme të komunës si dhe listën e veçantë të pronave që planifikohen për dhënie në shfrytëzim për vitin vijues, duke arsyetuar interesin publik dhe zhvillimin ekonomik të komunës.

Mbajtja e zgjedhjeve lokale më 12.10.2025 dhe konstituimi i organeve komunale në fund të vitit kalendarik, u ka pamundësuar komunave planifikimin dhe publikimin me kohë të listave të pronave komunale të cilat do të duhet të ipen në shfrytëzim për vitin 2026. Marr parasysh këtë rrethanë, Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal, përmes kësaj shkrese cakton afat shtesë për publikimin e listës së pronave për dhënie në shfrytëzim.

Afati për publikimin e listës së përgjithshme të pronave të paluajtshme të komunës si dhe listën e veçantë të pronave që planifikohen për dhënien në shfrytëzimpër këtë vit mund ta bëjnë deri me 31.03.2026. Çdo proces për dhënien në shfrytëzim, për pronat e pa publikuara dhe për pronat e publikuara pas këtij afati nga Ministira e Administrimit të Pushtetit Lokal do të vlerësohen jo legjitime.

Me respekt,

Elbert Krasniqi

*Minister i MAPL-së*

**Kopje:** *Jeton Qela, Sekretar i Përgjithshëm i MAPL-së*
*Arkivit të MAPL-së.*

**Republika e Kosovës**
Republic of Kosovo
**Komuna e Malishevës**
Municipality of Malisevo

| | |
|---|---|
| PËR: | Kuvendin Komunal Malishevë<br>Komitetin për Politikë dhe Financa - KPF |
| NGA: | Drejtoria për Gjeodezi Kadastër<br>Drejtori – Rifat Mazreku |
| CC: | Kryetarit të Komunës së Malishevës<br>Z.Ekrem Kastrati |
| TEMA: | Kërkesë për shqyrtimin dhe miratimin e listës së pronave të paluajtshme të komunës |
| DATA: | 26.02.2026 |

Bazuar në nenin 13 të Ligjit Nr.06/L-92 për Dhënien në Shfrytëzim dhe Këmbimin e Pronës së Paluajtshme, neni 6 i Rregullorës (QRK) Nr.09/2020 për Përcaktimin e Procedurave për Dhënien në Shfrytëzim dhe Këmbimin e Pronës së Paluajtshme të Komunës, komunat duhet që ta miratojnë dhe publikojnë listën e përgjithshme të pronave të paluajtshme të komunës si dhe listën e veçantë të pronave të paluajtshme që planifikohen për dhënien në shfrytëzim.

Prandaj, Drejtoria për Gjeodezi dhe Kadastër– konform dispozitave të sipërshënuara paraqet listën e pronave të paluajtshme për dhënien në shfrytëzim afatshkurtër dhe afatgjatë.

**Qëllimi**

- Rritja e vlerës së pronës komunale, zhvillimi ekonomik dhe rritja e të hyrave vetanake.

**Destinimi**

- Pronat e publikuara do të shfyrtëzohen për veprimtari të ndryshme bujqësore, prodhuese, afariste, rekreacion, si dhe veprimtari tjera varësisht prej interesit të komunës e po ashtu edhe prej kërkesave.

Procedurat e dhënies në shfrytëzim të pronës së paluajtshme për secilen pronë brenda kësaj liste, do të zhvillohen sipas dispozitave të Ligjit Nr.06/L-92 për Dhënien në Shfrytëzim dhe Këmbimin e Pronës së Paluajtshme dhe Rregullores (QRK) Nr.09/2020 për Përcaktimin e Procedurave për Dhënien në Shfrytëzim dhe Këmbimin e pronës së Paluajtshme të Komunës.

Ndërlidhur me këtë shkresë keni listen e veçantë dhe të përgjithshme me pronat e paluajtshme të komunës.

Lista e veçantë e pronave të paluajtshme

| Nr. | Nr. Parceles | Sipërfaqja $m^2$ | Zona Kadastrale | Pronësia |
|---|---|---|---|---|
| 1 | P-72310001-01027-1 | 4975 | Balincë | Komuna e Malishevës |
| 2 | P-72310001-00545-1 | 3032 | Balincë | Komuna e Malishevës |
| 3 | P-72310003-00833-2 | 100000 | Bubavec | Komuna e Malishevës |
| 4 | P-72310003-00833-3 | 30000 | Bubavec | Komuna e Malishevës |
| 5 | P-72310003-00833-4 | 65081 | Bubavec | Komuna e Malishevës |
| 6 | P-72310003-00833-5 | 13542 | Bubavec | Komuna e Malishevës |
| 7 | P-72310012-00394-0 | 28535 | Vërmicë | Komuna e Malishevës |
| 8 | P-72310025-00223-525 | 20000 | Dragobil | Komuna e Malishevës |
| 9 | P-72310025-00223-664 | 73422 | Dragobil | Komuna e Malishevës |
| 10 | P-72310025-00223-666 | 27250 | Dragobil | Komuna e Malishevës |
| 11 | P-72310025-00223-667 | 30270 | Dragobil | Komuna e Malishevës |
| 12 | P-72310025-00223-668 | 4695 | Dragobil | Komuna e Malishevës |
| 13 | P-72310025-00223-669 | 10600 | Dragobil | Komuna e Malishevës |
| 14 | P-72310025-00223-672 | 21118 | Dragobil | Komuna e Malishevës |
| 15 | P-72310025-00223-674 | 80200 | Dragobil | Komuna e Malishevës |
| 16 | P-72310025-00223-684 | 172954 | Dragobil | Komuna e Malishevës |
| 17 | P-72310025-00304-0 | 20861 | Dragobil | Komuna e Malishevës |
| 18 | P-72310025-00408-1 | 62628 | Dragobil | Komuna e Malishevës |
| 19 | P-72310025-00408-2 | 20000 | Dragobil | Komuna e Malishevës |
| 20 | P-72310025-00223-687 | 7650 | Dragobil | Komuna e Malishevës |
| 21 | P-72310025-00223-688 | 29784 | Dragobil | Komuna e Malishevës |
| 22 | P-72310025-00223-679 | 900 | Dragobil | Komuna e Malishevës |
| 23 | P-72310025-00299-0 | 45846 | Dragobil | Komuna e Malishevës |
| 24 | P-72310045-00145-0 | 11975 | Maxharrë | Komuna e Malishevës |
| 25 | P-72310047-00641-6 | 1993 | Malishevë | Komuna e Malishevës |
| 26 | P-72310047-00641-7 | 1000 | Malishevë | Komuna e Malishevës |
| 27 | P-72310047-00641-102 | 17024 | Malishevë | Komuna e Malishevës |
| 28 | P-72310047-00641-99 | 41737 | Malishevë | Komuna e Malishevës |
| 29 | P-72310047-00894-25 | 1494 | Malishevë | Komuna e Malishevës |
| 30 | P-72310047-00894-26 | 2460 | Malishevë | Komuna e Malishevës |
| 31 | P-72310047-00894-27 | 2200 | Malishevë | Komuna e Malishevës |
| 32 | P-72310047-00894-28 | 10345 | Malishevë | Komuna e Malishevës |
| 33 | P-72310047-01046-166 | 14614 | Malishevë | Komuna e Malishevës |
| 34 | P-72310047-01004-998 | 14323 | Malishevë | Komuna e Malishevës |
| 35 | P-72316001-01692-1 | 5147 | Banjë | Komuna e Malishevës |
| 36 | P-72316001-01898-0 | 11670 | Banjë | Komuna e Malishevës |
| 37 | P-72316001-01536-1 | 388 | Banjë | Komuna e Malishevës |
| 38 | P-72316001-01534-1 | 1407 | Banjë | Komuna e Malishevës |
| 39 | P-72316001-01535-0 | 138 | Banjë | Komuna e Malishevës |

| | | | | |
|---|---|---|---|---|
| 40 | P-72310078-01785-2 | 42311 | Carrallukë | Komuna e Malishevës |
| 41 | P-72310050-01025-15 | 38664 | Mirushë | Komuna e Malishevës |
| 42 | P-72310050-01025-20 | 14459 | Mirushë | Komuna e Malishevës |
| 43 | P-72310037-01262-0 | 3268 | Kijevë | Komuna e Malishevës |
| 44 | P-72310060-00825-0 | 4823 | Pagarushë | Komuna e Malishevës |
| 45 | P-72310064-00627-1 | 182616 | Panorc | Komuna e Malishevës |

Lista e përgjithshme e pronave të paluajtshme

| Nr. | Nr. Parceles | Sipërfaqja $m^2$ | Zona Kadastrale | Pronësia |
|---|---|---|---|---|
| 1 | P-72310001-00055-0 | 2030 | Balincë | Komuna e Malishevës |
| 2 | P-72310001-00292-0 | 25249 | Balincë | Komuna e Malishevës |
| 3 | P-72310001-00301-0 | 3725 | Balincë | Komuna e Malishevës |
| 4 | P-72310001-00388-0 | 4581 | Balincë | Komuna e Malishevës |
| 5 | P-72310001-00426-0 | 9576 | Balincë | Komuna e Malishevës |
| 6 | P-72310001-00448-1 | 1574 | Balincë | Komuna e Malishevës |
| 7 | P-72310001-00457-1 | 2737 | Balincë | Komuna e Malishevës |
| 8 | P-72310001-00457-2 | 1057 | Balincë | Komuna e Malishevës |
| 9 | P-72310001-00458-0 | 585 | Balincë | Komuna e Malishevës |
| 10 | P-72310001-00501-0 | 1140 | Balincë | Komuna e Malishevës |
| 11 | P-72310001-00580-1 | 1884 | Balincë | Komuna e Malishevës |
| 12 | P-72310001-00580-2 | 1473 | Balincë | Komuna e Malishevës |
| 13 | P-72310001-00744-0 | 3418 | Balincë | Komuna e Malishevës |
| 14 | P-72310001-00880-0 | 800 | Balincë | Komuna e Malishevës |
| 15 | P-72310001-00970-1 | 15060 | Balincë | Komuna e Malishevës |
| 16 | P-72310001-00970-2 | 1071 | Balincë | Komuna e Malishevës |
| 17 | P-72310001-00982-0 | 550 | Balincë | Komuna e Malishevës |
| 18 | P-72310001-00983-0 | 2112 | Balincë | Komuna e Malishevës |
| 19 | P-72310001-00994-0 | 2850 | Balincë | Komuna e Malishevës |
| 20 | P-72310001--01003-0 | 3251 | Balincë | Komuna e Malishevës |
| 21 | P-72310001-01045-0 | 5832 | Balincë | Komuna e Malishevës |
| 22 | P-72310001-01050-0 | 2244 | Balincë | Komuna e Malishevës |
| 23 | P-72310001-01051-0 | 3967 | Balincë | Komuna e Malishevës |
| 24 | P-72310001-01054-0 | 2679 | Balincë | Komuna e Malishevës |
| 25 | P-72310001-01056-0 | 450 | Balincë | Komuna e Malishevës |
| 26 | P-72310003-00905-0 | 1817 | Bubavec | Komuna e Malishevës |
| 27 | P-72310003-01543-0 | 529 | Bubavec | Komuna e Malishevës |
| 28 | P-72310007-00150-0 | 2726 | Bubël | Komuna e Malishevës |
| 29 | P-72310007-00266-0 | 3793 | Bubël | Komuna e Malishevës |
| 30 | P-72310007-00279-0 | 1909 | Bubël | Komuna e Malishevës |

| | | | | |
|---|---|---|---|---|
| 31 | P-72310007-00281-0 | 3858 | Bubël | Komuna e Malishevës |
| 32 | P-72310009-00001-3 | 137331 | Llashkadrenoc | Komuna e Malishevës |
| 33 | P-72310009-00002-2 | 3257 | Llashkadrenoc | Komuna e Malishevës |
| 34 | P-72310009-00115-0 | 13025 | Llashkadrenoc | Komuna e Malishevës |
| 35 | P-72310009-00359-0 | 3372 | Llashkadrenoc | Komuna e Malishevës |
| 36 | P-72310009-00564-0 | 36868 | Llashkadrenoc | Komuna e Malishevës |
| 37 | P-72310009-00577-1 | 42250 | Llashkadrenoc | Komuna e Malishevës |
| 38 | P-72310009-00605-0 | 1639 | Llashkadrenoc | Komuna e Malishevës |
| 39 | P-72310009-00819-0 | 22154 | Llashkadrenoc | Komuna e Malishevës |
| 40 | P-72310009-00820-0 | 5940 | Llashkadrenoc | Komuna e Malishevës |
| 41 | P-72310009-00919-0 | 48760 | Llashkadrenoc | Komuna e Malishevës |
| 42 | P-72310009-00936-0 | 74056 | Llashkadrenoc | Komuna e Malishevës |
| 43 | P-72310009-00941-0 | 23372 | Llashkadrenoc | Komuna e Malishevës |
| 44 | P-72310009-00945-0 | 9617 | Llashkadrenoc | Komuna e Malishevës |
| 45 | P-72310009-00946-0 | 10368 | Llashkadrenoc | Komuna e Malishevës |
| 46 | P-72310009-00947-0 | 13624 | Llashkadrenoc | Komuna e Malishevës |
| 47 | P-72310009-01029-0 | 8167 | Llashkadrenoc | Komuna e Malishevës |
| 48 | P-72310009-01030-0 | 10493 | Llashkadrenoc | Komuna e Malishevës |
| 49 | P-72310009-01074-0 | 1074 | Llashkadrenoc | Komuna e Malishevës |
| 50 | P-72310009-01135-0 | 2852 | Llashkadrenoc | Komuna e Malishevës |
| 51 | P-72310009-01155-0 | 5277 | Llashkadrenoc | Komuna e Malishevës |
| 52 | P-72310009-01515-0 | 7196 | Llashkadrenoc | Komuna e Malishevës |
| 53 | P-72310009-01620-0 | 2218 | Llashkadrenoc | Komuna e Malishevës |
| 54 | P-72310009-01621-0 | 579 | Llashkadrenoc | Komuna e Malishevës |
| 55 | P-72310009-02728-0 | 1723 | Llashkadrenoc | Komuna e Malishevës |
| 56 | P-72310009-02421-0 | 1392 | Llashkadrenoc | Komuna e Malishevës |
| 57 | P-72310009-02842-0 | 6816 | Llashkadrenoc | Komuna e Malishevës |
| 58 | P-72310009-02853-0 | 4370 | Llashkadrenoc | Komuna e Malishevës |
| 59 | P-72310009-02868-2 | 25409 | Llashkadrenoc | Komuna e Malishevës |
| 60 | P-72310009-02880-0 | 14285 | Llashkadrenoc | Komuna e Malishevës |
| 61 | P-72310009-02881-1 | 69898 | Llashkadrenoc | Komuna e Malishevës |
| 62 | P-72310009-02881-2 | 69898 | Llashkadrenoc | Komuna e Malishevës |
| 63 | P-72310009-02900-0 | 6593 | Llashkadrenoc | Komuna e Malishevës |
| 64 | P-72310009-02928-0 | 13373 | Llashkadrenoc | Komuna e Malishevës |
| 65 | P-72310009-03291-0 | 7849 | Llashkadrenoc | Komuna e Malishevës |
| 66 | P-72310009-03297-0 | 13270 | Llashkadrenoc | Komuna e Malishevës |
| 67 | P-72310009-03314-0 | 2518 | Llashkadrenoc | Komuna e Malishevës |
| 68 | P-72310009-03373-0 | 4751 | Llashkadrenoc | Komuna e Malishevës |
| 69 | P-72310009-03374-0 | 4341 | Llashkadrenoc | Komuna e Malishevës |
| 70 | P-72310009-03375-0 | 20468 | Llashkadrenoc | Komuna e Malishevës |
| 71 | P-72310009-03376-0 | 24769 | Llashkadrenoc | Komuna e Malishevës |

| | | | | |
|---|---|---|---|---|
| 113 | P-72310037-01590-0 | 2799 | Kijevë | Komuna e Malishevës |
| 114 | P-72310037-01595-0 | 3919 | Kijevë | Komuna e Malishevës |
| 115 | P-72310037-01596-0 | 7998 | Kijevë | Komuna e Malishevës |
| 116 | P-72310037-01605-0 | 7998 | Kijevë | Komuna e Malishevës |
| 117 | P-72310037-01619-0 | 7345 | Kijevë | Komuna e Malishevës |
| 118 | P-72310043-00007-5 | 63700 | Llazicë | Komuna e Malishevës |
| 119 | P-72310043-00007-8 | 79446 | Llazicë | Komuna e Malishevës |
| 120 | P-72310043-00009-1 | 80660 | Llazicë | Komuna e Malishevës |
| 121 | P-72310043-00723-0 | 37857 | Llazicë | Komuna e Malishevës |
| 122 | P-72310043-00726-0 | 34363 | Llazicë | Komuna e Malishevës |
| 123 | P-72310043-00727-0 | 964 | Llazicë | Komuna e Malishevës |
| 124 | P-72310043-00728-0 | 3093 | Llazicë | Komuna e Malishevës |
| 125 | P-72310043-00735-0 | 465642 | Llazicë | Komuna e Malishevës |
| 126 | P-72310043-00941-0 | 192635 | Llazicë | Komuna e Malishevës |
| 127 | P-72310044-00149-0 | 2868 | Lubizhdë | Komuna e Malishevës |
| 128 | P-72310044-00317-0 | 6776 | Lubizhdë | Komuna e Malishevës |
| 129 | P-72310044-00327-0 | 2738 | Lubizhdë | Komuna e Malishevës |
| 130 | P-72310044-00342-0 | 18869 | Lubizhdë | Komuna e Malishevës |
| 131 | P-72310044-00723 | 2339 | Lubizhdë | Komuna e Malishevës |
| 132 | P-72310044-00940-0 | 26029 | Lubizhdë | Komuna e Malishevës |
| 133 | P-72310044-00942-0 | 12155 | Lubizhdë | Komuna e Malishevës |
| 134 | P-72310044-00943-0 | 9560 | Lubizhdë | Komuna e Malishevës |
| 135 | P-72310044-00944-0 | 53286 | Lubizhdë | Komuna e Malishevës |
| 136 | P-72310044-00954-0 | 11796 | Lubizhdë | Komuna e Malishevës |
| 137 | P-72310044-00913-0 | 5462 | Lubizhdë | Komuna e Malishevës |
| 138 | P-72310044-00954-0 | 11796 | Lubizhdë | Komuna e Malishevës |
| 139 | P-72310044-00958-0 | 11103 | Lubizhdë | Komuna e Malishevës |
| 140 | P-72310045-00144-0 | 4254 | Maxharrë | Komuna e Malishevës |
| 141 | P-72310045-00145-0 | 11975 | Maxharrë | Komuna e Malishevës |
| 142 | P-72310048-00010-0 | 10212 | Marali | Komuna e Malishevës |
| 143 | P-72310048-00353-0 | 62450 | Marali | Komuna e Malishevës |
| 144 | P-72310048-00429-0 | 22307 | Marali | Komuna e Malishevës |
| 145 | P-72310048-00628-0 | 5729 | Marali | Komuna e Malishevës |
| 146 | P-72310048-00634-0 | 6954 | Marali | Komuna e Malishevës |
| 147 | P-72310048-00875-0 | 4088 | Marali | Komuna e Malishevës |
| 148 | P-72310048-00875-1 | 15310 | Marali | Komuna e Malishevës |
| 149 | P-72310048-01122-0 | 11119 | Marali | Komuna e Malishevës |
| 150 | P-72310048-01263-0 | 95351 | Marali | Komuna e Malishevës |
| 151 | P-72310048-01337-0 | 82139 | Marali | Komuna e Malishevës |
| 152 | P-72310048-01504-0 | 17886 | Marali | Komuna e Malishevës |
| 153 | P-72310048-01619-0 | 11327 | Marali | Komuna e Malishevës |

| | | | | |
|---|---|---|---|---|
| 154 | P-72310049-0010-0 | 15365 | Shkozë | Komuna e Malishevës |
| 155 | P-72310049-00303-0 | 279291 | Shkozë | Komuna e Malishevës |
| 156 | P-72310049-00312-0 | 7796 | Shkozë | Komuna e Malishevës |
| 157 | P-72310049-00313-0 | 2284 | Shkozë | Komuna e Malishevës |
| 158 | P-72310049-00326-0 | 98500 | Shkozë | Komuna e Malishevës |
| 159 | P-72310049-00333-0 | 34252 | Shkozë | Komuna e Malishevës |
| 160 | P-72310049-00355-0 | 2096 | Shkozë | Komuna e Malishevës |
| 161 | P-72310049-00356-0 | 12417 | Shkozë | Komuna e Malishevës |
| 162 | P-72310049-00357-0 | 2436 | Shkozë | Komuna e Malishevës |
| 163 | P-72310049-00363-0 | 16700 | Shkozë | Komuna e Malishevës |
| 164 | P-72310049-00379-0 | 9008 | Shkozë | Komuna e Malishevës |
| 165 | P-72310049-00380-0 | 16236 | Shkozë | Komuna e Malishevës |
| 166 | P-72310049-00382-0 | 4667 | Shkozë | Komuna e Malishevës |
| 167 | P-72310049-00437-0 | 15786 | Shkozë | Komuna e Malishevës |
| 168 | P-72310049-01571-0 | 42789 | Shkozë | Komuna e Malishevës |
| 169 | P-72310049-01731-0 | 12780 | Shkozë | Komuna e Malishevës |
| 170 | P-72310049-01733-0 | 4662 | Shkozë | Komuna e Malishevës |
| 171 | P-72310050-00518-69 | 30643 | Mirushë | Komuna e Malishevës |
| 172 | P-72310050-00591-0 | 974 | Mirushë | Komuna e Malishevës |
| 173 | P-72310050-01025-18 | 4350 | Mirushë | Komuna e Malishevës |
| 174 | P-72310050-01033-1 | 17940 | Mirushë | Komuna e Malishevës |
| 175 | P-72310051-00934-0 | 1464 | Mleqanë | Komuna e Malishevës |
| 176 | P-72310051-00946-0 | 1114 | Mleqanë | Komuna e Malishevës |
| 177 | P-72310051-00992-0 | 1128 | Mleqanë | Komuna e Malishevës |
| 178 | P-72310051-00993-0 | 1188 | Mleqanë | Komuna e Malishevës |
| 179 | P-72310051-01053-0 | 22282 | Mleqanë | Komuna e Malishevës |
| 180 | P-72310051-01088-0 | 1472 | Mleqanë | Komuna e Malishevës |
| 181 | P-72310051-01089-0 | 247171 | Mleqanë | Komuna e Malishevës |
| 182 | P-72310059-00072-0 | 24584 | Astrazup | Komuna e Malishevës |
| 183 | P-72310059-00474-0 | 50618 | Astrazup | Komuna e Malishevës |
| 184 | P-72310060-00086-0 | 59363 | Pagarushë | Komuna e Malishevës |
| 185 | P-72310060-00589-0 | 53384 | Pagarushë | Komuna e Malishevës |
| 186 | P-72310060-00705-0 | 13103 | Pagarushë | Komuna e Malishevës |
| 187 | P-72310060-00822-0 | 17030 | Pagarushë | Komuna e Malishevës |
| 188 | P-72310060-00825-0 | 4823 | Pagarushë | Komuna e Malishevës |
| 189 | P-72310060-01127-0 | 15578 | Pagarushë | Komuna e Malishevës |
| 190 | P-72310064-00114-0 | 5400 | Panorc | Komuna e Malishevës |
| 191 | P-72310064-00115-0 | 5100 | Panorc | Komuna e Malishevës |
| 192 | P-72310064-00178-0 | 7517 | Panorc | Komuna e Malishevës |
| 193 | P-72310064-00493-0 | 161051 | Panorc | Komuna e Malishevës |
| 194 | P-72310064-00626-2 | 192520 | Panorc | Komuna e Malishevës |

| | | | | |
|---|---|---|---|---|
| 195 | P-72310062-00083-0 | 11701 | Pllaqicë | Komuna e Malishevës |
| 196 | P-72310062-00084-0 | 18326 | Pllaqicë | Komuna e Malishevës |
| 197 | P-72310062-00085-0 | 19002 | Pllaqicë | Komuna e Malishevës |
| 198 | P-72310073-00296-0 | 45696 | Shkarashnik | Komuna e Malishevës |
| 199 | P-72310073-00970-0 | 39666 | Shkarashnik | Komuna e Malishevës |
| 200 | P-72310073-00297-1 | 48477 | Shkarashnik | Komuna e Malishevës |
| 201 | P-72310035-00100-0 | 4417 | Jançisht | Komuna e Malishevës |
| 202 | P-72310035-00101-1 | 5714 | Jançisht | Komuna e Malishevës |
| 203 | P-72310041-00204-0 | 11780 | Lladroc | Komuna e Malishevës |
| 204 | P-72310041-002014-0 | 22937 | Lladroc | Komuna e Malishevës |
| 205 | P-72310041-00232-0 | 5015 | Lladroc | Komuna e Malishevës |
| 206 | P-72310041-00241-0 | 42412 | Lladroc | Komuna e Malishevës |
| 207 | P-72310041-00261-0 | 19119 | Lladroc | Komuna e Malishevës |
| 208 | P-72310041-00262-0 | 86174 | Lladroc | Komuna e Malishevës |
| 209 | P-72310041-01015-0 | 2393033 | Lladroc | Komuna e Malishevës |
| 210 | P-72310041-01322-0 | 181502 | Lladroc | Komuna e Malishevës |
| 211 | P-72310041-01544-0 | 15867 | Lladroc | Komuna e Malishevës |
| 212 | P-72310075-00001-0 | 22744 | Tërpezë | Komuna e Malishevës |
| 213 | P-72310075-00013-0 | 14409 | Tërpezë | Komuna e Malishevës |
| 214 | P-72310075-00774-0 | 1138 | Tërpezë | Komuna e Malishevës |
| 215 | P-72310075-01664-0 | 1420 | Tërpezë | Komuna e Malishevës |
| 216 | P-72310075-01666-0 | 2185 | Tërpezë | Komuna e Malishevës |
| 217 | P-72310075-02039-0 | 8719 | Tërpezë | Komuna e Malishevës |
| 218 | P-72314006-00206-0 | 2737 | Berishë | Komuna e Malishevës |
| 219 | P-72314006-00377-0 | 16432 | Berishë | Komuna e Malishevës |
| 220 | P-72310078-00005-0 | 49287 | Carrallukë | Komuna e Malishevës |
| 221 | P-72310078-00007-0 | 129991 | Carrallukë | Komuna e Malishevës |
| 222 | P-72310078-00111-0 | 9380 | Carrallukë | Komuna e Malishevës |
| 223 | P-72310078-00160-0 | 13155 | Carrallukë | Komuna e Malishevës |
| 224 | P-72310078-00162-0 | 34856 | Carrallukë | Komuna e Malishevës |
| 225 | P-72310078-00178-0 | 74996 | Carrallukë | Komuna e Malishevës |
| 226 | P-72310078-00178-0 | 27345 | Carrallukë | Komuna e Malishevës |
| 227 | P-72310078-00779-2 | 118063 | Carrallukë | Komuna e Malishevës |
| 228 | P-72310078-01852-0 | 2743 | Carrallukë | Komuna e Malishevës |
| 229 | P-72310078-01854-0 | 2753 | Carrallukë | Komuna e Malishevës |
| 230 | P-72310078-01856-0 | 5580 | Carrallukë | Komuna e Malishevës |
| 231 | P-72310078-01880-0 | 4927 | Carrallukë | Komuna e Malishevës |
| 232 | P-72310078-01882-0 | 7787 | Carrallukë | Komuna e Malishevës |
| 233 | P-72310078-01906-0 | 2120 | Carrallukë | Komuna e Malishevës |
| 234 | P-72310079-00101-0 | 21757 | Gurbardhë | Komuna e Malishevës |
| 235 | P-72310079-00148-0 | 22537 | Gurbardhë | Komuna e Malishevës |

| | | | | |
|---|---|---|---|---|
| 236 | P-72310079-00228-0 | 28750 | Gurbardhë | Komuna e Malishevës |
| 237 | P-72316001-02009-0 | 6923 | Banjë | Komuna e Malishevës |
| 238 | P-72316001-02010-0 | 7394 | Banjë | Komuna e Malishevës |
| 239 | P-72316001-01903-4 | 37056 | Banjë | Komuna e Malishevës |
| 240 | P-72316001-01897-1 | 1870 | Banjë | Komuna e Malishevës |
| 241 | P-72316001-01707-0 | 4532 | Banjë | Komuna e Malishevës |
| 242 | P-72316002-00555-0 | 40782 | Bellanicë | Komuna e Malishevës |
| 243 | P-72316002-00724-0 | 11259 | Bellanicë | Komuna e Malishevës |
| 244 | P-72316002-02255-0 | 19045 | Bellanicë | Komuna e Malishevës |
| 245 | P-72316002-02299 | 12476 | Bellanicë | Komuna e Malishevës |
| 246 | P-72316013-00743-0 | 12454 | Ngucat | Komuna e Malishevës |
| 247 | P-72316013-01446-0 | 17776 | Ngucat | Komuna e Malishevës |
| 248 | P-72316024-00753-0 | 7380 | Bardhë | Komuna e Malishevës |
| 249 | P-72316041-01297-0 | 59094 | Senik | Komuna e Malishevës |
| 250 | P-72310014-00325-0 | 7011 | Gurbardh | Komuna e Malishevës |
| 251 | P-72316048-00175-0 | 2954 | Temeqinë | Komuna e Malishevës |
| 252 | P-72316048-00325-0 | 2175 | Temeqinë | Komuna e Malishevës |
| 253 | P-72316048-00326-0 | 569 | Temeqinë | Komuna e Malishevës |
| 254 | P-72316048-00327-0 | 4431 | Temeqinë | Komuna e Malishevës |

**REPUBLIKA E KOSOVËS**
KOMUNA E MALISHEVËS

**Këshilli Komunal për Siguri në Bashkësi**

Zyra e Kryetarit
Nr. 01/
04.03.2026

| PËR: | z. Fatmir ADEMAJ , Kryesues i Kuvendit të Komunës së Malishevës |
|---|---|
| PËRMES: | z. Ekrem KASTRATI , Kryetar i komunës së Malishevës |
| NGA: | Halit MAZREKU, Udh. i Sektorit të Emergjencave - DMSH |
| LËNDA: | **Kerkesë** - Themelimi i KKSB-së për komunën e Malishevës,- |

I nderuar !

Në mbështetje të nenit 7 të Ligjit Nr. 04/L-076 për Policinë e Kosovës, nenit 3. pika 1 dhe 2 të Uhëzimit Administrativ Nr.27/2012 MPB – 03/2012 MAPL për Këshillat Komunal për Siguri në Bashkësi, kerkoj që Kuvendi i Komunës ta themeloj dhe emëroj anëtarët e KKSB-së konform Nenit 4 të UA të lartëcekur, dhe atë:

- **Ekrem KASTRATI,** Kryesues i KKSB-së,
- **Nazmi Zogaj,** K-dant i Stacionit Policor në Malishevë, anëtar
- Nga një përfaqësues i secilës bashkësi fetare të komunës, anëtar
- Nga një përfaqësues i secilit komunitet etnik të komunës, anëtar
- Kryesuesi i Komitetit për Komunitete i Kuvendit të Komunës, anëtar
- **Vera BYTYQI,** Zyrtare për Barazi Gjinore, anëtare
- **Arbëreshe KRASNIQI,** Drejt. për Arsim dhe Edukim, anëtar
- **Agon ZOGAJ,** Kryetar i Këshillit të Prindërve të Arsimit të Komunës, anëtar
- **Vedat SHATRI,** Toger – FSK, anëtar
- **Femi GASHI,** KLSP- Kijevë, anëtar
- **Sejdi PAÇARIZI,** Kryesues i EVSB-së, anëtar
- **Nuredin HOXHA,** Drejtor i DMSH-së (Sektori i Emergjencave), anëtar
- **Edona KRASNIQI,** përfaqësuese i Zyrës Komunale për Komunitete dhe Kthim, anëtare
- Një përfaqësues nga OJQ, mediat lokale, komuniteti i biznesit dhe komuniteti i përsonave me aftësi të kufizuara, anëtar dhe
- **Halit MAZREKU,** Koordinator i KKSB-së

Me nderime !

**REPUBLIKA E KOSOVËS**

**KUVENDI I KOMUNËS NË MALISHEVË**

---

Kuvendi Komunal – Malishevë

**PROCESVERBAL**

i mbledhjes së I (parë) urgjente të Kuvendit Komunal të Malishevës.

Mbledhja u mbajtë më datë: **12.01.2026**, duke filluar nga ora: **10:00**.

**Mbledhjen e kryesoi Kryesuesi i Kuvendit Komunal të Malishevës, Fatmir Ademaj. Të pranishëm në këtë mbledhje ishin 26 anëtarë të Kuvendit Komunal, përfaqësues të OSBE-së dhe përfaqësues nga Zyra për Informim.**

## Rendi i ditës

1. Themelimi i komiteteve obligative:
**Komitetit për Politikë** dhe **Financa** dhe **Komitetit për Komunitete.**

Kryesuesi i Kuvendit, **Fatmir Ademaj:** Përshëndetje për të gjithë!

Mirë se keni ardhur në mbledhjen e parë (I) urgjente! Së pari kërkoj nga sekretaria e Kuvendit të konstatojë numrin e anëtarëve të Kuvendit a kemi kuorum për vazhdim të kësaj seance?

Konstatojmë që të pranishëm jemi **26** anëtarë dhe kemi kuorum për vazhdimin e seancës. E keni marrë dhe materialin ku si pikë në rend të ditës kemi:

1. Themelimi i komiteteve obligative:
**Komitetit për Politikë** dhe **Financa** dhe **Komitetit për Komunitete.**

Kush është **PËR** këtë rend të ditës? 26 anëtarët unanimisht **PËR!** Miratohet ky rend i ditës. Duke u konsultuar me ligjin dhe Udhëzimin Administrativ, sot duhet t'i themelojmë dy komitetet e Kuvendit: ***Komitetin për Politikë dhe Financa*** dhe ***Komitetin për Komunitete.*** Përbërja e tyre është varësisht prej numrit të banorëve dhe përfaqësimit të asambleve Komunale në nivel vendi. Në këtë rast ne si Asamble Komunale kemi 27 asambleistë. Qëndrojmë te numri 7 në ***Komitet për Politikë dhe Financa***, dhe numër 5 te ***Komiteti për Komunitete.*** Para se të fillojmë me propozime kisha kërkuar nga Zyrtari Ligjor i Komunës, *Muharrem Morina* që ta japë interpretimin e Komitetit për Politikë dhe Financa dhe po ashtu Komitetit për Komunitete.

Urdhëro, Muharrem Morina!

**Muharrem Morina**, Zyrtar Ligjor: Përshëndetje për të gjithë!

Ju uroj të gjithëve marrjen e mandatit dhe suksese në punën tuaj. Sot mbledhja urgjente është thirrë për themelimin e dy komiteteve obligative. E sqaroi edhe Kryesuesi ndryshimet të cilat janë bërë në regjistrimin e popullësisë kanë ndikuar që Komiteti për Politikë dhe Financa të jetë me numër siç ka qenë në mandatin e kaluar.

Ta kemi parasysh para këtij mandati kemi pasur **9** anëtarë, tani Asambleja i ka **27** anëtarë, në mandatin e kaluar i ka pasur **31** asambleistë. Komiteti për Politikë dhe Financa është i formuar prej **7** anëtarëve, mirëpo te çelësi i përbërjes të forcës politike në këtë komitet ligji thotë që duhet të ketë përbërjen e njëjtë në përfaqësimin politik në kuvend.

Kryesuesi i Komitetit nuk llogaritet, sepse Kryesuesi i Kuvendit është ex officio, edhe Kryesues i Komitetit për Politikë dhe Financa. Sa i përket numrit 6 që duhet me përfaqësu në këtë Komitet ne kemi marrë formulën që jeni zgjedhur ju si përfaqësues në Kuvendin Komunal, në bazë të fuqisë politike të votave që i keni marrë në zgjedhjet komunale, në bashkëpunim dhe me OSBE-në.

Sipas kësaj numri:

- numri 1 vjen **Nisma Socialdemokrate** për arsye se i ka 9089 vota;

- numri 2 vjen nga **PDK** 4281 vota;

- numri 3 vjen nga **LDK** me 3068 vota;

- numri 4 vjen prapë nga **Nisma Socialdemokrate** me 3029 vota;

- numri 5 vjen nga **LVV** me 2461 vota;

- numri 6 vjen nga **Nisma** me 1817 vota.

Kjo është formulë që është apliku dhe për ju si anëtarë të asamblesë. Në rastin konkret për arsye të numrit 6 **AAK** që ka vetëm një anëtar nuk përfshihet fare në këtë Komitet.

Kryesus i Kuvendit, **Fatmir Ademaj**: Hapi debatin për këtë pikë të rendit të ditës.

Urdhëro, **Halil Morina**!

**Halil Morina,** anëtarë nga **Nisma Socialdemokrate**: Përshëndetje për të gjithë!

Është hera e parë që po ju drejtohem nga kjo foltore; më lejoni t'ju uroj në zgjedhjen e këtij mandati si anëtarë të Kuvendit të gjithëve. Shpresoj që të gjithë së bashku në këtë mandat të bëjmë më të mirën për qytetarët e Komunës sonë! Sa i përket pikës së rendit të ditës Kryesuesi i Kuvendit dhe Zyrtari Ligjor, Muharrem Morina, e shpjeguan shumë mirë formulën se si zgjidhet përbërja e këtij Komiteti.

Kjo metodë që e shpjegoi *Muharremi* është metodë që edhe KQZ-ja e aplikon për caktimin e mandateve në Zgjedhjet Qendrore ose Zgjedhjet Lokale. Ne si Grup Parlamentar pajtohemi me këtë përbërje.

Kryesus i Kuvendit, **Fatmir Ademaj:** Faleminderit Halil! Urdhëro, Veton Zogaj!

**Veton Zogaj**, anëtarë nga **LVV**: Përshëndetje për të gjithë!

Nëse kishe mundësi, Muharrem, me na sqaru sepse sa kam lexuar ligjin dhe Udhëzimet Administrative nuk e kam parë që Kryesuesi i Kuvendit është me ex officio i parapare të jetë domosdoshmërisht anëtar i KPF-së, por me qenë dhe një anëtar tjetër nga LDK shtesë nuk e di që është e nevojshme, sepse ky përfaqëson LDK-në. Dhe diçka që harrove në komitet është e rëndësishme me qenë edhe barazia gjinore, në këtë rast KPF-ja i ka 7 anëtarë, domosdoshmërisht jemi të obliguar që së paku tri femra me qenë të përfshira në Komitet. Mënyrën e votim e kisha propozu që ta japin të gjitha subjektet me propozime dhe pasi t'i votojmë bashkërisht të gjitha, mos të ketë hatërmbetje.

Kryesus i Kuvendit, **Fatmir Ademaj:** Urdhëro, Burim Paçarizi!

**Burim Paçarizi**, anëtar nga PDK: Përshëndetje për të gjithë!

Meqë është fjala ime e parë në këtë mandat ju uroj punë të mbarë dhe suksese të gjithëve, dhe të kemi punë të mira bashkërisht për të mirën e qytetarëve të Komunës së Malishevës! Sipas analizave të cilat i kemi bërë dhe hollësive të ligjit, nuk shënon që Kryesuesi i Kuvendit duhet të jetë ex officio si anëtarë i KPF-së. Andaj mendoj që duhet me analizu dhe njëherë e mirë ndarjen dhe mënyrën e pozicionit jo pse ne jemi nga PDK, por mendoj që formula ka qenë që edhe ne të kemi anëtarin e dytë në Komitet.

Kryesus i Kuvendit, **Fatmir Ademaj**: Urdhëro, Muharrem Morina!

**Muharrem Morina,** Zyrtar Ligjor: Të nderuar asambleistë! Duke ditur shqetësimin pse duhet të jetë Kryesuesi ex officio edhe Kryesus i Komitetit për Politikë dhe Financa. Dua t'ju njoftoj që para mandatit të kaluar Komuna e Malishevës ka kërkuar interpretim lidhur me këtë çështje të Ligjit për Qeverisje Lokale, jo që ne e kemi pasur të paqartë, por për arsye të këtyre përplasjeve politike që kanë ndodhë për përfaqësimin e komiteteve të kuvendit. Interpretimi ligjor që ka ardhë prej Ministrisë së

Pushtetit Lokal ka qenë në harmoni me Ligjin për Qeverisje Lokale neni 52 të Ligjit ceket që Komiteti për Politikë dhe Financa krysohet nga Kryesuesi i Kuvendit të Komunës dhe përbërja e tij duhet të reflektojë përfaqësimin e komiteteve politike në Kuvend. Në rastin konkret Kryesuesi i Kuvendit është ex officio. Kryesues i KPF-së, për këtë ndarja e mandateve bëhet vetëm për numërin 6, sepse numri 7 nuk llogaritet. Sikur Nisma do të kishte Kryesuesin e vetë do t'i kishte 4 anëtarë për arsye të këtij parimi. Ju e dini që shumë dokumentacione të cilat hyjnë në Kuvend duhet me qenë të nënshkruara nga Kryesuesit i Kuvendit, këtë po e thotë ligji, jo unë.

Kryesusi i Kuvendit, **Fatmir Ademaj**: Urdhëro, Imran Xhyliqi.

**Imran Xhyliqi,** anëtar nga PDK: Përshëndetje për të gjithë!

Meqenëse është hera e parë që po marrë fjalën në këtë foltore dua t'ju uroj suksese të gjithë asambleistëve dhe Kryesuesit të zgjedhur. Kryesues, kjo mbledhje urgjente është dashtë të thirret për vërshimet që janë bërë, jo për formim të këtyre komiteteve. Besoj që ajo kishte me qenë urgjente, për vërshimet nga fatkeqësit natyrore.

Sa i përket këtyre komiteteve, Muharrem, e ceke më herët që për arsye të numrit që është zvoglu në Malishevë, numri i asambleistëve tash është 27, herën e kaluar ka qenë 31, prapë i kemi pasur 7 anëtarë në KPF. Ligji thotë prej 21-31 anëtarë të Kuvendit Komunal maksimumi të vendosen 7, jo më shumë se 7. Sipas ndarjes së ligjit, në asnjë ligj nuk shënon që duhet të ndahet KPF sipas ligjit DKMUS. Nëse shkojmë sipas ligjit presjen dhjetore e kemi ne më të madhe si PDK, automatikisht anëtari i KPF-së i dyti jam unë, ne nuk po duam me na mbivlërsu, ne thjesht po duam ligjin me respektu. Nëse LDK-së i takon vetëm një anëtar atëherë, pse 1+1, unë e di që Kryesuesi është kryetar i KPF-së këtë e thotë ligji, e kuptuam, por nuk do të thotë LDK të mbivlerësohet më shumë se PDK. LDK i ka vetëm 4 anëtarë, ne i kemi 6 anëtarë Kuvendi, me çfarë ligji po e mbivlerësoni LDK-në. Thjesht respektojeni ligjin.

Kryesus i Kuvendit, **Fatmir Ademaj**: Urdhëro, Halil Morina, replikë!

**Halil Morina**, anëtar nga Nisma Socialdemokrate: Është e vërtetë që nuk shkruan askund që KPF-ja zgjedhet sipas DKMUS, por parimi është i njëjtë, aplikohet njëjtë siç aplikohet në ndarjen e mandateve si në Zgjedhjet Lokale, ashtu dhe qendrore i njëjëti parim vien edhe këtu. Në qoftë se në ligj ishte dashur të shënohet gjithçka atëherë, kushtetuta nuk kishte pasur ndonjë rol të madh. Ajo që the ti, nuk është ligj, por është formulë në bazë të së cilës ne e kemi marrë m'i nda anëtarët e KPF-së. Përndryshe, vendimet që merren në këtë Kuvend filtrohen në MAPL, secili subjekt politik që mendon që i është bërë e padrejtë ka të ndrejtë të bëjë ankesë në MAPL dhe merr përgjigje, nëse MAPL thotë që këtë ndarje e keni bërë gabim, atëherë ne e bëjmë ndarjen ashtu siç na thotë MAPL. Askush nuk do të mbivlërsohet as nuk do të nënvlerësohet, sepse i kemi disa ligje të cilat jemi të obliguar të funksionojmë në bazë tyre.

Kryesuesi i Kuvendit, **Fatmir Ademaj**: Urdhëro, Imran Xhyliqi!

**Imran Xhyliqi**, PDK: Sa i përket parimeve, parimi i zgjedhjes së Kryesuesit që është zgjedhë Fatmir Ademaj, përse në këtë rast nuk ia lironi një vend me sjellë një asambleist siç po ia lironi në KPF, përse nuk po e praktikoni këtë parim?

Kryesusi i Kuvendit, **Fatmir Ademaj**: Urdhëro, Muharrem Morina!

**Muharrem Morina,** Zyrtar Ligjor: Ligji për Qeverisje Lokale nuk i njeh koalicionet, për qeverisje lokale. Ligji për Qeverisje Lokale e njeh mandatin tënd si anëtar që keni ardhë me votë të popullit, mënyrën e përfaqësimit në Kuvend e ka mospërfaqësimin e politikës, asnjë nen nuk thotë koalicionet politike. Kryesuesi i Kuvendit zgjedhet prej Kuvendit, nëse thua me zëvendësu bëhemi 28 anëtarë, e shkelim ligjin, nuk lejohet.

Kryesusi i Kuvendit, **Fatmir Ademaj**: A ka dikush nga anëtarët e Kuvendit të paraqes mendimin e tij lidhur me këtë çështje? Nëse nuk ka në bazë të vlerësimit ligjor themelimi i Komitetit për Politikë dhe Financa përbëhet nga 7 anëtarë, në këtë përbërje të aspektit politik:
3 anëtarë nga ***Nisma Socialdemokrate***,
1 anëtar nga ***PDK***,
1 anëtar nga ***LDK***
1 anëtar nga ***LVV***

Kryesusi i Asamblesë Komunale, **Fatmir Ademaj**, ftoj subjektet politike t'i ofrojnë propozimet e tyre.

Urdhëro, Halil Morina!

**Halil Morina**, anëtarë nga Nisma Socialdemokrate: Në emër të Grupit të Nismës për KPF propozoj këta emra: *Halil Morina, Gentianë Mehmetaj, Amrush Helshanin!*

Kryesusi i Kuvendit, **Fatmir Ademaj**: Nga PDK?

**Burim Paçarizi**, anëtarë nga PDK: Nga ne propozojmë, *Imran Xhyliqin!*

Kryesusi i Kuvendit, **Fatmir Ademaj**: Nga grupi LVV?

**Vlera Bytyçi,** anëtare nga LVV: Nga Grupi LVV?

Kryesusi i Kuvendit, **Fatmir Ademaj**: LDK ka *Xhenetë Morinën.* Në seancën e kaluar Vetoni ka kërkuar reflektim gjinor, politika është e gjatë jo, më gjatë sesa një mandat zgjedhor. Kështu që kërkoj nga subjektet politike LVV, Nisma Socialdemokrate dhe PDK të reflektojnë që ta plotësojnë kuotën gjinore.

**Veton Zogaj**, anëtarë nga LVV: Grupi jonë ka vetëm një anëtar në KPF, normalisht nuk mundemi me reflektu në këtë pikë, të kishim pasë dy patjetër që kishim bërë reflektimin tonë. Këtë reflektim presim nga ju LDK dhe Nisma ta bëni.

Kryesuesi **Fatmir Ademaj**: Veton nga LDK e prezantuam emrin është: *Xheneta Morina,* femër. Pres nga PDK dhe Nisma që të reflektojnë. Halil nëse ju nevojitet kohë për konsulta mund të bëjmë pauzë dhe të vazhdojmë prapë. Propojmë 5 minuta pauzë.

*Vazhdojmë seancën pas pauzës,* Halil po presim reflektimin tuaj.

**Halil Morina**, anëtarë nga Nisma Socialdemokrate: Atëherë në vend të *Amrush Helshanit* propozojmë *Edonë Hotin*, meqë tjerët nuk lëvizën asgjë.

Kryesusi i Kuvendit, **Fatmir Ademaj**: Atëherë përbërja e **KPF**-së është si vijon:

1. **Halil Morina** - *Nisma Socialdemokrate*
2. **Gentianë Mehmetaj** - *Nisma Socialdemokrate*
3. **Edonë Hoti** - *Nisma Socialdemokrate*
4. **Imran Xhyliqi** - *PDK*
5. **Fatmir Ademaj,** *LDK - Kryesues i Kuvendit.*
6. **Xhenetë Morina** - *LDK*
7. **Veton Zogaj** - *LVV*

Kush është **Për**, që ***Komitetit për Politikë dhe Financa*** të formohet me këtë përbërje nga subjektet politike? **26** anëtarë prezent.
Unanimisht të gjithë të pranishmit ishin **PËR** miratohet përbërja e **KPF-së.**

Vazhdojmë me pjesën tjetër të pikës së parë themelimi i **Komitetit për Komunitete**. Edhe në këtë pjesë Muharremi dhe Salihi na treguan që janë 5 anëtarë, 2 nga Kuvendi dhe tre janë nga komunitete të ndryshme. Kështu që ne kemi obligim ligjor t'i zgjedhim dy emrat nga Kuvendi dhe tre emrat e tjerë presim propozimet nga komunitetet, të cilët jetojnë në Komunën e Malishevës. Urdhëroni me propozime!

**Halil Morina**, anëtarë nga Nisma Socialdemokrate: Në emër të Grupit propozoj *Hafir Rexhën*!

**Xhenetë Morina**, anëtare nga LDK: Në emër të grupit të LDK propozojë *Fitim Shalën*!

**Burim Paçarizi**, anëtarë nga PDK, në emër të grupit të PDK propozojë *Demir Bajrën!*

Kryesus i Kuvendit, **Fatmir Ademaj**: Nëse nuk ka propozime të tjera vazhdojmë me votimin nga e para nëse nuk kalon mbetet në vazhdimësi. Urdhëro, Veton!

**Veton Zogaj**, anëtar nga LVV: Nëse mundesh me na tregu cilat ishin propozimet dhe a kemi m'i votu një nga një porpozimet? Në momentin që e votojmë një të Nismës ose LDK-së dhe kalojnë dy votimet, atëherë te propozimi i tretë nuk kemi çfarë të shkojmë, sepse janë vetëm 2 anëtarë që do të zgjidhen në Kuvend.

Kryesusi i Kuvendit, **Fatmir Ademaj**: Urdhëro, Burim Paçarizi!

**Burim Paçarizi**, anëtarë nga PDK: Përshëndetje për të gjithë!
Pasi që i ka vetëm 2 anëtarë nga Kuvendi Komiteti kisha kërku bashkarisht me zgjedhë një nga pozita dhe një nga opozita le të jetë përfaqësimi i të gjithëve.

Kryesuesi i Kuvendit, **Fatmir Ademaj**: Ne asnjëherë përfaqësim të të gjithëve nuk mundemi me qenë, strukturat politike në këtë Asamble Komunale kanë ndërruar dhe do të ndërrohen shpesh. Urdhëro, Halil Morina!

**Halil Morina**, nga Nisma Socialdemokrate: Për dallim prej komiteti i mëhershëm i KPF-së që Ligji për Vetëqeverisje Lokale na thotë që këtë komitet me ndryshu përbërjen e grupeve politike në kuvend. Komiteti për Komunitete nuk e ka të njëjtën formulë anëtarët e këtij Komiteti zgjidhen me shumicë votash në kuvend. Muharremi Morina ceku se ligji nuk i njeh kualicionet në Kuvend këtu nuk kemi kualicione. Këtu varet se cilët prej këtyre marrin shumicën e votave. Kishte qenë mirë ashtu siç po thua por problemi është që në Kuvend vendoset në bazë të votave dhe në bazë të bisedimit të anëtarëve të Kuvendit.

Kryesuesi i Kuvendit, **Fatmir Ademaj**: Urdhëro, Amrush Helshani!

**Amrush Helshani**, anëtar nga Nisma Socialdemokrate: A duhet të aplikohet kuota gjinore edhe në këtë Komitet? Duke marrë parasysh që nëse vijnë dy anëtarë që kanë qenë më herët janë meshkuj.

**Muharrem Morin**, Zyrtar Ligjor: Është parim i njëjtë për të gjitha komitetet.

Kryesuesi i Kuvendit, **Fatmir Ademaj**: Nuk mund të paragjykojmë, sepse përkatësitë e komuniteteve munden me pasë aspektin e gjinisë, kështu që sot po i votojmë anëtarët e Kuvendit nga votat e Asamblesë Komunale.

Kush është **Për** që *Hafir Rexha* të bëhet anëtarë i Komitetit për Komunitete?

**Për:** 17

**Kundër:** 5

**Abstenim:** 4

Me 17 vota PËR, 5 KUNDËR, 4 ABSTENIME **Hafir Rexha** bëhet anëtarë i **Komitetit për Komunitete.**

Propozimi i dytë ishte nga LDK që ***Fitim Shala*** të bëhet anëtarë i **Komitetit për Komunitete**.

Kush është **Për?**
**Për:** 17
**Kundër:** 5
**Abstenim:** 4
Me 17 vota **Për,** 5 Kundër, 4 Abstenime, ***Fitim Shala*** bëhet anëtarë i **Komitetit për Komunitete.**

Atëherë po e vendosim në votim edhe një propozim, i cili është për ***Demir Bajrajn*** nga PDK.

Kush është **PËR** që Demir Bajra të jetë anëtarë i **Komitetit për Komunitete**?
**Për:** 9
**Kundër:** 16
**Abstenim**: 1
Me 9 vota **Për**, 16 **Kundër**, 1**Abstenim**, nuk kalon ky propozim.
Në këtë rast kemi dy anëtarë të Komitetit për Komunitete: **Hafir Rexha** dhe **Fitim Shala**! Pjesa tjetër mbetet që përmes përfaqësuesve të komuniteteve dhe përfaqësuesve të OJQ-ve të sillin emrat.
Urdhëro, *Enver Hoti!*

**Enver Hoti**, anëtarë nga AAK: Përshëndetje për të gjithë!

Çka më ka befasu Kryesues që rendi i ditës nuk është ardhë, nëse nuk keni mundur me na dërgu, sot është dashtë të na sjellni këtu në Asamble. Vetëm seanca e jashtëzakonshme nuk e ka pikën: *Të ndryshme* jo seancat e tjera, ti nuk na ke dhënë hapsirën për këtë pikë së paku t'i diskutojmë disa çështje të rëndësishme. Përsonave të cilët u zgjodhën unë ju uroj suksese kjo është çështje ligjore, praktike të funksionojnë në interes të qytetarëve. Por te gjendja aktuale që po kalojmë si komunë është dashur të na jepni mundësinë ta diskutojmë. Cila është gjendja sot e situatës pas vërshimeve? Ne jemi munduar të jemi aktiv dhe t'i mbështesim të gjithë reagusit për të gjitha masat të cilët i kanë marrë reaguesit. Mendoj që qytetarët është dashtë të informohen më tutje përmes përfaqësuesve të tyre, sepse ka pasur disa ngecje. Kjo ishte një çështje të cilën ndoshta në seancën tjetër do ta diskutojmë.

Ajo që u pa në këtë seancë u bë një ndikim mbi votim nuk është në rregull, është dashur t'i jepni përparësi pak opozitës, por i keni numrat vazhdoni! Do të vjen një ditë që do t'ju duhen numrat sepse 4 vjet janë të gjata do t'ju duhen votat dhe mos i kërkoni. Po thoni që nuk ka koalicion, nëse bëhet koalicioni për çështje individuale, funksionale është çështje tjetër.

Kryesusi i Kuvendit, **Fatmir Ademaj**: Enver e vlerësova që ke diçka rreth pikës së rendit të ditës dhe ju lejova ta merrni fjalën, vërshimet nuk kanë qenë nga dora e njeriut, por kanë qenë vërshime nga natyra dhe i ka shqetësuar të gjithë qyetatrët e Komunës së Malishevës, të gjitha institucionet, Kryetarin e Komunës, të gjithë asambleistët komunal, por të gjitha institucionet relevante e kanë përfunduar punën e tyre. Të gjitha subjektet politike i kanë parë shqetësimet dhe reagimet e tyre dhe plotësisht pajtohem me vlerësimet që janë bërë nga të gjitha institucionet. LDK dhe Nisma Socialdemokrate momentalisht kanë koalicion në Malishevë në harmonizimin e programeve dhe bashkëqeverisjes në të ardhmen në Malishevë në këtë mandat.

**Enver Hoti**, anëtar nga **AAK**: Ju kuptoj por unë e ceka është dashur me pasë në rend të ditës si pikën: *Të ndryshme*, por ju po e përdorni votën mund t'ma merrni edhe fjalën, por reagimin tim nuk mund të ma ndalni.

Kryesusi i Kuvendit, **Fatmir Ademaj**: Anëtarët e Asamblesë Komunale të cilët nuk kanë pasur ftesë nuk e di kush nuk ka pasur, por kam kërkuar nga administrata e kuvendit që përmes asaj që keni votuar dhe jeni zgjedhur si asambleistë, të gjithë asambleistët do të duhej t'i mirëpresim me llaptopë. Ata të cilët nuk janë rizgjedhë asambleistë detyrohen t'i dorëzojnë sa më shpejt llaptopët që t' jua dorëzojmë anëtarëve të rinj të Kuvendit të cilët janë aktiv. Rrjedhimisht të gjitha njoftimet zyrtare do t'ju dërgojmë në e-mail. Me kaq e përfundojmë mbledhjen e parë urgjente.

Shihemi në takimet e radhës.

Mbaroi në ora: **11:10**

Procesmbajtësja:
Argenitë Thaçi

Kryesuesi i Kuvendit
Fatmir Ademaj

04.03.2026
02/54

**REPUBLIKA E KOSOVËS**

**KUVENDI I KOMUNËS NË MALISHEVË**

---

Kuvendi Komunal – Malishevë

**PROCESVERBAL**

i mbledhjes së II (dytë) të jashtëzakonshme të Kuvendit Komunal të Malishevës.

Mbledhja u mbajt, më datë: **20.01.2026**, duke filluar nga ora: **10:15.**

**Mbledhjen e kryesoi Kryesuesi i Kuvendit Komunal në Malishevë, Fatmir Ademaj. Të pranishëm në këtë mbledhje ishin: 24 anëtarë të Kuvendit Komunal, Kryetari i Komunës, përfaqësues të OSBE-së, medie dhe përfaqësues nga Zyra për Informim.**

## Rendi i ditës

1. Dhënia e betimit të anëtarit të Kuvendit Komunal, z.Albrim Morina.
2. Shqyrtimi dhe miratimi i kërkesës nr.04/534 dt: 29.08.2025 për miratimin e projektbuxhetit për vitin 2026/2028.

Kryesues i Kuvendit, ***Fatmir Ademaj***, Përshëndetje për të gjithë!
Mirë se keni ardhur në mbledhjen e dytë **II** të jashtëzakonshme, së pari kërkoj nga sekretaria e kuvendit të verifikojë numrin e anëtarëve të Kuvendit se a kemi kuorum për vazhdim të kësaj seance. Konstatojmë që të pranishëm jemi **24** anëtarë, ndaj kemi kuorum për vazhdim të kësaj seance. Kemi dy pika të rendit të ditës të cilat janë:

1. Dhënia e betimit të anëtarit të Kuvendit Komunal, z.Albrim Morina.
2. Shqyrtimi dhe miratimi i kërkesës nr. 04/534 datë: 29.08.2025 për miratimin e projektbuxhetit për vitin 2026/2028.

**Veton Zogaj** (anwtar nga LVV): Nëse kisha mundur një propozim për një pikë shtesë?

**Fatmir Ademaj,** Kryesues i Kuvendit: Veton nuk di e ke lexuar ligjin në mbledhjet, e jashtë-zakonshme nuk ka ndryshim të rendit të ditës.

**Veton Zogaj** (anwtar nga LVV): Kryesues është shumë me urgjencë, nëse kishe mujtë me shti si pikë të rendit të ditës ose mos me çuar shumë gjatë formimi i komisionit për hartimin e Planit të Punës së Kuvendit për vitin 2026. Jemi në fund të muajit janar vazhdojmë të mbajmë seanca të jashtëzakonshme, urgjente, dhe nuk e kemi një Plan të Punës për vitin 2026.

**Fatmir Ademaj**, Kryesues i Kuvendit: Ne kemi mbajtur mbledhje në KPF dhe gjatë diskutimit ju kam pyetur, a ka dikush propozim për mbledhje për ndonjë pikë të veçantë, të cilën e vlerësojnë anëtarët e KPF-së, që të futet si pikë në rend të ditës në seancën e jashtëzakonshme? Veton, ti ke qenë pjesë e komitetit dhe nuk ke pasur një propozim të tillë, në aspektin ligjor mos të kërkojmë diçka që ta shkelim ligjin, përderisa mbledhja e rregullt e asamblesë Komunale do të mbahet shumë shpejt me një agjendë të veçantë për vitin kalendarik 2026 të Planit të Punës së Kuvendit Komunal.

Jemi në proces të votimit, kush është për këtë rend të ditës?

**Për:** 21

**Kundër**: 0

**Abstenim:** 3

Me **21** vota Për, **0** Kundër, **3** Abstenime miratohet ky rend i ditës.

Vazhdojmë me pikën e parë të rendit të ditës e cila është: Dhënia e betimit të anëtarit të Kuvendit Komunal, *z.Albrim Morina.* Duke dhënë dorëheqje anëtari nga PDK është zëvendësuar dhe kemi Vendimin e KQZ-së për ndryshimin e anëtarëve në Kuvendin Komunal. *Albrim Morina*

emërohet anëtar i Kuvendit në Malishevë nga subjekti politik PDK, duke zëvendësuar anëtarin e Kuvendit Komunal, *Mevludin Mazreku.* Unë po lexoj në fund do ta bëni betimin. *"Unë **Albrim Morina**, betohem se do t'i kryej detyrat me nder, besnikëri, paanime e me ndërgjegje dhe sipas ligjit do t'i ushtroj autorizimet e mia si anëtarë i Kuvendit të Komunës së Malishevës, në mënyrë që të sigurohen kushtet për jetë të qetë për të gjithë. Betohem!"*

**Fatmir Ademaj,** Kryesues i Kuvendit, urime Albrim!

Vazhdojmë me pikën e dytë të rendit të ditës: Shqyrtimi dhe miratimi i kërkesës nr. 04/534 datë: 29.08.2025 për miratimin e projektbuxhetit për vitin 2026/2028.
Fillimisht ftoj Kryetarin që ta marrë fjalën. Urdhëro z. Kryetar!

**Ekrem Kastrati,** Kryetar i Komunës:

I nderuari Kryesues,

Të nderuar këshilltarë komunal,

Të gjithë ju të pranishëm, qytetarë që po na ndiqni përmes kanaleve tona të komunikimit.

Ju falënderoj të gjithëve që përmes pjesëmarrjes suaj në këtë mbledhje të Kuvendit, i jeni përgjigjur pozitivisht ftesës së Kryesuesit të Kuvendit, për të shqyrtuar kërkesën time, të cilën e kam parashtruar konform kompetencave ligjore të Kryetarit të Komunës, që ka të bëjë me miratimin e projektbuxhetit të Komunës së Malishevës për vitet 2026/2028, me theks të veçantë për vitin 2026.

Të nderuar këshilltarë komunal, të dashur qytetarë, mbledhja e sotme është e një rëndësie të veçantë për Komunën tonë dhe interesin e përgjithshëm të qytetarëve tanë, për të thënë më mirë është më e rëndësishmja që legjislatura e institucionit tonë mban gjatë një viti kalendarik, për faktin se këtu vendoset për investimet e qeverisjes komunale për vitin aktual dhe në vijim.

Të nderuar të pranishëm, siç edhe jeni në dijeni përmes materialeve që keni pranuar për mbledhjen e sotme, për hir të opinionit publik, po e ritheksoj se Komuna e Malishevës për vitin 2026 ka një buxhet në vlerë prej **22,088,710.00 €**, që krahasuar me vitin e kaluar, kemi një buxhet mbi 500, 000 euro më të lartë. Mirëpo, kjo rritje ndërlidhet direkt në kategorinë paga dhe shtesa.

Rritja e vogël është si pasojë e pakësimit të numrit të banorëve në Komunën e Malishevës. Pra, dua ta theksoj për ju dhe të gjithë qytetarët tanë se ky buxhet është jo populist, por është buxhet që në fokus ka zhvillimin ekonomik, vazhdimin e investimeve në qendër dhe fshatra, gjithnjë në funksion të jetësimit të projektit tonë të përbashkët për Malishevën Urbane dhe fshatra të urbanizuara, për të cilin na kanë dhënë besimin edhe qytetarët e komunës sonë, në zgjedhjet e fundit elektorale.

Konkretisht në buxhet për vitin 2026 nga granti qeveritar janë **20,144,762.00 €** dhe nga të hyrat vetjake **1,943,948.00 €**, me rritje të të hyrave vetanake prej **438,422** euro, të shpërndarë në **5** kategori ekonomike, në kategorinë:

1. *Paga dhe Shtesa* janë të planifikuara **13,077,454.00 €** (për 1,378 të punësuar);

2. *Mallra dhe Shërbime* janë planifikuar **2,555,812.00 €**;

3. *Shpenzimeve Komunale* janë **500,000.00 €**;

4. *Subvencioneve* kemi planifikuar **600,000.00 €**, dhe kategoria më e rëndësishme për zhvillimin e komunës sonë është kategoria:

5. *Investimeve kapitale,* ku janë planifikuar saktësisht **5,355,444.00 €**, që krahasuar me vitin aktual kemi rreth *708 mijë euro* më pak, për shkak të numrit të banorëve, por ne planifikojmë ta mbulojmë përmes realizimit të tejkalimit të të hyrave të vitit 2025, e cila në total kap vlerën mbi *1 milion euro.*

Siç e dimë pjesa më e madhe e buxhetit të Komunës është ndarë në **3** programe kryesore, në:

*Programin për arsim;*

*Programin për shëndetësi,* si dhe

*Programi për administratë Komunale.*

Të nderuar ky projektbuxhet është me modifikime shumë të vogla. Jam plotësisht i vetëdijshëm se një pjesë e madhe e mjeteve për investime kapitale janë të parapara për infrastrukturën rrugore nëpër të gjitha fshatrat e Komunës së Malishevës dhe në qendër të qytetit: kanalizime, ndriçimit publik etj. Po ashtu dua ta theksoj se me investimet në qendër tashmë jemi në fazën e përfundimeve, për vitin aktual dhe vijues janë hapur shumë rrugë për t'u zgjeruar dhe investime në fshatra, pra për të qenë i sinqertë me vulnetin më të madh secilin fshat e lagje të Komunës sonë planifikojmë ta përkrahim me investime sipas nevojës.

Unë shpreh gjithë gatishmërinë time që si Kryetar i Komunës së Malishevës, pavarësisht kësaj, do të jem shumë i gatshëm që kërkesat tuaja për projekte me interes për qytetarët tanë, apo për zgjidhjen e problemeve nëpër fshatra tona apo këtu në qytet, që nuk kanë gjetur hapësirën në këtë projektbuxhet, ju siguroj se do të bëjmë maskimumin për t'i përkrahur në të ardhmen e afërt. Mirëpo, gjithsesi mendoj që ky projekt prek nevojat më elementare që kanë qytetarët tanë, dhe ne do të bëjmë të pamundurën që të investojmë dhe banorëve tanë tua përmisojmë kushtet bazë për një jetë më të mirë e më të dinjitetshme. Jam plotësisht i vetëdijshëm se anekënd komunës sonë ka nevojë për më shumë investime kapitale; për më shumë përkrahje, thuajse në secilën fushë zhvillimore, por mundësitë tona buxhetore janë paksa të kufizuara, veçmas tash kur kemi një buxhet më të vogël që ka rrjedh si pasojë e zvogëlimit të numrit të banorëve, ku zyrtarisht është **43 mijë e 888** banorë.

Ju siguroj se për asnjë moment nuk do të ndalem që për shumë projekte me interes për komunën dhe qytetarët tanë, të cilat ne si komunë nuk kemi mundësi buxhetore për t'i jetësuar, do të drejtohem për të gjetur përkrahje institucioneve qendrore, duke mos lënë anash edhe donatorët dhe partnerët tanë ndërkombëtarë. Prandaj, duke pasur në konsideratë se miratimi i buxhetit është edhe obligim yni ligjor, kërkoj nga ju që pas kontributeve që mund të jepni në këtë seancë, në fund ta përkrahni miratimin e këtij projektbuxhetit të Komunës së Malishevës për vitin 2026/2028 me theks të veçantë për vitin 2026. Më lejoni të theksoj se që nga viti 2022 ku ne kemi nisur të punojmë si qeverisje komunale e dalë nga zgjedhjet e fundit lokale, kemi një rritje të buxhetit në vlerë prej 6,2 milion euro.

Ju faleminderit!

**Fatmir Ademaj,** Kryesues i Kuvendit: Faleminderit Kryetar, urdhëro Drejtori për Buxhet dhe Financa, *Blerim Thaçi!*

**Blerim Thaçi**, Drejtor për Bugjet dhe Financa:

Më lejoni t'ju urojë për zgjedhjen tuaj këshilltarë komunal dhe njëkohësisht dhe juve si Kryesues i Kuvendit, duke ju uruar sukese dhe bashkëpunim për 4 vitet e ardhshme. Kryetari e prezantoi projektbuxhetin për vitin 2026/2028 me theks të veçantë për vitin 2026, i cili buxhet ka vlerën **22,088,710.00 €**. Është pothuajse një buxhet i njëjtë me vitin 2025 me ndryshime të vogla, me një rritje shumë të vogël dhe ato rritje shkojnë në kategorinë e *Pagave dhe shtesave*, duke futur dhe rritjen e limitit të të hyrave vetanake pasi që në 4 vitet e fundit kemi pasur tejkalim të të hyrave. Kjo ka ndodhë pasi numri i popullsisë në Komunën tonë është zvogëluar. Kategorinë që ka ndikuar më së shumti është në *kategorinë e investimeve kapitale*, kjo na sfidon në realizimin e projekteve, në kërkesat e tjera të qytetarëve, mirëpo duke pasur parasysh që në vitin 2025 kemi pasur tejkalim të të hyrave mbi 1 milion euro nga kjo të shohim se si do t'i mbulojmë pjesët e tjera obligimet kontraktuale, të kërkesave të tjera të qytetarëve.

Ky buxhet është dorëzuar në Kuvendin Komunal në fund të muajit gusht sipas obligimeve ligjore dhe para jush është prezantuar si i tillë, mirëpo për shkaqe të ndryshme nuk ka mundur të aprovohet si buxhet. Tani jemi para jush me kërkesë që të miratohet ky buxhet me dy ndryshime, një ndryshim tjetër është teknik si kërkesë që e kemi pasur në KPF. Ndryshimet janë kryesisht te *investimet kapitale* njëra prej tyre që është e domosdoshme sanimi i kësaj salle qoftë ajo elememtare qoftë teknike. Është një kod i ri që do të futet dhe *vërshimet e fundit* që kanë ndodhur në Malishevë janë dëmtuar disa ura njëra në Malishevë dhe njëra në Carrallukë. Është dashur të planifikojmë investimet në këto dy ura dhe kam propozu që të hyjnë në projektbuxhet që presim të miratohet nga ju. Çështja tjetër gabimi teknik në buxhetin e prezantuar në gusht të vitit 2025 për arsye që Ministria e Financave nuk lejon të futen të gjitha shënimet që i japim në buxhet, sidomos te rrugët është një hapësirë e madhe, para jush e kemi sjellë të përmisuar, sepse janë të gjitha rrugët në fshatra dhe kryesisht është interesi i gjithë qytetarëve. Këto rrugë i ka projektu operatori projektues i cili është i kontraktuar nga Komuna dhe janë në detaje afro 50 km që do të shtrohen për tri vjet dhe janë të specifikuar me akse.

Ju mund të thoni kush është aksi 1 aksi 2 të gjitha këto specifikisht mund t'i gjeni në Drejtorinë e Urbanizmit, që janë të specifikuara saktë cilat rrugë do të shtrohen dhe cilat do të mirëmbahen. Rrugë të reja është vlera rreth **7,000,000** euro, mirëmbajtja e rrugëve në fshatra edhe aty kemi përafërsisht **1,000,000** euro. Gjithashtu kemi kanalizime të reja afër **1.4** milion euro, kemi dhe projektin e ndriçimit publik në të gjitha fshatrat. Kryesisht në këtë projektbuxhet është orientu investimi në fshatrat e Komunës së Malishevës. Nuk përjashtohen dhe investimet brenda qytetit të Malishevës, dhe rrugët rreth lumit që i kemi në Malishevë dhe sanimet të cilat i kemi në qendër të Malishevës. Para jush e keni projektbuxhetin mund të bëni pyetje dhe do t'ju përgjigjemi çfarëdo që keni nevojë.

**Fatmir Ademaj,** Kryesues i Kuvendit: Para se të hap debatin nga sot do të fillojmë praktikën që fillimisht të paraqiten në emër të Grupeve Parlamentare qëndrimet e tyre, pastaj të hapen debate nga asambleistët komunal. Për arsye të numrit të asambleistëve e ftoj përfaqësuesin e grupit Nisma të japë qëndrimin e tyre!

**Halil Morina,** nga Nisma Socialdemokrate:

Faleminderit Kryesues i Kuvendit! I nderuar Kryetar i Komunës, drejtorë të nderuar, kolegë asambleistë dhe ju gjithë të pranishëm! Neve sot na është dhënë mundësia me diskutu për projektbuxhetin për vitin 2026-2028 me theks të veçantë për vitin 2026. Që ka qenë detyrë e legjislaturës së kaluar mirëpo edhe legjislaturës së kaluar i ka ndodhë e njëjta gjë që është dashur të merret me buxhetin e legjislaturës paraprake, kështu që këto gjëra janë normale. Sa herë që ne diskutojmë për buxhtetin më kujtohet se sa të mëdha janë nevojat tona të qytetarëve të Komunës së Malishevës në krahasim me mundësitë tona financiare. Mundësitë tona financiare janë shumë të vogla, mirëpo ne funksionojmë në bazë të këtyre mundësive financiare që i kemi. Ajo çka është e rëndësishme të theksohet këtu që këto mundësi financiare që i kemi në këtë projektbuxhet janë të shpërndara në të gjitha kategoritë që prekin nevojat më bazike dhe elementare të qytetarëve të Komunës së Malishevës, sidomos kur flasim për investime kapitale.

Aty janë të përfshira projekte të tilla si asfaltime të rrugëve, kanalizime, ndriçime, projekte të ujësjellësit pothuajse në të gjitha fshatrat dhe vendbanimet e Komunës së Malishevës. Kjo është një dëshmi që ky projektbuxhet është i shpërndarë në mënyrë proporcionale në të gjitha komunitetet e Komunës dhe për të gjithë qytetarët e Komunës sonë. Kjo është e mjaftueshme me dhënë dritën e gjelbërt dhe me dhënë votë ***pro*** këtij projektbuxheti. Siç e dimë projektbuxhetet janë projeksione mbi të hyrat dhe shpenzimet për vitin e ardhshëm, gjatë këtij viti ne kemi me pasë shumë ndryshime:kemi me pasë të hyra vetanake, kështu që këto mundësi financiare që janë të paraqitura në buxhet kanë m'u rritë më shumë, dhe kemi me pasë mundësinë me realizu projekte të tjera. Në emër të grupit të Nisma-s deklaroj që grupi ynë voton **Pro** për këtë dokument ashtu siç ka ardhë pa asnjë ndryshim.

**Fatmir Ademaj,** Kryesues i Kuvendit: Në emër të PDK-së urdhëro, *Burim Paçarizi!*

**Burim Paçarizi,** nga PDK, Përshëndetje për të gjithë!

Së pari para se të futem te buxheti dua të shpreh keqardhje për të gjithë ata që kanë pësuar dëme nga vërshimet, të cilat ndodhën në Komunën tonë. Po ashtu dua të shpreh keqardhje dhe për projektin kryesor të proklamuar dhe organizuar nga partia në pushtet, ku vërshimet kanë ndodhur ende pa u prerë shiriti, pa u funksionalizuar në mënyrën e duhur. Dua ta shpreh një reagim te Amrushi ku e pati në postimin, në profesionin tim. Amrush matjet bëhen dhe realizohen sipas matjeve edhe projektet. Bëhen me matje të realizume prej kompanive serioze po ashtu realizohet projekti, nuk është e natyrshme që një projekt ende pa u funksionalizu tërsisht ta marrë uji. Prandaj ne si PDK shprehim keqardhje! Shpresoj që këto vërejtje në të ardhmen dhe sa më shpejt të bëhet sanimi i këtyre problemeve të këtij projekti, sepse veturat e njerëzve të cilët i parkojnë aty që ne i kemi ofruar mundësi, me punën tonë të kenë vërshime, andaj duhet të kemi kujdes dhe të analizojmë këto situata urgjente.

Flasim për përmbajtjen e këtij projektbuxheti duhet të theksojmë një fakt shumë domethënës se ky projektbuxhet është produkt i mandatit të kaluar, ku është dashur të miratohet nga përbërja e mëparshme e Kuvendit Komunal, por ka dështuar sepse nuk ka pasur mbështetje as atëherë as tani. I njëjti dokument pothuajse me të njëjtat probleme na sillen sërisht për miratim pa reflektim dhe pa përgjegjësi politike. Ky fakt tregon qartë se problemi nuk është opozita, por paaftësia e qeverisjes komunale për të ndërtuar një konsensus, për të hartuar një buxhet të përbashkët bashkërisht për interesin e qytetarëve.

Ky projektbuxhet nuk është dokument zhvillimor, por është dëshmi e keqmenaxhimit të mungesës së verzionit dhe shkëputjes totale të pushtetit nga realiteti i qytetarëve të Malishevës. Ai nuk synon zhvillim të qëndrueshëm, por mbijetesë politike dhe propaganda mediatike. Ky projektbuxhet nuk ka prioritete reale, nuk i adreson problemet elementare të qytetarëve, rrugët lokale janë në gjendje të mjerueshme, kanalizimet mungojnë, shkollat kanë nevojë për investime serioze, ndërsa shëndetësia po injorohet. Në vend të kësaj fondet po orientohen drejt projekteve të paqarta, të fryera me kosto dhe pa ndikim real.

Së dyti shpërndarja e mjeteve është thellësisht e padrejtë dhe politike disa fshatra trajtohen si prioritet, ndërsa disa të tjera ndëshkohen për arsye partiake, kjo qasje përçarëse e shndërron buxhetin në mjet favorizimi dhe ndëshkimi.

Së treti projektet kapitale janë në vazhdimësi dështime të viteve të kaluara, të njëjtat projekte riciklohen vit pas viti pa u përfunduar, pa llogaridhënie dhe pa përgjegjësi politike.

Së katërti konsultimi me qytetarët ka qenë farës, dëgjimet publike janë mbajtur vetëm për t'i plotësuar kërkesat formale ligjore dhe zëri i qytetarëve është injoruar tërësisht.

Së pesti realizimi i buxhetit në vitet e kaluara ka qenë zhgënjyes, fondet as nuk janë shpenzuar ose janë shpenzuar keq pa ndikim real në jetën e qytetarëve, të gjitha ato nuk kanë dhënë llogari për këtë situatë, së fundi mungon transparenca e Kuvendit Komunal trajtohet si organ formal, ndërsa qyretarët mbahen jashtë informacionit për mënyrën se si shpenzohet paraja publike, si përfundim i këtij projektbuxheti i cili ka dështuar dy herë: njëherë në mandatin e kaluar besoj duhet të dështoj edhe sot, për arsye se edhe ne si PDK besoj edhe kolegët me votu këtë projektbuxhet është jolegjitim dhe është keqmenaxhim, pa drejtësinë dhe mungesën e përgjegjësisë politike. Për këtë arsye ky projektbuxhet duhet të refuzohet pa hezitim dhe duhet të kthehet për shikim, ne jemi për zhvillim të Malishevës, po jo me buxhet të dëshpëruar dhe me qeverisje të papërgjegjshme duke mos marrë asnjëherë kërkesat tona si anëtarë të Kuvendit Komunal që të bëjmë një projekt bashkërisht që ta japim më të mirën e qytetarëve të Malishevës, prandaj ne si grup i partisë së PDK e kundërshtojmë këtë projektbuxhet dhe do të votojmë **kundër**. Faleminderit!

**Fatmir Ademaj**, Kryesues i Kuvendit: Urdhëro, *Fitim Shala!*

**Fitim Shala**, nga LDK:

I nderuar Kryesues i Kuvendit Komunal, i nderuar Kryetar, të dashur anëtarë të Kuvendit Komunal, meqenëse po shfrytëzoj për herë të parë këtë foltore edhe është mandati im i parë, uroj që koha të na ec mbarë dhe të na bashkojë interesi i përgjithshëm, e natyrisht edhe kjo ditë për çfarë po diskutojmë, sot buxheti komunal i Malishevës. Ne si LDK e kemi analizu materialin edhe buxhetin, ky buxhet përfshin investime kapitale të shumta në fshatra, që ka qenë kërkesë e vazhdushme e LDK-së për çka edhe i mirëpresim. Buxheti e përfshin edhe një investim që është e pritshme për qytetarët e komunës së Malishevës, fillimin e investimit me ujësjellsin e komunës së Malishevës, ndaj kërkoj edhe nga kolegët që ta përkrahin këtë buxhet. Buxheti përfshin dhe subvencione të shumta në kulturë, rini, sport, arsim, pa e anashkaluar edhe subvencionin që do të ndodhë në bujqësi, kërkoj nga ekzekutivi që t'i rritë subvencionet në kulturë, sport dhe rini, por gjithashtu edhe bursa për studentët.

Kërkesë e vazhdushme e kam parë që ka qenë edhe në legjislaturën e kaluar renovimi i Sallës së Kuvendit, me këtë buxhet po bëhet jetik, kërkoj nga Kryetari dhe Kryesuesi i Kuvendit që këtë çështje ta përshpejtojnë, sepse po shihet edhe gjendja e Kuvendit, pa dashur të hyjë rend si përfaqësues i fshatit Ngucat, i mirëpres edhe investimet që janë të futura në këtë buxhet, invetime në rrugët lokale, hapja dhe zgjerimi i rrugës fushore të rrugës Mërkaqi, natyrisht dhe investime të shumta që do të ndodhin, rregullimi i oborrit të palestrës që është nevojë e kohës gjithashtu edhe renovimin e disa shkollave. Kërkoj nga ekzekutivi që të ketë trystni të madhe te kompanitë që e bëjnë furnizimin me material higjienik nëpër shkolla. Duke parë të gjitha këto investime ky bixhet do ta ketë përkrahjen e LDK-së, pres përkrahjen edhe nga anëtarët e tjerë të Kuvendit. Faleminderit!

**Fatmir Ademaj**, Kryesues i Kuvendit: Urdhëro, *Veton Zogaj!*

**Veton Zogaj**, nga LVV: Përshëndetje Kryetar, kolegë asambleistë!

Kryetar e kam një pyetje meqenëse është pika e rendit ditës më e rëndësishmja në legjislaturë, kush ka qenë asambleistë e di këtë çështje edhe ata të rinjtë besoj e dinë. Sot e diskutojmë projektbuxhetin për vitin 2026-2028 me theks të veçantë 2026, edhe Kryetari ende nuk na ka prezantu një Kabinet Qeverisës me të cilin ka me implementu projektbuxhetin, të cilin sot e prezantoi. Ne e kemi pasë një debat për këtë draftbuxhet edhe në legjislaturën e kaluar, e cila nuk i ka marrë votat, për arsye që i kemi dhënë vërejtjet tona dhe të cilat nuk janë përmisuar dhe nuk janë marrë parasysh nga qeverisja komunale.

Kryetar i kam disa pyetje konkrete për mos me u përsëritë në ato që i kemi thënë edhe në shtator që i kemi diskutu: e para dua ta di saktë sa është borxhi total i Komunës së Malishevës, sepse ju në këtë projektbuxhet e keni kërku prapë me votu diku 1.3 milion euro për investime në Sheshin e Dëshmorëve në Malishevë, me datën 8 gusht e keni bërë fushatën e keni promovu si projekt të përfunduar edhe realisht jeni mbytë tue promovu në fushatën elektorale: parkingun, platonë, lulet e gjithçka tjetër, në fund një rigë e shiut i mori lumi të gjitha.

Sa është borxhi i kompanisë që e ka ndërtu këtë projekt, dhe pse po kërkohen sot mbi 1,3 milion euro shtesë për me u investu në projektin e qytetit? Ndoshta 163 mijë euro janë të arsyeshme për ndërtimin e Memorialit në Shesh, të cilat na i tha profa atë ditë në KPF, por 1.2 milion euro të tjera nuk po mundem me arsyetu se çka të duhen shtesë, kjo është vetëm me kry borxhin që i keni mbetë kompanisë!

E dyta kush ka qenë asambleistë dhe kush e ka përcjellë Kuvendin Komunal në katër vitet që i lamë pas, ky rregullim i kolektorit kryesor prej 2.5 kilometra ka qenë prej vitit 2020-2021 në projektbuxhete, d.m.th. vetëm vendoset si shumë, kërkohet me u miratu, kurrë asgjë nuk bëhet. Kanalizimet vazhdojnë me ndotë lumin Mirusha edhe ndodh dështimi siç na ndodhi me këtë fatkeqësi natyrore që ndodhi 2 javë më parë. Pse e qitni në projekt dhe, pse nuk merrni diçka konkrete me e realizu? Ku është faji që gati gjysmë milioni kërkohet edhe nuk bëhet asgjë?!

Pastaj i kemi të përsëritura plot rrugë nëpër fshatra të cilat kanë kosto zero, ta zëmë renovimin e rrugëve lokale në fshatrat Vërmicë, Carrallukë, Shkarashnik, Bellanicë, Ngucat, Dragobil, Pagarushë, Lubizhdë, Turjakë, koston e kanë zero. Pse figurojnë në projektbuxhet kështu? Më poshtë rregullimi i kanalizimit: Bubavec, Kijevë, Drenoc, Banjë, lagjja Mirdita në Malishevë, koston e ka zero, pse del kështu ky projekt dhe ka koston zero? Prapë e kemi të ndamë si kategori dhe i kam kërkuar me sjellë si draft të shënuara emrat e rrugëve, sepse nuk mund ta dime se për cilën rrugë po bëhet fjalë?

Ndërtimi i trajtimit të pastrimit të lumit Mirusha me një vend kërkohen 500,000 euro dhe me një vend tjetër 50,000 euro shtesë, në rregullimin e rrugëve anësore, pse nuk janë bërë me një kategori të caktuar dhe me u mbledhë shuma totale 550,000 euro, por ndahen kështu? Ai është një projekt pastrimi dhe rregullimi i fshatit? Lumi Mirusha prej urës në qendër të qytetit deri në urën mbi tranzit. Pse figuron kështu e ndarë dhe, a mundemi me ditë sa ka me investu komuna këtu? E dimë që komuna është në bashkëfinancim me nivelin qendror përmes grandit të përfomancës që ka dhënë një pjesë. Sa është shuma totale nëse në vitin 2026 ka kushtuar 500 mijë euro, sa kërkohen në 2027-2028, kur do të përfundojë si projekt?

Çështja tjetër, ju e keni pasë në fushatë Malisheva Urbane në të kaluarën, i keni pasur dy projekte të Malishevës Urbane, rrugën Ish-"Rilindja kombëtare" – Ibrahim Mazreku, tani Bulevardi dhe Sheshin e Dëshmorëve, keni thënë në katërvjeçarin e ardhshëm kemi me u fokusu në infrastrukturën nëpër fshatra, tani e kemi një buxhet për investime kapitale mbi 5.3 milion euro, e kemi 1,210,000 euro që duhet me u investu ose me la borxh për tek Sheshi. E kemi lumi Mirusha 500,000 euro, nuk jam kundër me investu në Shesh. E kemi Palestrën Sportive "Ibrahim Mazreku". Dmth shkoi komplet buxheti për investime në Malishevë, ndërsa 15 fshatra e keni vendosë një shumë buxhetore prej 50,000 euro për renovimin e rrugëve. Më thuani ju mua me shtru asfaltë 50,000 mijë euro sa metra bëjnë me u shtru? Burimi është profesionist i kësaj fushe ky mundet me na tregu se sa kushton një oborr me shtru në kubëza (kocka), kushton 50 mijë euro, kjo është hajgare kështu me qytetarë.

E dimë që i keni votat edhe e kaloni, qysh e keni kalu katër vitet e tjera, mirëpo puna nuk po përfundohet. Këto kush po i përcjell kolegë asambleistë nëse pritoni me i lexu të gjitha projektbuxhetet e viteve paraprake merrni këqyrni procesverbalet në web faqen e komunës edhe i shihni këto diskutimet e mia; Valjeta, Burimi dhe të tjerët që kemi folë për këto projekte një nga një edhe prapë sot i gjejmë prej 2021 të përsëritura. D.m.th. po mjafton me ju qitë hi syve qytetarëve me iu thënë e kam vendos një rrugë tek lagjja jote, por kur realizohet nuk i dihet. Kur ka me ardhë koha me u realizu ajo s'bëhet kurrë, thoni që na jemi të zhytur në borxhe i kem kompanisë, janë pllakatat e "Famis-it" ato nuk guxon m'i largu, sepse i kemi borxhe dhe pa e la borxhin nuk po mundemi me i largu. Po më vjen keq që po duhet me i diskutu në këtë mënyrë, po nuk po ka alternativë tjetër, ka me ardhë një moment që edhe qytetarët nuk ta japin votën. Nëse ti vazhdon m'i përsëritë projektet buxhet pas buxheti asnjë prej këtyre nuk gjen zbatueshmëri është hajgare.

Faleminderit shumë!

**Fatmir Ademaj,** Kryesues i Kuvendit: Urdhëro, *Enver Hoti*!

**Enver Hoti,** nga AAK:

I nderuar Kryetar, i nderuar Kryesues, media, të nderuar qytetarë të Komunes sonë, të nderuar asambleistë.

Sot unë mendoj që duhet të ishte një ditë e cila do të na bashkonte të gjithëve si asambleistë pavarësisht cilit subjekt i takojmë dhe cilit pozicion i takojmë: pozitë apo opozitë, sepse jemi duke trajtur temën më jetike dhe më të rëndësishme për qytetarët e Komunës, siç është buxheti i Komunës sonë. Buxheti i cili do ta garantojë dhe do ta sigurojë mirëqenien, të arriturat dhe zhvillimin për ata dhe çka e presin qytetarët.

Kryetar nuk isha në prezantimin që e bëtë në fillim, po u mundova pak a shumë ta përcjell edhe Drejtorin e Financave, dhe unë i kam disa çështje të cilat dua t'i shpreh. I kam disa vërejtje në fillim në organizimin e kësaj seance mendoj që keni pasur kohë të mjaftueshme nuk është dashtë të thirret seancë e jashtëzakonshme, është dashtë ta kemi kohën e mjaftushme dhe të furnizohemi më herët me materiale, apo me dokumente të nevojshme dhe ta trajtojmë në mënyrë më të qetë me kohë pak ma të gjatë edhe t'i japim propozimet tona.

Vërejtja e dytë Kryetar është me luajtë një rol më pozitivë m'i ofru opozitës bashkëpunim, sepse kemi të bëjmë me buxhetin, dhe ai është i të gjithë qytetarëve. Ne kemi disa projeksione tona që mendojmë që janë në interesin e qytetarëve, të bëhemi pjesë e këtij buxheti pse jo. Nëse fokusohemi vetëm në numra, atëherë e drejta e numrave e jep mundësinë dhe të drejtën, por nëse fokusohemi te interesi i qytetarëve ne si përfaqësues të tyre, mendoj që është dashtë me pranu opozitën dhe të ndikosh më shumë që të krijohet një hapësirë së paku e diskutimeve. Me mundësi që ne të jemi pjesë aktive në projektet buxhetore e sigurisht do të kishim ndihmuar më shumë në realizimin e këtij procesi.

Nëse hyjmë te tema që jemi sot unë i kam disa vërejtje se këtu e pamë edhe njëherë që po vazhdon investimi në Shesh, është një pyetje direkte a përfundon me këto mjete, me këtë projektsion investimi? Sheshi icili është diskutuar mjaft gjatë dhe nuk do të marrë kohë më shumë, është një shumë jashtëzakonisht e madhe e cila kalon mbi 1,200,000 euro si vazhdimësi e atij projeksioni investiv, dhe a përfundon me këtë projeksion me këto të dhëna 1,200,000 euro? Është një pyetje që mendoj që e presin edhe qytetarët, dhe ju e dini që unë nuk jam që të ndërprehet, jam që të vazhdohet të realizohet, por a përfundon këtu?

Ajo që kishte qenë mirë sot që ky projektbuxhet nuk e acepton si problem të tillë qendrën siç është parë këtu, por e tha Drejtori i Financave për disa projekte që janë këtu shumë të rëndësishme në vazhdimsi në zhvillimin e ardhshëm 2026-2028, janë të planifikuara shumë projeksione nëpër fshatra me akse, por pa informacion shtesë. Ishte dashur t'i sillni ato projekte ta kishte lehtësu ty punën, ndoshta si të tilla s'mund t'i dërgosh në Ministri të Financave, së paku ne jemi këtu nuk jemi në Ministri të Financave, sepse ndoshta nuk kish thënë ndonjë zyrtar në fshat që ka një autoritet shtesë që të thotë, po dua me ndërru këtë rrugë me vendos këndej, sepse kam vota apo nuk kam vota, e kishim ditë pse po votojmë për cilin projekt, për cilën rrugë, sa gjatësi çfarë përmase. Nuk ish bërë asgjë me sjellë një aneks shtesë me të dhëna që janë të nevojshme.

Kryetar ka këtu disa të dhëna tjera që i përfshijnë disa fusha për qytetarët e Malisheves që janë të rëndësishme, për shembull gjendja në arsimim që mendoj është dashur të bëhen projeksione më të detajuara, me investime më të mëdha, sepse nuk e kemi mirë gjendjen në shkolla, me investime të cilat në këtë rast garanton një proces të qetë dhe të mirë zhvillimor. Në rini i shikova nëse nuk gaboj afër 200,000 euro ishin, të cilat janë pak. Po ashtu në bujqësi i keni planifiku 200,000 euro, e kemi edhe drejtorin këtu që e pyeta se a të ka pyet kush ajo kur ka qenë si propozim me hy në projektbuxhet që e mendoj pak, besojmë ke pasë mundësi si pjesë e qeverisë komunale me shtu financimin edhe investimin në këto çështje.

Nuk kam parë që keni bërë ndonjë planifikim ose së paku inicim për t'u bërë një zhvillim ekonomik, sepse bizneset kanë nevojë dhe ata presin që Qeveria Komunale të ofrojë infrastrukturë financiare, po edhe infrastrukturë tjetër administrative, që bizneset të zhvillohen akoma më shumë. Mendoj që duhet të mendohet seriozisht për zhvillimin ekonomik, unë ia kisha propozu Kryetarit që të mbahet edhe një seancë tjetër dhe ta diskutojmë pozitë dhe opozitë dhe të na përmisoni në ato çka i ceka më herët, nëse i ka Drejtoria e Urbanizmit, na furnizoni edhe me ato t'ia shtojmë edhe të bëhemi pjesë e votimit. Nuk e di sa e merrni parasysh, por mendoj që do të ishte mirë që m'u konsultu edhe m'u mbajtë edhe një seancë e vazhdushme tjetër.

Ju faleminderit.

**Fatmir Ademaj,** Kryesues i Kuvendit: Urdhëro, *Amrush Helshani!*

**Amrush Helshani**, nga Nisma Socialdemokrate:

Faleminderit për fjalën i nderuar Kryesues, z. Fatmir Ademaj, i nderuar Kryetar i Komunës, zotri Ekrem Kastrati, të nderuar kolegë dhe anëtar të Kuvendt të Komunës së Malishevës, media. Meqenëse zyrtarisht është fjala ime e parë në këtë përbërje të Kuvendit të Komunes së Malishevës, më lejoni që fillimisht t'ju uroj të gjithve për mandatin e marrë duke dëshiruar punë të mbaë bashkëpunim dhe përfaqsim dinjitoz në shërbim të qytetarëve të Komunës së Malishevës. Falënderoj nga zemra të gjithë votuesit nga çdo fshat, nga çdo lagje, për besimin që më kanë dhënë që të jem përfaqësues i tyre në Kuvendin Komunal. Në mënyë të veçantë dua t'i falënderoj bashëvendasit e mi nga Ngucati si dhe mërgimtarët tanë për mbështetjen dhe besimin ndaj kanditatures sime, sepse ky është besim që më obligon të jem zë i përgjegjshëm dhe përfaqësues korrekt i interesave të qytetarëve të Komunës së Malishevës padallim.

Të nderuar antarë të Kuvendit, qytetarë të Komunës së Malishevës sot ne po shqyrtojmë dhe po votojmë një projektbuxhet për vitet 2026 -2028, një dokument tejet të rëndsishëm për zhvillimin e komunës sonë. Ky buxhet reflekton Programin qeverisës, prioritet zvillimore dhe angazhimin institucional për përmirësimin e jetës së qytetarëve, e vlerësoj këtë projektbuxhet si realist dhe të orientuar drejt nevojave konkrete të qytetarëve në çdo fshat, duke përfshirë investime në infrastrukturë, arësim, shëndetësi, bujqësi, mirëqenie sociale, barazi gjinore dhe zhvillim ekonomik lokal. Besoj se ky buxhet është ndërtuar mbi parimin e përgjëgjsisë, transparencës dhe shpërndarjes së drejt të mjeteve publike dhe do të ndikojë drejpërdrejt në përfaqsimin e shërbimeve dhe krijimin e kushteve më të mira për jetë në komunën e Malishevës. Me këtë frymë shpreh mbështetje të plotë për miratimin e këtij buxheti me bindjen se zbatimi i tij do të sjellë zhvillim të qëndrueshëm dhe përfitime konkrete për qytetarët tanë.

Faleminderit.

**Fatmir Ademaj,** Kryesues i Kuvendit: Urdhëro, *Sylë Dukolli!*

**Sylë Dukolli,** nga Nisma Socialdemokrate.

I nderuar Kryesues, përshëndetje Kryetar, Drejtor i Financave dhe ju të gjithë asambleistë, urime të gjithëve mandati dhe ishalla jua përmbush kërkesat të gjithë atyre që ju kanë votuar. Jemi në ditën e aprovimit të buxhetit për vitit 2026, buxhet ky siç tha edhe drejtori është hartuar më herët, unë mendoj që është i pranueshëm sa i përket shpërndarjes së buxhetit nëpër kategori të ndryshme nëpër fshatra. Unë në cilësinë e drejtorit që kam qenë këtu në seancë besoj përherë e kam parë që ka pasë kërkesa të vazhdueshme nga ju që vini nga fshatrat e ndryshme për mos investime në fshatra për arsye të projektit të madh dhe që e ceku dikush që i keni dhe disa mjete borxh. Po flas për shefin e grupit të LVV-së, ju keni thënë që nuk keni me mujtë me dalë prej borxhit, m'u duk shumë pak çka the ti, sepse është punu shumë. Në anën tjetër një përfaqsues i PDK-së pra Burimi që e përshëndes, realisht çka ka folë ka folë jashtë vetes.

Të kisha thënë që kush të ka thënë ashtu me folë, fol brenda vullnetit tënd se unë të njoh dhe e di që nuk ke folë brenda vullnetit tënd, por në politikë këto gjëra lejohen. Më pëlqej fjalimi i Enverit, jo që e kam shok të mirë, por në kategorinë që kam udhëhequr në drejtorinë time, më kanë pyetur, por mua vetëm pak mjete me m'i ofru unë bashkëpunoj me organizata të tjera dhe ia dal, kurrë më shumë nuk është dhënë se që 3 vjet subvencione për bujqit dhe fermerët e komunës së Malishevës. Buxheti i shpërndarë në të gjitha fshatrat ishte në mënyrën më të drejtë të mundshme. Çdo fshat do të ketë asfalltim të rrugëve të vogla nga 200|300 metra sa kanë mbetë, kanalizime, infrastrukturë përcjellëse që besoj se do t'i prekë të gjitha lagjet e fshatrave tona. Besoj që edhe ato do të bëhen më urbane dhe ndriçim, i cili është i kontraktuar edhe pse buxheti na dënon për 500,000 - 600,000euro më pak për shkak të numrit të banorëve i cili është bërë nga regjistrimi i fundit. Të gjithëve na bjen mirë me këtë projekt çdo fshati çdo banori të komunës së Malishevës. E meriton aprovimin tuaj dhe kërkoj që bashkërisht të dalim sikur qysh kemi dalë nganjëherë me një miratim të përgjithëshëm të buxhetit nga të gjitha grupet duke ju falënderuar dhe duke ju thirrë për angazhime. Ju falëminderit Kryesues për fjalën që ma dhe.

**Fatmir Ademaj**, Kryesues i Kuvendit: Urdhëro, *Valjeta Hoti!*

**Valjetë Hoti**, nga PDK: Faleminderit Kryesues, përshëndetje për të gjithë!

Meqë është hera e parë që po ju drejtohem në këtë seancë, shfrytëzoj rastin me ju uru të gjithë juve kolegë, po ashtu uroj që kjo sallë, kjo hapësirë të na shërbejë si hapësirë dialogu, respekti dhe vendimmarrje në të mirën e qytetarëve.Veton unë pajtohem me atë çka the ti pak më herët që po mjaftojke një analizë e shpejtë edhe shumë lehtë me ardhë në përfundim që buxheti i ri, projekte të vjetra që nuk na kanë dhënë rezultat as në mandatin e kaluar. Fokusi prapë kish mbet i njëjtë planifikim nuk pashë dhe si projektbuxhet nuk po premtojke ndonjë dryshim real, dhe si asambleiste e mandatit të kaluar e them me bindje që asnjëherë nuk kemi pasë raport ose analizë për këto projekte dhe tani këto investime ju që i keni paraparë përsëri në këtë projektbuxhet se çka po punohet edhe deri ku kanë arritë këto punime, andaj e them që edhe ky projektbuxhet që nuk po premtojka transparencë.

Pse mendoj kështu? Se financimi i investimeve kapitale mjafton m'u ndalë te pjesa e arsimit ku e kemi ndërtimin e shkollës fillore në Turjakë në vitin 2022 në projektbuxhetin që është parapa për periudhën 2023/2025 është caktuar një shumë prej 100,000 euro, në projektbuxhetin 2025/2027 në vitin 2023 që është miratu ky projektbuxhet e kemi paraparë totalin prej 192,000 euro, e për këtë projektbuxhet kish arritë shumën prej 265,000 euro. Keni parapa investime të reja renovimin e shkollave që po përsëriten vazhdimisht, sa shpesh duhet me ndodhë ky renovim? Kush i përcakton që këto renovime duhet me u përfshi në projektbuxhet, sepse po flasim për shkollat që kanë mungesë të elementeve, të kushteve bazike, shkollat që nuk kanë printer edhe ato që kanë printer çdoherë kanë mungesë letre ose ngjyre. Po flasim për shkolla që nuk kanë kabinete, po ashtu edhe lëndët djegëse për çdo dimër janë mungesë.

Te planifikimi hapësinor dhe urban e kemi edhe ndërtimin e qendrës, Sheshit që është i ripërsëritur, është ndërtimi i rrugës Habib Berisha deri te stadiumi dhe oborri i qendrës sportive, prapë ishin përsëritë si investime të reja edhe në këtë projektbuxhet. Ndërtimi i rrugëve ishin përmendur 2-3 lagje edhe ishin shku kësaj here me akse puna që më lehtë me kriju konfuzion te ata që e marrin këtë projektbuxhet edhe e lexojnë. Pastaj ke edhe rregullimin e kolektorit të ujërave të zeza e ceku edhe Vetoni është 2.5 km prej vitit 2022 nuk është punë me përfundu. Ke edhe renovim të rrugëve Drenoc, Carrallukë,Vermicë, Shkarashnik, unë jetoj në Carrallukë edhe nuk kam parë ndonjë renovim ose ndonjë ndërtim të rrugve që po bëhet apo që është bërë edhe më herët.

Është edhe rregullimi i kanalizimeve kemi edhe mjekësinë e kemi ndërtimin e QMF-së në Kijevë, ndërtimi i Shtëpisë për përsona me aftësi të kufizuara ka edhe disa prej tyre, por shkova në disa që i mendoj si më të rëndësishme dhe mos me zgjatë më shumë. E kam një pyetje për juve, pse neve na duhet me votu këtë projektbuxhet me krejt këto mangësi, të gjitha këto të meta, projekte prej mandatit të kaluar që kanë fillu mjetet janë ndarë edhe nuk kanë përfundu.

Falëminderit.

**Fatmir Ademaj,** Kryesues i Kuvendit: Urdhëro, *Demir Bajra!*

**Demir Bajra**, nga PDK: Përshëndetje asambleistë, zotëri Kryetar, Ekrem Kastrati!

Është hera e parë në këtë legjislaturë që po e marr fjalën, ju përgëzoj për mandatin e dytë, ju urojë shëndet dhe punë të mbarë! Po kyçna menjëherë në projektbuxhetin e paraparë për vitin 2026/2028 në kohën kur kemi ardhë ne asnjëherë nuk besoj qoftë PDK,VV, NISMA, LDK p.sh: të jemi kundër një subjekti politik, por paraprakisht është mirë që të mundohemi ta ndajmë këtë pjesë, këtë hise që e kemi në minues në bazë të banorëve për disa mija euro edhe ne është mirë që t'i shohim me Kryetarin, me dikasteret që ta bëjmë një ndamje proporcionale e jo sipas mundësive partiake dhe të investojmë.

Kur është fjala për renovime në shkolla unë di që ka një fshat që 99% e njohin të gjithë e pashë rinovimi shkollës "Asim Vokshi" Panorc, Kryetar po të drejtohem direkt mua më ka prekur shumë, sepse është një investim bukur mirë aty, dhe ajo shkollë, sapo ka filluar nuk i ka as 2 vjet që është prerë shiriti. A është bërë gabim teknik prej dikujt nuk e di, por besoj diçka nuk e pashë në rregull, sepse te masa, te qytetarët e komunës së Malishevës kjo ndikon shumë. Burimi tha që nuk do të jemi pro, sepse nuk kemi bashkëpunim, Kryetar ne prej 3 dhjetorit kemi ardhë në këtë Kuvend duke thirrur mbledhje urgjente, të jashtëzakonshme dhe uroj që mbledhja e ardhshme mos të jetë e jashtëzakonshme, por të jetë mbledhje e rregullt. Edhe po bazohem tek organet e fshatrave që i keni zgjedhur keni qenë edhe ju vetë aty që isha prezent, i kemi kryetarët e Bashkësive lokale, a duhet të vetëdijesohemi ndonjëherë si shoqëri që t'i respektojmë edhe ata që janë zgjedhur nga qytetarët, a do të mirren parasysh kërkesat e Bashkësisë lokale të vijnë deri këtu, të merret parasysh. Që nga viti 2012|2013 ne kemi ardhë në pushtet, unë kam qenë pjesë e Nismës janë projektet të bartura Kryetar, për ata po flas me sinqeritetin më të madh njerëzor dhe moral që kam.

Projektet e bartura prej vitit 2013 e deri më sot, t'i silleni këtu në projektor i shohim projektbuxhetin prej vitit 2013 e deri më sot i shohim që vetëm bartën. Së paku ta kemi një mirëkuptim edhe ne nuk jemi të kënaqur që mos me votu projektbuxhetin për vitin 2026-2028, edhe ne jemi pjesë e Malishevës, dhe ne jemi taksapagues të Malishevës. Nuk jemi armiq të Nismës, por jemi vëllezër, jemi shokë kështu që kërkoj Kryetar ta shtyjmë dhe ta gjejmë një modalitet dhe ta gjejmë një konsensues, sepse as ne nuk jemi të kënaqur që mos të votohet projektbuxheti për vitin 2026-2028 nga PDK-ja.

**Fatmir Ademaj**, Kryesues i Kuvendit: Urdhëro, *Veton Zogaj* një minut replikë!

**Veton Zogaj** nga LVV: Replikë edhe për ju Kryesues praktika e kuvendit, qoftë Kuvendi i Republikës apo dhe kuvendet e tjera komunale është mirë që replikën e merr dhe pse kanë kërkuar të tjerët fjalën, e merr menjëherë pasi ta përfundojë parafolësi, sepse i humb kuptimi. Syla ka përvojën e duhur besoj që e di që nëse një projektit i prehet shiriti dhe promovohet ai kuptohet që është përfunduar çdo obligim, edhe financiar dhe çdo gjë pastaj bëhet promovimi. Kaq kisha, pyetja ime ishte shumë e drejtë jo tendencioze që opinion publik, taksapaguesit në këtë vend duhet ta dinë se sa borxh i kemi kompanisë që i ka bërë punimet e Sheshit të Dëshmorëve në Malishevë.

**Fatmir Ademaj,** Kryesues i Kuvendit**:** Veton vlerësoj që të gjitha pyetjet që janë duke iu bërë drejtori dhe Kryetari i Komunës në fund do t'i trajtojnë. Kështu që fjalën e kaloj te *Halili!*

**Halil Morina**, nga Nisma Socialdemokrate:

Në mbledhjen e ardhshme është mirë secilit me ia sjellë Rregulloren e Punës së Kuvendit, secili anëtar i Kuvendit me pasë parasysh se kur ka të drejtë me marrë fjalën, sa minuta ka drejtë, dhe kur ka të drejtë të bëjë replikë. U cekën vërshimet sa herë që ndodhin fatkeqësi natyrore kjo e fundit që ka ndodhë në vendin tonë dhe në komunën tonë, njerëzit bëhen bashkë në fatkeqësi natyrore, bëhen bashkë me u bë ballë sfidave dhe problemeve që i sjellin këto fatkeqësi natyrore. Kur mbaron fatkeqësia natyrore pastaj mundemi me i pasë kritikat tona për gabimet të cilat ka mundur t'i bëjë dora e njeriut dhe që ka shkaktu ende më shumë problem në fatkeqësi natyrore. Atë ditë që kanë ndodhur vërshimet unë i kam parë shumicën e kolegëve këtu opozitarë që në atë moment kanë filluar të bëjnë kritika politike, kjo më bënë me kuptu që këta nuk i ka shqetësuar fakti që po ndodhin vërshimet, por janë përpjekur me i instrumentalizu këto probleme të vërshimeve me ndërtu argumente politike.

Është disfatizëm politik me pritë prej fatkeqësive natyrore me të ndihmu ty për të bërë politikë përmes fatkeqësive natyrore. Shpresoj që kurrë mos të ketë fatkeqësi natyrore në vendin tonë, në komunën tonë, por sa herë që të ketë ëshë mirë të bëhemi bashkë me i tejkalu ato fatkeqësi dhe pastaj me u marrë me problematikat tona dhe dorën e njeriut. Qyteti jonë ka nevojë për trajtime të ujërave, sidomos në dalje të qytetit në mënyrë që me hap rrugën ujit mos me u mbledhë, sepse kjo dihet që kur të mbledhet uji do të vijnë në nënkalim në parkingun nëntokësor, pra nuk është faji i nënkalimit dhe parkingut nëntokësor, faji që nuk janë trajtu ujërat në dalje të qytetit dhe këto ujëra do të mbledhen diku dhe kanë me gjetë ku është pika më e ulët për me u tubu.

Ky projektbuxhet në secilën kategori ka pak para, por këto janë mundësitë tona nuk kemi më shumë para për me i rritë, mirëpo detyrë e ekzekutivit dhe e të gjithë neve është që me pa mundësi dhe me gjetë alternativa tjera për m'i ndihmu këtij buxheti. E ceku Syla në mandatin e kaluar Qeveria, Kryetari i Komunës kanë bashkëpunu me shumë organizata, ndërkombëtare janë përfituar më shumë se 1 milion euro vetëm prej "Qatar Charity," në bujqësi dhe sectorë të tjerë. Me organizatat e brendshme kemi bashkëpunu me "Jetimat e Ballkanit", mbi 2 milion euro investime për kategorinë e fëmijëve me nevoja të veçanta dhe pleqëve. Kjo është hapësira e qeverisë që nuk bazohet vetëm në buxhetin e vetë, por gjen alternativa, fonde, donacione për me i plotësu nevojat e qytetarëve. Me pasë qenë në opozitë kurrë nuk kisha kërkuar të bëjë bashkë buxhet me qeverinë, nëse qeveria e ka propozu një buxhet kisha dalë kisha thënë që ky buxhet nuk është i mirë, t'kisha qenë unë në pushtet paratë i kisha dërgu në këtë projekt, dhe kisha kërkuar prej qytetarëve që herën tjetër të më votojnë mua, sepse unë kam ide më të mira për buxhetin sesa këta që janë në pushtet. Me kërku ta bëjnë bashkë buxhetin është me kërku me u bërë pjesë e qeverisë, është e vërtetë që në pika të caktuara ne mund të bëjmë bashkëpunim me marrë ide prej njëri-tjetrit, por nëse kërkohet me u ulë ta bëjmë bashkë buxhetin atëherë këtu më nuk ka pozitë e opozitë, nuk ka më demokraci, por ka sistem njëpartiak dhe shyqyr që nuk e kemi më atë sistem.

**Fatmir Ademaj**, Kryesues i Kuvendit: Urdhëro, *Enver Hoti* replikë!

**Enver Hoti**, nga AAK: Është dashur që ky projektbuxhet të miratohet vitin e kaluar meqë jemi ardhë në këtë pikë është dashur ne me pasë propozimin me kohë dhe me trajtu. Kemi të drejtën si përfaqësues opozitarë me dërgu projektsionet tona përmes administratës rrugëve që janë krejtësisht legjitime dhe me kërku si propozime. Nëse i kish fut qeveria Komunale në buxhetin aktual mirë, nëse jo kaq, askush nuk është duke kërkuar me u ulë me bërë qeverinë bashkë. Kjo është një retorikë që e gënjen publikun, gënjeshtrat shmangëni. Ne kemi kaluar një situatë të vështirë dhe është dashur që së paku me pas një ndryshim ky projektbuxhet që me fillu një fazë të planifikimit, sepse prapë do të bjerë shi, prapë do të kemi një situate të tillë dhe ndoshta planifikimi buxhetor i qeverisë qendrore pas gjashtë muajve kemi mundur ta bëjmë një kërkesë të planifikuar mirë të trajtuar mirë që me fitu një investim, sepse Komuna nuk e ka potencialin m'i marrë të gjitha masat t'i sanojë dëmet të cilat e dëmtojnë Komunën tonë. Vërshimet janë të përditshme, prandaj ne si institucion duhet me vepru dhe m'i parandalu këto, jo m'i lënë në mëshirën e Zotit. Nuk kemi bërë politikë me vërshime, por kemi mbështet publikisht të gjitha masat të cilat i ka marrë komuna dhe ekipet përkatëse. Mendoj që është e arsyeshme me pasë një mundësi sidomos në situatën e emergjencave, që me u obligu ne si institucione me na u hap rruga me kërku diçka me na investu. E ke gjendjen te diga është jashtëzakonisht e rrezikshme, rrezikon dhjetra jetëra të qytetarëve. Opozitës t'i jepet një hapësirë, sepse buxheti është i taksapaguesëve të Malishevës. Ju falëminderit.

**Fatmir Ademaj**, Kryesues i Kuvendit: Duke e pasur në konsideratë të kaluarën tënde si Kryesues i Kuvendit por edhe në pozita shtetërore nuk ju ndërpreva fare, në të njëjtën kohë kërkojë nga antarët e Asamblesë Komunale ta respektojnë minutazhin në këto pika.

Urdhëro për replikë *Halil Morina.*

**Halil Morina,** nga Nisma Socialdemokrate: Për çështjet të cilat unë i ngrita pjesa më e madhe e antarëve të Kuvendit prej opozitës i kanë thënë të njëjtat gjëra pak a shumë. Kështu që kur unë flas nuk gënjej e jap opinionin. Askush nuk ka thënë që anëtarët e Kuvendit nuk kanë të drejtë me dhënë propozime këtu, por e kanë hapësirën mund t'i japin propozimet e veta këtu, por kjo puna e spekulimit politikë, e gënjeshtrës nuk kanë të bëjnë fare me mua, as me fjalimin tim, atë çfarë e thashë unë e thashë opinion timin dhe i qëndroj opinionit tim. Uroj që këtë vit mos të ketë fatkeqësi natyrore, por nëse do të ketë mos të përdorin politikisht të paktën kur është duke ndodhur ajo fatkeqësi natyrore, mbasi të mbarojnë ato pastaj mund të ngrisim shqetësimet dhe shohim ku i kemi çështjet.

**Fatmir Ademaj,** Kryesues i Kuvendit: Faleminderit, fjalën e ka kërkuar Imrani. Urdhëro *Imran Xhyliqi.*

**Imran Xhyliqi,** nga PDK: Faleminderit do të ishte mirë me sjellë atë Rregullore, sepse më është lodhur dora duke e ngritur, dikush me folë tre herë e dikush asnjëherë nuk është në rregull. I nderuar Kryetar urime për zgjedhjen, i nderuar Kryesues të dashur bashkëkolegë asambleistë! Këtu para nesh e kemi buxhetin për vitin 2026-2027- dhe 2028 nuk kam marrë pjesë asnjëherë në debat për projektbuxhet, sepse nuk kam qenë asambleist në legjislaturat e kaluara, por unë kam bërë projekte në fakultet sa kam qenë, e kam bërë prezantimin e temave të ndryshme, një prezantim shumë më të mirë, më të detajuar dhe me kosto shumë më të vogla.

Sa i përket projektbuxhetit pikësëpari këtu më duket që kanë dështuar me dëgjim publik, sepse nëse keni mbajtur dëgjime publike ju e keni bërë me antarët tuaj të Nismës. Kjo është çështje kryesore që nuk keni marrë nevojat e qytetarëve, bashkëfshatarëve tanë nëpër fshatra, ju i keni futur në projektbuxhet vetëm nevojat ndoshta të antarëve të Nisma-s. Ju i keni përmendur kur e keni miratuar buxhetin për vitin 2025/2026 dhe 2027 e keni paraparë që në ndërtime në shesh mos me u ndarë asnjë cent më, sot janë ndarë mbi 1,200,000.00 €, kur ju e keni vlerësuar që në vitin 2024 që në vitin 2026 mos me u ndarë asnjë cent për Sheshin sot kjo vlerë 1,200,000.00 € a është borxh? A ka me u ndërtuar apo ka me u shtruar dukat nuk e di çfarë do të bëhet këtu?

Kur sheh këtë buxhet 10,000,000,00 € e sheh këtë park, Shesh, parking nënkalim 10,000,000.00€ plus tjetra jepen 1,200,000.00 € nuk e di çfarë janë duke bërë me këto para për besë, unë jam ekonomist vetë e di me bërë llogaritjen bashkarisht me Avniun edhe Burimin, një objekt banesor i cili është ndoshta dhjetë kate dhe ka njëqind parkingje poshtë nuk kushton 10,000,000.00 € m'u ndërtu, kjo më habit, plus i jepen edhe 1,200,000.00 € shtesë kjo nuk ka sens. Një tjetër temë e cila ka vlerën prej 70,000.00 € rregullimi i parkut te Sheshi në qendër të Malishevës ku gjendet ky park, unë nuk jam duke e parë ndoshta unë jam verëbuar nuk jam duke e parë, të paktën nuk ka park. Gjëja e vetme kryesore e cila nuk është përmendur pas shumë replikave, e shumë thënieve e kemi ujësjellësin i keni ndarë 100,000.00€ për ujësjellës për vitin 2026, kurse vitin 2027 dhe 2028 e keni vlerësuar me zero që nuk ka nevojë për ujësjellës, ndërsa bashkëfshatarët tanë i çelin puset me 10,000.00€ çdo ditë e ju e shihni që duhet me investuar me zero euro në ujësjellës, ose dil dhe thuaju Kryetar qytetarëve që nuk keni

ujë dhe nuk do të keni edhe për katër vjet sa do të jem unë, të paktën ashtu thuaju ose mos dilni këtu me na proklamuar asfalt, sepse jemi ngopur asfalt.

Sa i përket kësaj aksi një aksi dy dhe tre i keni përfshirë vetëm katrëmbëdhjetë fshatra mos thuani krejt komunën e Malishevës i keni përfshirë aksi një, dy, tre, katër, pesë, dhe as ju vetë faktikisht nuk e dini çfarë keni bërë edhe e keni përfshirë aksi një edhe i keni ndarë 200,000.00€ kjo po më duket absurde. E vetmja gjë e cila më pëlqeu këtu është ajo që e ceku kolegia Valjeta dhe prej kolegut Vetonit për grumbullin e ujërave të zeza, e cila nuk është bartur çdo vit, të paktën nuk e kam parë që nuk ka përfunduar kurrë, me të vërtetë punës së mirë i them puna e mbarë, sepse nuk ju kam inat personal juve as si Kryetar as ju të tjerëve që jeni bërë bashkë. Unë punës së mirë i them puna e mbarë, mirëpo kjo nuk është punë e mirë 7,000,000.00€ për vitin 2026, 2027, 2028 për asfallt, kurse mos me paraparë asnjë cent për ujë kjo nuk është në rregull.

**Fatmir Ademaj**, Kryesues i Kuvendit: Ju lutem më shkurt sepse e keni përfunduar kohën.

**Imran Xhyliqi**, nga PDK: E di që e kam përfunduar kohën, por përderisa nuk ia tërhiqni vërejtjen askujt, deri tani mos ma tërhiqni vërejtjen as mua.

**Fatmir Ademaj**, Kryesues i Kuvendit: Ju lutem përfundojeni fjalimin!

**Imran Xhyliqi**, nga PDK: E keni paraparë te shëndetësia edhe te kultura rinia dhe sporti edhe tek arsimi më falni, nuk dëshiroj të futem te shëndetësia, por te kultura, rinia dhe sporti zero euro për rininë, asnjë euro s'keni paraparë t'ia ndani ndonjë të riu t'i jepni motiv me hap një biznes mos me dalë jashtë vendit? Zero euro i keni paraparë për organizatat joqeveritare, zero euro e keni paraparë për bursa, asnjë euro nuk e keni ndarë për organizatat e dala nga lufta. Ju e dini shumë mirë që Metushi shumicën e kohës edhe lulet që shkojnë te varrezat i blen prej buxhetit të vetë kurse e keni paraparë me zero euro.

**Fatmir Ademaj**, Kryesues i Kuvendit: Ju lutemi përfundojeni!

**Imran Xhyliqi**, nga PDK: Sa i përket Maralisë edhe e përfundova, sepse vij nga ky fshat.

**Fatmir Ademaj**, Kryesues i Kuvendit: Këtu nuk jeni i fshatit, por jeni anëtar i Kuvendit.

**Imran Xhyliqi**, nga PDK: Shumicën e votave i kemi marrë nga fshati. E përmendi Syla nëse nuk gaboj që tha se nuk është projketbuxhet për PDK-në, por është për fshatra. A dëshironi t'i hyj me emra në Marali që i keni shtruar rrugët vetëm për anëtarët e juaj edhe ku është një antarë i PDK-së ose AAK-së që dëshironi shkojmë me emra. Po përmendi që shtatë vjet apo sa janë dritat në Marali vetëm te dyertë e mia nuk kanë vendosur dritë, duke ia filluar rrugës prej Dragobilit deri në Pagarushë tek dyert e mia nuk e keni vendosur dritën, tjetra është që ju nuk e keni paraparë asnjë cent në Marali me investu mos hajdeni me lyp vota andej!

**Fatmir Ademaj**, Kryesues i Kuvendit: Faleminderit! Fjalën e ka *Bashkimi* pastaj *Burimi*.

**Bashkim Krasniqi,** nga Nisma Socialdemokrate: Faleminderit Kryesus i nderuar Kryetar, drejtorë të nderuar antarë të Kuvendit Komunal.

Urime të gjithëve mandati i ri shpresoj që do t'ju shkojë mbarë, ashtu si është thirrur kjo mbledhje si urgjente unë besoj që edhe këto që janë paraparë rregullimi i sallës rregullimi i ujërave etj. për shkak të vërshimit janë po ashtu urgjente dhe besoj të mirren me prioritet dhe të përfundojnë. Çështja tjetër që është paraparë në buxhet dhe kjo besoj që është me prioritet që mos me i quajtur të gjitha urgjente, është renovimi i rrugëve lokale në të gjitha fshatrat, besoj që është një prioritet që duhet pasur parasysh edhe me marrë menjëherë në fillim të këtij miratimi të buxheti. E kam shqyrtuar buxhetin do të thotë ka shumë projekte dhe investime, ka shumë shifra që mos të hyj t'i përsëris të gjitha, unë pajtohem me kritika që dhatë, mirëpo nuk e pashë që dikush ka marrë një kërkesë konkrete në Kuvend edhe e ka sjellë në Kuvend dhe kërkojnë që ajo pikë me u miratua. Unë mendoj që ajo është roli jonë, mundemi me repliku ka gabime ka edhe gjëra që munden me u përfshirë.

Ajo çfarë unë e pashë që ka shumë projekte, investime, por ka pak buxhet tek disa investime edhe janë grumbulluar për shembull: rregullimi i rrugëve i shumë fshatrave renovimi i shumë shkollave që nganjëherë unë mendoj që kanë me na dalë probleme në këtë aspekt, kështu mendoj që të bëhet një mbikqyrje e rreptë te ata që i marrin punët që do të thotë që i implimentojnë në teren për shkak se shpeshherë po na duhet me përsëritë prapë në renovim që e kemi pasur në projektbuxhet dhe nuk është kryer si duhet. Nuk po e them operator i papërgjegjshëm, por i papërgatitur, në këtë rast na duhet me ia shtuar mbikqyrjen që do me thënë mbikqyrja të jetë më e rreptë e të realizohen. Ajo çfarë mendoj që është më e rëndësishme me u paraparë është të jenë në projektbuxhe, bursat për studentë. Po ashtu edhe subvencionimet për klubet dhe sportin, që janë të vetmet forma që na me mbajtur rininë aktive dhe në vendlindje. Për fund projektbuxheti është dokument që në momentin kur miratohet është ligj. Unë kërkoj dhe uroj që të respektohet. Faleminderit!

**Fatmir Ademaj,** Kryesues: Faleminderit Bashkim! Fjalën e ka Burimi.

**Burim Paçarizi,** nga PDK: Asnjëherë besoj që asnjë qytetarë i Komunës sonë nuk është i kënaqur nëse ndodh ndonjë vërshim apo fatkeqësi në komunën tonë, apo edhe në shtetin tonë. Prandaj ne nuk jemi të kënaqur si është proklamuar në të gjitha mediat që opozita është e kënaqur me vërshimet, ajo nuk qëndron edhe është totalisht gabim, sepse asnjë qytetarë i Republikës së Kosovës nuk është i kënaqur me fatkeqësitë që ndodhin në vendin tonë. Prandaj është mirë edhe ne të kemi kujdes, edhe ju në adresimin e këtyre propagandave. Unë si asambleist edhe në mandatin e kaluar vërejtjet e mia i kam dhënë që nga detyra projektuse që nga dëgjimi publik në këtë sallë; i kam bërë mbi pesëmbëdhjetë pyetje kompanisë projektuese besoj jeni këtu, po janë edhe procesverbalet për të gjitha përgjigjet e prezantimet kanë qenë që këtë e ka vlerësuar komuna.

Gabimet projektuese që i kemi bërë ato po shfaqen, po dalin tani, nuk është që ne i dimë të gjitha, por nganjëherë ndoshta edhe puna profesionale edhe puna në terren ty të tregojnë disa problematika që mund të ndodhin në vazhdimësi dhe ato të evitohen. Ky parking po ka probleme të mëdha për arsye të një mospërfilljeje të Sëot-analizve, pa një analizë të mirëfilltë një projekt jetik për qytetarët e Malishevës normalisht që do të ketë këto shfaqje. Unë e kam edhe një pyetje për Kryetarin një temë me rëndësi është që këto vërshime, këto situata në vazhdimësi po na vijnë ndoshta për shkak të pakujdesisë sonë, unë nuk di se kush është duke i bërë projektet, shtrati i lumit duhet bërë me materiale të forta me beton d.m.th. është mënyra ma e keqe e rregullimit të shtratit të lumit. Nuk jam kundër investimit, por shtrati i lumit në këtë formë e ka arritur shpejtësinë e lëvizjes e ka dëmtuar ekosistemin, që verës ato gjallesa të cilat janë në ujë janë në cektinë është jashtëzakonisht keq. Nuk e di ku është marrë ai model ose ajo formë, por janë detaje shumë me rëndësi që në të ardhmen ka me shkaktuar telashe se ajo shpejtësinë e ujit ty ta ka arritur sasinë e ujit tek diga, kjo nuk është punë me ishalla por kjo punë është me matje. Duhet të jetë vizioni më i qartë të ketë përgjegjësi më shumë, ka analiza më shumë, urojmë që të funksionojnë mirë, por që të funnksionojë në mënyrën më të mirë duhet të merren këto probleme. Mos të shkojmë te rreziku sepse nëse diga që e ceku kolegu më herët ka probleme ne e dimë që fshatrat të cilat janë mbrapa kanë me pasë dëme jashtëzakonisht të mëdha edhe te aspekti njerëzor dhe te aspekti ekonomik.

Të kemi kujdes të analizojmë, të trajtohen ujrat të trajtohet mënyra e funksionalizimit të një projekti, mbi 10,000,000 € investim. Kryetar është jashtëzakonisht jetik, është investimi më i madh i bërë në qendër të qytetit dhe mbrenda një afati tremujor që është bërë prerja e shiritit të kemi vërshime. Unë e kam thënë që uji në Malishevë vjen prej Berishës e nga Ngucat shumica nuk e kanë marrë parasysh, komplet ai ujë ty ta ka marrë parkingun, stacionin e autobusëve. Dëmet janë shumë të mëdha duhet të trajtohet kjo çështje. Edhe atëherë vërejtja ime ka qenë që Malisheva si situacion, toka është e përbërë me materiale të cilat e përçojnë lagështinë dhe niveli i ujit është një metër është në procesverbale, normalisht që ke me pasë probleme në këtë formë, edhe te izolimet dhe te mënyra e largimit të ujit, prandaj është mirë të bëhet edhe njëherë një detyrë projektuese ta trajtojë ujin, të bëni izolime të mira. Problemin me lumë do ta keni në vazhdimësi, sepse keni rritë shpejtësinë e ujit dhe keni dëmtuar ekosistemin, duhet të mirren materiale shtesë që të izolohet ai beton sepse nuk ka këtë formë të lumit me beton që i plotëson kriteret e ekosistemit. Ndoshta është mirë me na dhënë përgjigje për këtë sepse nuk kam pasur rastin me dhënë vërejtje për mënyrën sesi ka arritur ky projekt.

**Fatmir Ademaj**, Kryesues i Kuvendit: A ka dikush debat për këtë pikë të rendit të ditës? – nëse nuk ka ftojë e Drejtorin për Buxhet dhe Financa t'i japë shpjegimet për pyetjet të cilat u bënë. Urdhëro, Drejtor *Blerim Thaçi!*

**Blerim Thaçi,** Drejtor për Buxhet dhe Financa.

Së pari dua t'ju themi që borxh nuk kemi janë obligime kontraktuale të cilat i kemi të kontraktuara me operatorët për punët të cilat janë kryer.

Po ndalem te kontratat e punëve të Sheshit, unë e di që në janar të vitit 2022, është nënshkruar Kontratat e Sheshit në qendër dhe sipas planifikimit buxhetor ka qenë e planifikuar edhe një pjesë në vitin 2026, i cili ka vlerën 1,200,000 euro që janë si obligim mbrenda Kontratës së nënshkruar për Sheshin. Po ashtu kemi dhe obligime të tjera trevjeçare kontraktuale të cilat duhet të bartën.

Te çështja e kolektorit në Bubël dhe ajo është një kontratë, e cila është nënshkruar në vitin 2022, dhe është në implementim nuk është që ne e kemi si projekt të ri, e kemi obligim dhe besoj që këtë vit do të mbyllet dhe ajo kontratë. Të gjitha këto obligime kontraktuale janë pothuajse 90% e kontratave që do të mbyllen këtë vit. Është e vërtetë që e kemi një shumë të madhe të mjeteve të cilat janë obligim kontraktual që duhet të kryhen këtë vit. Kemi dhe te rrugët të cilat janë obligime asfaltimi i rrugëve nga kontratat paraprake. E ceku Vetoni përvojën e Sylës, por dhe Vetoni ka një përvojë politike, te renovimi i rrugëve janë 50.000 euro nuk e ceku të gjithë projeksionin, sepse nëse shikojmë janë rreth 1 milion euro.

Te kanalizimet e reja dhe këtu janë 1,400.000 € por me projeksione të vitit 2027/2028. Te renovimi i rrugëve e ceku që e kemi 0,0 është te projeksionet e vitit 2027/2028 sepse 2026 është, janë 30.000 € janë obligim nga kontrata që e kemi të nënshkruar. Lumi është një projekt i cili është i kontraktuar nga komuna për pjesën për buxhet nga përformanca që e kemi pasur 620.000 € dhe si total i projektit që të realizohet ajo është dashur t'i shtohet rreth 800,000 €, që është afër 1.4 milion shtrati i lumit. Ai është si projekt i veçantë pse e kemi futur këtë projektin tjetër rrugët rreth lumit, ne nuk kemi mundur t'i fusim në projektin që është në ekzekutim, ky është projekt i ri dhe kemi paraparë që për 2-3 vjet të përfundohen dhe dy rrugët anësore të lumit. I cekët akset është e vërtet që ndoshta është dashur një material shtesë, nuk e di a e kanë në aspektin teknologjik urbanizmi a i kanë në CD apo në USB, apo i kanë në fletë sepse ato i kanë në fotografi që i kanë bërë me dron dhe akset ku janë. Arsyetimi i firmes projektuese është rrugët për të cilat kërkohen 90% e tyre nuk kanë emra dhe i kanë bërë operatorët me akse. Carrallukë p.sh.: rruga Imer Krasniqi e kanë shënuar aksi i parë. *Imran* ndoshta nuk e lexove këtë pjesën të cilën e kemi sjellë sot aty janë të gjitha rrugët, janë në vlerë rreth 7,000,000 € këtë vit në materialin shtesë.

Renovimi i shkollave e ceku *Demiri* është një gjë që na vijnë të dhënat nga Drejtoria e Arsimit na është parapa të futen të gjitha shkollat, ne nuk mundemi t'i fusim të gjitha shkollat në sistemin e Ministris së Financave që të jenë të alokuara në buxhet, por ne kemi marrë një shembull është çështje e DKA-së kemi pasur një rast një dëmtin në shkollën e Astrazupit ndoshta e kanë parapa ndonjë sanim. Më saktë nuk e di përgjigjen janë përfshirë, por nuk do të thotë që kur bëhet kontrata duhet të bëhet ndërhyrja, por është ndërhyrja kur është nevoja, sepse nuk po janë format e kontratave në bazë të asaj çka kërkon shkolla me u kry. Dëgjimet publike i kemi mbajtur vitin e kaluar në çdo lokakion të Bashkësive lokale, në 22 Bashkësi lokale. Ftesa për qytetarë ka qenë për të gjithë, ka pasur fshatra që ka pasur mungesë por ka pasur fshatra që ka pasur pjesëmarrje të mjaftueshme.

Jemi munduar që t'i funksionojmë në buxhet të gjitha kërkesat e qytetarëve. Jemi të diskriminuar me buxhet? Jemi të diskriminuar sepse numri i popullsisë ka rënë dhe koeficienti i ndarjes së buxhetit nga qeveria nuk është ndarë, është absurde rritet buxheti bëhet 4 miliard euro në nivel qendror, e zvogëlohet në atë lokal që i bie pjesa e mbetur i mbetet qeverisë. Është dashur të ndërroj dhe koeficienti i ndarjes. Sheshi së bashku me parkun ka, nevojë me u mirëmbajtë, ka nevojë për investime për këtë arsye është planifiku më shumë në aspektin e mirëmbajtjes.

Një gjë u cek me të drejtë dhe kemi bërë dhe kërkesë mediatike që ne jemi të hendikepuar që në rastet emergjente nuk lejohet me pasë fond emergjent Komuna. Kisha kërkuar nga ju që buxheti të miratohet me ato dy ndryshimet, të cilat janë ardhur sot. Harrova të ceku dhe një gjë shumë me rëndësi se kemi projekte që janë shtyer me kërkesë për gjashtë muaj për implementim dhe kemi dalë në vitin 2026. Gjatë kësaj periudhe 4-vjeçare jemi dëmtuar në buxhet kryesisht në investime kapitale në mallra e shërbime nga Kontrata Kolektive do të jetë 3.8 milion euro, na janë marrë mjetet që na kanë penguar edhe në realizimin e këtyre kontratave. Fatmirësisht kemi pasur fatin dhe me angazhimin tonë për 4 vite rresht kemi pasur tejkalim të të hyrave që na ka mundësu lehtësimin e realizimit e këtyre projekteve, sepse nëse nuk do të kishim tejkalim të hyrave vërtet do të kishim obligime të mëdha.

Faleminderit!

**Enver Hoti**, nga AAK: Unë nuk e kisha fjalën për fond emergjent, ideja është kështu të organizohet një grup i ekspertëve që do ta bëjnë vlerësimin e rreziqeve sepse ne do të vijmë prapë në të njëjtën situatë, të marrim masa që t'i përballojmë më lehtë.

**Fatmir Ademaj**, Kryesues i Kuvendit: Urdhëro, Kryetari i Komunës, *z. Ekrem Kastrati*!

**Ekrem Kastrati**, Kryetari i Komunës:

Të gjitha diskutimet, analizat, opinionet që dolën nga kjo seancë urgjente janë të kuptueshme, sepse ne të gjithë që jemi në sallë e kemi një mision të përhershëm interesin qytetarë. Besoj që të gjithë të zgjedhurit e Komunës së Malishevës po e luajn këtë rol që ta mbrojnë interesin e qytetarëve, që është obligim dhe detyrë e tyre dhe e Kryetarit të Komunës dhe njësisë komunale që t'i ketë parasysh të gjitha këto opinione, vërejtje, dëshira dhe do të mundohemi që pak a shumë t'i përmbushim këto karshi mundësive tona dhe karshi objektivave tona politike.

Mirëpo, sot është buxheti një instrument i cili i realizon të gjitha këto kërkesa tona andaj ju i dini kapacitetet tona financiare. E ceku dhe Drejtori për Buxhet dhe Financa në vend të rritet buxheti është zvogëluar, për arsye të numrit të banorëve, mirëpo ne do të shkojmë me rritjen e të hyrave tona vetanake dhe sigurisht që të trokasim në secilën derë të qeverisë qendrore dhe tek donatorë të ndryshëm që t'i përmbushim pak a shumë të gjitha këto nevoja.

Mungesa e kabinetit qeverisës e Komunës së Malishevës, sigurisht që shumë shpejt do ta kemi në Qeverinë Komunale, këtë nuk e kemi bërë, sepse na ka munguar miratimi i buxhetit. Kemi dashur që së pari ta miratojmë buxhetin pastaj ta rregullojmë, sepse një numër i asambleistëve që do të jenë, do të jetë drejtor në qeverinë e ardhëshme, prandaj dorëheqja, zëvendësimet të gjitha këto neve na marrin kohë dhe kemi dashur që së pari ta votojmë buxhetin, sepse është kërkuar prej trupave të qeverisë që komunat të cilat nuk e kanë të aprovuar buxhetin në vitin që shkoi, sa më shpejt që është e mundur me votuar në asambletë e tyre, me qëllim që të kenë kohë ata që ta analizojnë dhe ta bashkërendojnë buxhetin e qeverisë komunale.

Kështu që të gjitha komunat të cilat nuk e kanë miratuar edhe ato do të shkojnë me procedura urgjente, sepse nuk kanë kohë me shku me mbledhje të rregullta. Bashkëpunimi me opozitën gjithmonë ka qenë, besoj që dhe do të jetë njëra prej objektivave tona të kësaj qeverie 4-vjeçare, do të kemi kohë të mjaftueshme edhe me juve qytetarë, juve parlamentarë dhe Kryesues përkatësisht dhe me anëtarë tjerë të opozitës, të gjithë e kemi një rol dhe ky rol është interesi i qytetarëve të Komunës së Malishevës. Ne nuk do të ndalemi edhe me kërkimin e donatorëve të tjerë, ju e dini që ne 1,2 milion euro i kemi marrë ndihmë vetëm prej Qeverisë së Qatarit është një shumë e madhe i kemi rritë edhe investimet në bujqësi, mirëpo kanë qenë të pamjaftueshme ndihma që e kemi marrë nga ISLAMIC RELIEF, ndihmat nga përfaqësuesit e shoqatave të tjera na kanë ndihmu që t'i realizojmë punët tona me aq buxhet që kishim. Do të vazhdojmë bashkëpunimin me të gjithë juve, do të kemi kohë me të gjitha dikasteret që të bisedojmë dhe t'i forcojmë argumentet tona faktike.

Te fatkeqësitë natyrore i gjithë populli ynë është bashkë sepse vetëm bashkë i përballojmë situatat e tilla, i dimë dhe dobësitë tona diku ku kanë dështu presim ta përmisojmë, por në fund të fundit është fuqia madhore kur ta rritë nivelin e ujit dy metra e gjysmë nuk kemi mundësi se si ta përballojmë, ato dalin mbi forcën njerëzore. Kështu që ne do të mundohemi që t'i sanojmë të gjitha defektet që i kemi pasur dhe që do të mundohemi që t'i realizojmë objektivat tona politike infrastruktore, vullnetin qytetarë dhe të gjithë.

Shtrati i lumit kërkesa jonë ka qenë që sa më shpejt të zbrazet qyteti prej ujit, ju vetë e cekët që Malisheva është një vend ku të gjithë lumenjtë e të gjitha përrockat derdhën në një luginë në shtratin e lumi Mirusha. Ne e kemi bërë detyrën projektuese që sa më shpejt me largu ujin nga qyteti, për ta larguar ujin nga qyteti duhet të rritet shpejtësia e ujit, për t'u rritur shpejtësia e ujit përveç betonit askush tjetër nuk e bën, sa i përket ekosistemit është e vërtetë që ndoshta cenohet, por ne kemi dashur që në vërshime të tilla ta largojmë ujin sa më shpejt nga qyteti. Mos të kishte qenë kjo pjesë që e largon ujin kaq shpejtë me të vërtetë do të ishin vërshimet më të mëdha dhe shumë më të rrezikshme. Diga e liqenit dihet qysh është ndërtu pa plan se nuk po dua t'i huj asaj teme, sepse i përket dikujt tjetër.

Diga është e paqëndrueshme dhe raportet tona me agjensinë për menaxhimin e emergjencave e kemi vetëm një rekomandim që atë dig duhet të riparohet të funskionalizohet, sepse përndryshe siç e ceku dhe Enveri është rrezik për banorët që jetojnë poshtë digës. Ne duhet sa më shpejt me organet tona kompetente me qeverinë qendrore, me agjensinë për menxhimin e financave dhe dikasterëve respektive që të dalim atje dhe sa më shpejt të jetë e mundshme ta rehabilitojmë këtë digë që është vërtet rrezik i madh për qytetarët. Ne besojmë që shumë shpejt negociatat që i kemi pasur me përfaqësuesit e qeverisë që kjo digë të trajtohet. Edhe ujërat që shpien në fshatin Gurbardh ju e dini që është dëmtuar shumë me këto vërshime është pjesë e trajtimit të qeveris qëndrore.

Të gjitha këto projekte të cilat janë dëmtuar gjatë vërshimeve ne do të kemi kujdes dhe tani veç e kemi dërguar shkresën tek ministritë respektive që t'i sanojmë këto së bashku. Pjesa e Berishës që ka një sipërfaqe të madhe të grumbullimit të ujit edhe ajo pjesë do të trajtohet, aty është një urë me u ndërtu dhe sigurisht thellimi i përrockës nën urë. Në të ardhmen ka me qenë fotografia e fundit që do ta vendosni. I gjithë regjioni Drenas, Rahovec, Malishevë është përfshirë nga uji, ne do të bëjmë përpjekje së bashku që të gjitha këto nevoja që i kanë qytetarët e Komunës së Malishevës t'i realizojmë.

Faleminderit!

**Fatmir Ademaj**, Kryesues i Kuvendit: kisha kërkuar nga Enveri a dëshiron ta vendos propozimin e tij për shtyrjen e kësaj seance apo dëshiron ta largojë si propozim? Urdhëro, *Enver Hoti!*

**Enver Hoti**, nga AAK: Unë dua ta vendosim në votim propozimin tim që ta vendosim në votim shtyrjen e projektbuxhetit.

**Fatmir Ademaj,** Kryesues i Kuvendit: E hedh në votim kërkesën e *Enver Hotit* anëtarit të Kuvendit që kjo seancë të shtyhet. Kush është për?

**Për**: 10
**Kundër:** 15
**Abstenim:** 1

Me 10 vota **Për,** 15 **Kundër,** 1 **Abstenim** nuk kalon propozimi i Enver Hotit.

Në mbledhjen e KPF-së individualisht i kam pyet anëtarët e Kuvendit përfaqësuesit e grupeve parlamentare nga Nisma, PDK, LDK, VV se a kanë propozime konkrete që të futen në buxhet, ashtu siç ka qenë kërkesa nga Drejtori për Buxhet dhe Financave që të shtohen në buxhet sot me rekomandim të KPF-së nuk ka pasur asnjë subjekt politik asnjë propozim. Edhe sot keni hapsirën t'i sjellni në mënyrë të shënuar që t'i vendosi në votim. A ka dikush kërkesa të shënuara që të futën në buxhet komunal 2026-2028?

Urdhëro, *Veton Zogaj*!

**Veton Zogaj**, nga VV: Përkundrazi Kryesues jam unë që kam bërë kërkesë zyrtare te profa i kam thënë: A ka hapësirë buxhetore që na t'i japim propozimet tona si Grup Parlamentar nëse po vijmë me kërkesa zyrtare dhe i protokolojmë, nëse jo kërkesat tona unë i paraqes në seancë që dua t'i paraqes kurdo që i vjen rasti.

**Fatmir Ademaj**, Kryesues i Kuvendit: A ke propozim, *Veton*?

**Veton Zogaj**, nga VV: Po i kam, mundem me t'i lexu, sepse nuk i kam të shënuara mund t'i dërgoj dhe në e-mail.

**Fatmir Ademaj**, Kryesues i Kuvendit: Propozime të shënuara, duhet t'i vendosni në votim, ose e cekim kërkesa e Vetonit me propozimet e cekura më lart.

**Veton Zogaj**, nga VV: Ne si grup kemi 7 kërkesa të cilat janë shumë të arsyeshme si nevoja për qytetarët e Komunës së Malishevës, të cilat kanë ardhë kërkesë prej qytetarëve. Nëse ka hapësirë buxhetore me u futë si projekte do të isha shumë mirënjohës dhe falënderues.

Kërkesa e parë është:

1. Renovimi i stacionit të autobusëve në Malishevë me kosto buxhetore prej 200.000 € që nënkupton që është projekt dyvjeçarë.

2. Bursa për studentë, 200-300 studenë.

3. Zgjerimi i hyrjeve dhe daljeve të qytetit sidomos në rrugën "Adem Jashari" dhe rruga "Imer Krasniqi" të bëhen në 4 kursi. Projekte dyvjeçare.

4. Vendosja e dy semaforëve në rrugën "Ibrahim Mazreku" te hyrja e gjimnazit dhe në rrugën "Gjergj Kastrioti" te hyrja e Komunës së Malishevës.

5. Hapësira e nënparkingut t'i jepet në menaxhim të shoqatës së dalë nga lufta.

6. Ndërtimi i objektit të ri të Biblotekës së qytetit.

7. Ndërtimi i rrethrrotullimit në kyqjen e rrugës në fshatin Tërpez.

**Fatmir Ademaj**, Kryesues i Kuvendit: A ka dikush tjetër ndonjë propozim? Urdhëro, *Enver Hoti!*

**Enver Hoti,** nga AAK: Unë propozoj që kanalizimi në Kijevë të realizohet, të lidhet me kolektorin kryesor që shkon në Malishevë. Në Carrallukë një kanalizim që ka mbetur në gjysmë afër 10 vjet të lidhet me kanalizime.

**Fatmir Ademaj**, Kryesues i Kuvendit: Urdhëro, *Drejtori për Buxhet dhe Financa!*

**Blerim Thaçi:** Janë të planifikuara te ndërtimet e reja të kanalizimeve edhe pjesa e kanalizimeve të Kijevës dhe të fshatit Carrallukë. Janë projeksione 3-vjeçare.

**Enver Hoti**, AAK: Kërkesa ime është t'i jipet prioritet.

**Blerim Thaçi:** Enver çështja e prioritetit është kontrata dhe mbikqyrësit vendosin kur i sheh më të domosdoshme, është çështje e implementimit.

**Fatmir Ademaj**, Kryesues i Kuvendit: I kemi dy propozime nga *Veton Zogaj* dhe nga *Enver Hoti.*

Kush është për që të miratohen këto propozime të *Veton Zogaj* nga LVV:

1. Renovimi i stacionit të autobusëve në Malishevë me kosto buxhetore prej 200.000 € që nënkupton që është projekt dyvjeçarë.

2. Bursa për studentë, 200-300 studenë.

3. Zgjerimi i hyrjeve dhe daljeve të qytetit sidomos në rrugën "Adem Jashari" dhe rruga "Imer Krasniqi" të bëhen në 4 kursi. Projekte dyvjeçare.

4. Vendosja e dy semaforëve në rrugën "Ibrahim Mazreku" te hyrja e gjimnazit dhe në rrugën "Gjergj Kastrioti" te hyrja e Komunës së Malishevës.

5. Hapësira e nënparkingut t'i jepet në menaxhim të shoqatës së dalë nga lufta.

6. Ndërtimi i objektit të ri të Biblotekës së qytetit.

7. Ndërtimi i rrethrrotullimit në kyqjen e rrugës në fshatin Tërpez.

**Për:** 10
**Kundër:** 15
**Abstenim:** 1

Me 10 vota **Për**, 15 **Kundër**, 1 **Abstenim** nuk kalon propozimi i Veton Zogaj.

Kush është për propozimin e *Enver Hotit* që kanalizimi në Kijevë të realizohet, të lidhet me kolektorin kryesor që shkon në Malishevë.
Në Carralluk një kanalizim që ka mbetur në gjysmë afër 10 vjet të lidhet me kanalizime, të ju jepen prioritet.

**Për:** 10
**Kundër:** 15
**Abstenim:** 1

Me 10 vota **Për**, 15 **Kundër,** 1 **Abstenim** nuk kalon propozimi i Enver Hotit.

E hedhim në votim kërkesën nr. 04/534 datë: 29.08.2025 ***për miratimin e projektbuxhetit*** për vitin 2026/2028.

* Gjatë procesit të votimit për miratim të buxhetit sallën e lëshuan: **PDK** dhe **LVV.**

Prezent jemi **17** anëtarë dhe kemi kourum për vazhdim të votimit.

E hedh në votim kërkesën nr. 04/534 datë: 29.08.2025 ***për miratimin e projektbuxhetit për vitin 2026/2028.***

Kush është për?
**Për:** 15
**Kundër:** 1
**Abstenim:** 1

Me 15 vota **Për**, 1 **Kundër,** 1 **Abstenim** miratohet buxheti komunal për vitin 2026-2028.

Me kaq e përfundojmë këtë seancë.

Procesmbajtësja
Argenitë Thaçi

Kryesuesi i Kuvendit
Fatmir Ademaj

Kuvend

# Propozim - Formula për zgjedhjen e delegatëve të Komunës për Kuvend të AKK-së

Safete Beqiri <safetebeqiri@komunat-ks.net>

Wed 2/11/2026 11:06 AM

To:Ekrem Kastrati <Ekrem.Kastrati@rks-gov.net>; valmir.gashi@hotmail.com <valmir.gashi@hotmail.com>;

1 attachments (168 KB)

Formula e zgjedhjes se delegatit per Kuvend te AKK-se.pdf;

Caution! This message was sent from outside your organization. Allow sender | Block sender

**I nderuar Kryetar,**

Asociacioni i Komunave të Kosovës (AKK) ju fton që, në përputhje me Statutin dhe rregullat e brendshme të AKK-së, të emëroni delegatët e Komunës Suaj për përfaqësim në Kuvendin e Përgjithshëm të AKK-së. Bashkangjitur gjeni **Propozim-Formulën** për zgjedhjen e delegatëve të Komunës për Kuvendin e AKK-së. Në bazë të kësaj Propozim-Formule, si dhe duke u mbështetur në rezultatet e zgjedhjeve të fundit për Kuvendin Komunal,propozohet që Komuna Juaj të përfaqësohet nga:

- NISMA– dy anëtar të Kuvendit Komunal
- PDK– një anëtar i Kuvendit Komunal

Ju njoftojmë se kjo është vetëm **formulë orientuese/propozuese** e AKK-së. Megjithatë, dëshirojmë të theksojmë se vendimin final për përfaqësim e marrin Kuvendet Komunale përkatëse, dhe se delegimi i përfaqësuesve duhet të miratohet me vendim formal nga Kuvendi Komunal, në përputhje me procedurat ligjore dhe statutore.

Ju lutemi që pas miratimit në Kuvendin Komunal, vendimin zyrtar me emrat e delegatëve të përzgjedhur ta dërgoni në adresën elektronike:safetebeqiri@komunat-ks.net
Duke ju falënderuar për bashkëpunimin, ju dëshirojmë suksese dhe punë të mbarë!

**Me respekt,**

**Safete Beqiri**
**Asistente e Administratës**
**Asociacioni I Komunave të Kosovës**
**Tel: +381 38 / 245-734**
**Fax: +381 38/245-733**
**www.komunat-ks.net**
**safetebeqiri@komunat-ks.net**

**ASOCIACIONI I KOMUNAVE TË KOSOVËS**

| | |
|---|---|
| Për: | Kryetarin e Komunës dhe<br>Kryesuesin/en e Kuvendit të Komunës |
| Nga: | Sazan Ibrahimi – Drejtor Ekzekutiv, Asociacioni I Komunave të Kosovës |
| Data: | 10 Shkurt 2026 |
| Subjekti: | Formula për zgjedhjen e delegatëve të Komunës për Kuvend të AKK-së |

I nderuar Kryetar,

I/E nderuar Kryesues/e i/e Kuvendit të Komunës,

Sipas Statutit të Asociacionit të Komunave të Kosovës, numri i delegatëve për Kuvend të AKK-së është caktuar në bazë të kritereve të shënuara në vijim:

Përveç Kryetarit të Komunës, komunat i delegojnë për çdo 10 anëtar të KK-së, 1 (një) përfaqësues në Kuvendin e AKK-së. Kërkohet edhe përfaqësimi i partive politike dhe përfaqësimi gjinor.

Në Kuvend marrin pjesë edhe përfaqësuesit e minoriteteve në pajtim të një marrëveshjeje të Kryetarëve të Komunave (numri dhe përkatësia në bazë të përfaqësimit të tyre në KK).

Komunat do t'i zgjedhin përfaqësuesit e tyre në Kuvendin e Komunës, në proporcion me numrin e votave që partia i ka fituar në Kuvendin Komunal.

Kjo formulë e përfaqësimit është aplikuar që nga fillimi.

Me respekt,

**Sazan Ibrahimi**

**Drejtor Ekzekutiv i Asociacionit të Komunave të Kosovës**

Rr."Gustav Mayer" Nr.5 Tel: 038/ 245 732 038/ 245 734 038 245 735 Fax: 038/ 245 733
**www.komunat-ks.net**

PRANUAR MË / ACCEPTED ON 03/03/2026
PRIMLJENO
01/443

# Republika e Kosovës
## KOMUNA E MALISHEVË

### KOMISIONI KOMUNAL PËR VLERËSIMIN E DËVE NGA FNFT

| | |
|---|---|
| PËR: | z. Fatmir ADEMAJ, Kryesues i Kuvendit të Komunës |
| PËRMES: | z. Ekrem KASTRATI, Kryetar i Komunës |
| NGA: | Halit MAZREKU, Sekretar i Komisionit |
| LËNDA: | **RAPORT:** mbi vlerësimin e dëmeve nga FNFT,- |

I nderuar !

Bazuar në situatën e krijuar si pasojë e reshjeve atmosferike me intenzitet të lartë që nga orët e mbrëmjes së datës 05.01.2026, duke rrezikuar përmbytje të zonave përgjatë pellgut të lumit Mirusha, dhe rreziku i qarjes së digës në liqenin e Mirushës, me kerkesë të Komandantit të Incidentit dhe Sektorit të Emergjencave, kryetari i Komunës me vendim Nr.01/04, të datës 06.01.2026 ka aktivizuar Shtabin Emergjent Komunal për menaxhimin e Situatës Emergjente - Vërshime.
Shtabi Emergjent Komunal ka menaxhuar Situatën Emergjente-Vërshimet në përputhshëri me aktet ligjore dhe Planet Emergjente për komunën e Malishevës.
Pas përfundimit të Situatës Emergjente, me propozimin e Sektorit të Emergjencave - DKMSH, kryetari i komunës, duke u bazuar në Nenin 90 dhe 91 të Ligjit Nr. 04/L-027 për Mbrojtje nga FNFT dhe Nenit 9 pika 2 dhe 3 të Rregullorës (QRK) Nr.17/2015 për Metodologjinë e Vlerësimit të Dëmeve nga TNFT, me aktvendim Nr.01/27 , të datës, 09.01.2026. ka themeluar Komisionin komunal për VD nga FNFT me mandat katër (4) vjeqar.

Me datë 12.01.2026, Sektori i Emergjencave - DKMSH, ka bërë shpallje publike për afatin e lajmërimit të dëmeve të shkatuara si pasoj e vërshimeve për Ekonomi Familjare, Bujqësi, Biznese dhe Infrastrukturë publike dhe private, me afat deri më 22.01.2026.
Pas përfundimit të afatit, Komisioni ka tërhequr nga zyra komunale për pritje gjithësej: 235 aplikacione, dhe atë për dëmet e shkatuara në:

- Bujqësi,
- Ekonomi familjare,
- Biznese, dhe
- Infrastrukturë publike dhe private.

Prej datës 23.01. deri më 12.02.2026, Komisioni ka bërë vlerësimin e dëmeve në terren. Pas përfundimit të punës në vlerësimin e dëmeve në terren sipas kerkesave, Komisioni ka filluar me klasifikimin e kerkesave dhe përpilimin e formularëve të vlerësimit. Komisioni ka trajtuar të gjitha kerkesat e parashtruara në vendin e shkaktimit të dëmit, dhe pas plotësimit të formularëve konstaton se:

- 57 kerkesa nuk përkojnë me Situatën Emegjente të vërshimit dhe se Komisoini nuk ka mundur të konstatoj dëme, dhe se si të tilla janë rrefuzuar.

Ndërsa, dëmet e shkatuara llogariten të jenë: 540,523.00 €

| Nr. | Përshkrimi | Nr. i kerkesave | Vlera e dëmit |
|---|---|---|---|
| 1 | Dëmet e shkaktuara në Ekonomi Familjare | 122 | 211,884.00 € |
| 2 | Dëmet e shkaktuara në Bujqësi | 14 | 8,260.00 € |
| 3 | Dëmet e shkaktuara në Biznese | 32 | 109,879.00 € |
| 4 | Dëmet e shkaktuara në Infrastruktur Publike | 10 | 210,500.00 € |
| **VLERA TOTALE E DËMEVE :** | | | **540,523.00 €** |

1.Bajram SHABANAJ, Kryetar __________.
2.Remzi PAÇARIZI, Anëtar __________.
3.Ramiz HOXHA, Anëtar __________.
4.Kushtrim KRASNIQI, Anëtar __________.
5.Halit MAZREKU, Sekretar __________

Me nderime!